

VENDIM
Nr. 381, datë 28.5.2026

**PËR MIRATIMIN E UDHËRRËFYESIT PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE TË
ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM, 2026–2030**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit të udhërrëfyesit për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, 2026–2030, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, ministritë e linjës dhe institucionet e tjera përgjegjëse, të përcaktuara në udhërrëfyes, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËRRËFYES PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM NË SHQIPËRI, 2026–2030

Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC)

Konteksti

Zbatimi i Agjendës 2030 ka qenë dhe vazhdon të jetë një përparësi e rëndësishme për Shqipërinë dhe institucionet e vendit. Shqipëria ka qenë ndër vendet e para që ka miratuar njëzëri një rezolutë të Kuvendit që konfirmon angazhimin e vendit për Agjendën 2030 dhe që ka krijuar mekanizmat institucionalë për të ndërlidhur SKZHIE si dhe strategjitë dhe politikat sektoriale me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Ky proces lidhet ngushtë me përparësitë e vendit: integrimi në Bashkimin Evropian, Agjendën 2030 për Zhvillim dhe me treguesit për Objektivat Zhvillimit të Qëndrueshëm për Shqipërinë, me fokus tek sektorët jetikë të zhvillimit të vendit si cilësia e shëndetësisë dhe arsimit, qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, ofrimi i shërbimeve publike, dhe ringritja efektive nga pandemia e COVID-19. Gjithashtu, miratimi i Udhërrëfyesit për arritjen e OZHQ-ve është edhe si një angazhim i ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare në kuadër të Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike 2023–2030, miratuar si një nga dy piketat hapëse të negociatave për Grupkapitullin e Themelorëve, si dhe si angazhim i reflektuar në Planin e Veprimit 2025–2027 të Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2025–2030 (konkretisht masa 1.1.4.a).

Arritja e objektivave për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit është pjesë e përmbushjes së reformave dhe angazhimeve të procesit të integritimit evropian sipas agjendës afatgjatë që ndihmon procesin e integritimit të Shqipërisë në BE brenda një kornize të qartë e të qëndrueshme strategjike. Integrimi evropian është, dhe për vitet në vijim gjatë zbatimit të Agjendës 2030, do të jetë përparësia kryesore e vendit, duke i dhënë, gjithashtu, një shtysë dhe mbështetje proceseve reformuese në të. Nga kjo pikëpamje, Plani Kombëtar për Integrim Evropian është dokument tepër i rëndësishëm për arritjen e OZHQ-ve në Shqipëri, pasi shumë nga reformat që kërkohen për integrimin në BE janë në përputhje me qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Përafrimi i OZHQ-ve me strategjitë kombëtare bazohet në qasjen për integrimin e proceseve të planifikimit të OZHQ-ve dhe Agjendës 2030, në sistemet dhe instrumentet kombëtarë të proceseve të planifikimit të politikave dhe të strategjive e dokumenteve strategjike të vendit, duke synuar eficiencën lidhur me përdorimin e mekanizmave të sistemeve të vendit; shmangien e mbivendosjeve të proceseve planifikuese; përdorimin efektiv të burimeve njerëzore; planifikimin realist të burimeve në kuadër të Agjendës 2030, si pjesë e Agjendës zhvillimore të vendit; evitimin e raportimeve të dyfishta gjatë zbatimit të kësaj Agjende të rëndësishme për zhvillimin e vendit.

Progresi në arritjen e OZHQ-ve ka qenë i ndryshëm dhe i ndikuar nga faktorë të rëndësishëm ndër të cilët pandemia e COVID-19 ngadalësoi ndjeshëm arritjet në adresimin e sfidave të zhvillimit të vendit. Po kështu, tërmeti që goditi Shqipërinë në vitin 2019 si dhe disa kriza globale, përfshirë atë energjetike, agresionin në Ukrainë etj. që shoqëruan periudhën e rikuperimit nga pandemia e COVID-19, efektet e të cilave janë edhe sot të pranishme në ekonominë globale, kanë pasur ndikim negativ, ndonëse të përkohshëm, në zbatimin e agjendës së zhvillimit të vendit.

Krahas faktorëve globalë, ndryshimet e rëndësishme demografike në vend gjatë dekadës së fundit shoqëruar me përkujdesjen e nevojshëm social, tranzicioni i gjelbër dhe energjetika, aftësia dhe qëndrueshmëria ndaj ndryshimeve klimatike dhe rreziqeve të paparashikueshme, përmirësimi i aftësive për punë dhe transformimi digjital për t’ju përgjigjur ndryshimeve të shpejta në tregun e punës dhe produktivitetit të biznesit, krahas mirëqeverisjes e ndërtimit të institucioneve të fuqizuara,

efektive dhe transparente, përbëjnë sfida kritike me të cilat Shqipëria do të duhet të vijojë të përballet deri në vitin 2030 e më tej.

Pavarësisht sfidave të rëndësishme me të cilat përballet zhvillimi i vendit, Shqipëria rezulton se e ka të ndërtuar si duhet mekanizmin e nevojshëm për arritjen me sukses të OZHQ-ve deri në vitin 2030. Ndër faktorët kryesorë vlen të theksohet se:

i. Përtej vullnetit të qartë për zbatimin e Agjendës 2030 dhe arritjes së OZHQ-ve, Shqipëria ka ngritur mekanizmat e plotë institucionalë dhe kapacitetet e duhura për këtë proces të rëndësishëm për zhvillimin e vendit. Krahas fuqizimit dhe reformave institucionale në vend, ngritja dhe funksionimi i Komitetit Kombëtar dhe Grupit Ndërinstitucional të Punës, si dhe angazhimi i SASPAC si agjencia koordinuese shtetërore në këtë drejtim, janë pjesë e rëndësishme e këtyre mekanizmave.

ii. Është kryer një punë mjaft e mirë për përafrimin e OZHQ-ve me strategjitë kombëtare dhe identifikimin e synimeve 2030 në sektorët prioritarë për procesin e zhvillimit. Përgatitja e Raportit Bazë të OZHQ-ve, përcaktimi i objektivave afatmesëm të tyre, Raportimi Vullnetar për OZHQ-të apo ndërthurja e OZHQ-ve me SKZHIE 2030, strategjitë sektoriale apo dokumente të tjerë të rëndësishëm strategjikë dhe bashkëpunimi me partnerët tanë të zhvillimit janë pasqyrë e qasjes që Qeveria Shqiptare ka ndjekur për integrimin e proceseve të planifikimit të OZHQ-ve dhe Agjendës 2030, në sistemet dhe instrumentet kombëtarë të proceseve të planifikimit të politikave dhe të strategjive. Pjesë e këtij procesi është dhe bashkëpunimi me aktorët e tjerë si shoqërinë civile, akademinë, forumet e biznesit apo pushtetin lokal.

iii. Shqipëria ka përgatitur, miratuar dhe po zbaton një strategji të integruar kombëtare dhe afatgjatë për zhvillimin e vendit – Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 (SKZHIE 2030) – e cila shtrihet deri në vitin 2030 duke përcaktuar qartë vizionin afatgjatë për zhvillimin e vendit, prioritetet e zhvillimit të vendit, fokusin në procesin e integrimit evropian, si dhe hapat e investimet që do të kryhen deri në 2030 në të gjithë sektorët e rëndësishëm për zhvillimin e vendit. SKZHIE 2030 harmonizon zbatimin me arritjen e OZHQ-ve, si pjesë e Agjendës 2030, për të cilat Shqipëria është plotësisht e angazhuar deri në përfundimin e procesit në vitin 2030. Po kështu, 16 nga 50 treguesit e monitorimit të SKZHIE 2030 janë njëkohësisht dhe tregues globalë të OZHQ ndërkohë që rritja e numrit të treguesve me objektiva të përcaktuar do të ndihmojë në procesin e hartimit të strategjive të tjera sektoriale për vitin 2030.

iv. Integrimi evropian dhe OZHQ-të janë të ndërlidhura, me një fokus të përbashkët në zhvillimin e qëndrueshëm, përmirësimin e mirëqenies, reformat për forcimin e sundimit të ligjit dhe përmirësimin e qeverisjes dhe mbrojtjen e të drejtave dhe mjedisit. Agjenda e Gjellbër e Ballkanit Perëndimor dhe Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor 2021-2027 kanë një rol tepër të rëndësishëm në adresimin e sfidave të Shqipërisë dhe rajonit për përmbushjen e angazhimeve të Agjendës 2030 dhe procesit të integrimit evropian. Për procesin e negociatave për anëtarësimin në BE, pikëlidhjet midis OZHQ-ve dhe kapitujve dhe clusters të integrimit evropian për rastin e Shqipërisë, si dhe shtyllave të SKZHIE 2030, paraqiten në mënyrë skematike në tabelën e mëposhtme, e cila përcakton, gjithashtu, edhe prioritetet përkatëse të procesit të integrimit sipas OZHQ-ve:

Shtyllat e SKZHIE 2030	Zhvillim i Qëndrueshëm, interkonektiviteti dhe rritja e gjelbër															
	Mbështetja Sociale								Demokracia, mirëqeverisja							
									Institucionet							
OZHQ Kapitujt e Integrimit Evropian																
Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave																
Kapitulli 2: Lëvizja e lirë e Punëtorëve																
Kapitulli 3: E Drejta e Vendasjes dhe Liria për të Ofruar shërbime																
Kapitulli 4: Lëvizja e Lirë e Kapitalit																
Kapitulli 5: Prokurimi Publik																
Kapitulli 6: Legjislacioni për Shoqëritë Tregtare																
Kapitulli 7: E Drejta e Pronësisë Intelektuale																
Kapitulli 8: Politika e Konkurrencës																
Kapitulli 9: Shërbimet Financiare																
Kapitulli 10: Shoqëria e Informacionit dhe Media																
Kapitulli 11: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural																
Kapitulli 12: Politikat e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve																
Kapitulli 13: Peshkimi																
Kapitulli 14: Politika e Transportit																
Kapitulli 15: Energjia																
Kapitulli 16: Tatimet																
Kapitulli 17: Politika Ekonomike dhe Monetare																
Kapitulli 18: Statistikat																
Kapitulli 19: Politikat Sociale dhe të Punësimit																
Kapitulli 20: Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale																
Kapitulli 21: Rrjetet Transevropiane																
Kapitulli 22: Politikat Rajonale dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore																
Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore																
Kapitulli 24: Drejtësia, Liria dhe Siguria																
Kapitulli 25: Shkenca dhe Kërkimi Shkencor																
Kapitulli 26: Arsimi dhe Kultura																
Kapitulli 27: Mjedisi																
Kapitulli 28: Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik																
Kapitulli 29: Bashkimi Doganor																
Kapitulli 30: Marrëdhëniet me Jashtë																
Kapitulli 31: Politika e Jashtme, e Sigurisë dhe e Mbrojtjes																
Kapitulli 32: Kontrolli Financiar																
Kapitulli 33: Dispozitat Financiare dhe Buxhetore																
Kapitulli 34: Institucionet																
Kapitulli 35: Çështje të Tjera																

Ngjyra e theksuar për prioritetet më të larta

Grupkapitujt e Integrimit në BE
Themeloret / 1) Funkcionimi i Institucioneve Demokratike; 2) Kriteri Ekonomik; 3) Reforma në Administratën Publike
Tregu i Brendshëm
Konkurrueshmëri dhe Rritje Gjithëpërfshirëse
Ajenda e Gjelbër dhe Ndërtidhja e Qëndrueshme
Burimet, Bujqësia dhe Kohëzoni
External Relations

v. Zbatimi i Agjendës 2030 realizohet mbi një kuadër fiskal të mishëruar në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike. Strategjia e tretë e Menaxhimit të Financave Publike, si pjesë e rëndësishme e kuadrit strategjik për investimet dhe shpenzimet publike në sektorët prioritarë të Agjendës 2030, shtrihet deri në vitin 2030 dhe orienton politikat e reformave në menaxhimin e financave publike duke synuar të sigurojë një sistem financiar publik që promovon transparencën, llogaridhënien, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe zhvillimin ekonomik në vend, përfshirë financimin gjinor.

vi. Arritja e objektivave të Agjendës 2030 realizohet në kushtet e një konsolidimi të favorshëm fiskal që mundëson realizimin e objektivave afatmesëm të vendit. Borxhi publik i Shqipërisë për herë të parë që nga viti 2011 ka rënë nën nivelin e 60% të PBB dhe pritet të vijojë zvogëlimin edhe gjatë viteve në vijim, ndërsa balanca primare u rikthye në pozitive dhe u shënuar një përmirësim i ndjeshëm i bilancit të llogarisë korrente, ndikuar kryesisht nga performanca e sektorit të turizmit dhe shërbimeve të lidhura me këtë sektor, si edhe investimeve të huaja direkte që gjatë vitit 2023 arritën në rreth 1.5 miliardë euro.


vii. Zbatimi i Agjendës 2030 po kryhet në kontekstin e një bashkëpunimi më të suksesshëm rajonal, krahasuar me periudhën kur kjo Agjendë nisi zbatimin e saj, gjë që e ka vendosur Shqipërinë në një rol aktiv dhe të rëndësishëm në promovimin e paqes dhe bashkëpunimit rajonal duke mundësuar më shumë zhvillimin e projekteve rajonale dhe atyre të financuara nga BE, veçanërisht në ndërlidhje dhe infrastrukturë, klimë dhe mjedis, energji etj.

viii. Së fundi, po jo më pak e rëndësishme, Shqipëria është e angazhuar në zbatimin e Agjendës 2030 duke qenë, gjithashtu, aktive me rolin e saj në zhvillimet ndërkombëtare, me kontribut modest, të njohur dhe në rritje në drejtim të thellimit të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe forcimit të paqes e demokracisë kudo në botë. Kuadri i Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm 2022 – 2026, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara, lidhet drejtpërdrejt me përparësitë e vendit: integrimin në Bashkimin Evropian, Agjendën 2030 për Zhvillim dhe treguesit për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm për Shqipërinë si dhe katër rezultate të bashkëpunimit që kontribuojnë në prioritetet strategjike të vendit: a) Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 me synime dhe objektiva për OZHQ-të; b) prioritetet e vizionit të qeverisë ‘Shqipëria 2030’: ofrimi i shërbimeve, inovacioni, rimëkëmbja e pandemisë dhe tërmeteve, turizmi, bujqësia dhe energjia; c) anëtarësimi në Bashkimin Evropian, sikurse përcaktohet në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, 2020–2027; d) Programi i Reformave Ekonomike.

Udhërrëfyeni për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2030 për Shqipërinë bazohet në:

i. Analizën e progresit të deritanishëm të Shqipërisë në zbatimin e Agjendës 2030 duke marrë si pikënisje të procesit Raportin Bazë të hartuar në vitin 2017, të dhënat e siguruara nga institucionet shtetërore, përfshirë INSTAT, si dhe publikimet ndërkombëtare që monitorojnë ecurinë e zbatimit të Agjendës 2030 nga të gjitha vendet pjesëmarrëse në proces.

ii. Përcaktimin e synimeve të matshme për vitin 2030 për të gjithë treguesit e disponueshëm të OZHQ-së, sipas metodologjisë së miratuar nga Kombet e Bashkuara për çdo tregues global dhe bazuar në vlerësimet apo parashikimet e institucioneve sipas fushave përkatëse si dhe përcaktimet e këtyre objektivave në dokumente politikash sektoriale të miratuara ose në proces miratimi. Gjatë procesit të përgatitjes së këtij udhërrëfyeni, në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha institucionet e përfshira në të, u arrit të përcaktohen synimet për vitin 2030 për 66 tregues globalë të OZHQ – **ose 26.6% të treguesve globalë OZHQ**, të shpërndarë për secilin OZHQ sipas grafikut të mëposhtëm:



iii. Treguesit për të cilët janë përcaktuar objektiva të matshëm për vitin 2030, i përkasin 52 synimeve OZHQ, nga 169 të tilla, ose për 31% të tyre.

iv. Konsiderimin e metodologjive alternative që mundësojnë vlerësimin e treguesve globalë të rëndësishëm për kontekstin shqiptar për rastet kur kjo nuk mund të realizohet si më sipër.

v. Analizën e strategjive sektoriale dhe dokumenteve të politikës sipas sektorëve përkatës si dhe lidhjet me procesin e integrimit evropian.

vi. Vlerësimin e lidhjeve midis synimeve dhe treguesve të OZHQ deri në vitin 2030.

vii. Përparësitë në objektivat e përcaktuara.

viii. Vlerësimin e përgjithshëm financiar mbi arritjen e synimeve të përcaktuara për vitin 2030.

ix. Përcaktimin e afateve kohore dhe përgjegjësi institucionale për objektivat e përcaktuara.

Pjesë e analizës në udhërrëfyes është dhe Raporti i Zhvillimit të Qëndrueshëm i vitit 2024, si një instrument i paanshëm monitorimi global që tregon se Shqipëria përgjithësisht ka kryer një progres të dukshëm në ndjekjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Rezultati i përgjithshëm i Indeksit të OZHQ-ve për Shqipërinë është 75/100. Gjatë vitit të fundit ka pasur një përmirësim të ndjeshëm në renditjen globale të Shqipërisë, me një rritje prej 12 vendesh në vendin e 42-të nga 163 vende (viti paraardhës, gjithashtu, kishte një rritje prej 7 vendesh). Në rajonin e Ballkanit Perëndimor, progresi i kryer e vendos Shqipërinë përpara Maqedonisë së Veriut, Bosnjë-Hercegovinës dhe Malit të Zi.

Pavarësisht progresit të kryer, mbeten ende sfida në OZHQ2 (Zero uri), OZHQ4 (Arsim cilësor) dhe OZHQ8 (Punë e denjë dhe rritje ekonomike). Këta objektiva kërkojnë vëmendje dhe përpjekje të përbashkëta për të përshpejtuar progresin. Përparim i mirë raportohet në OZHQ3 (Shëndet dhe mirëqenie e mirë), OZHQ5 (Barazia gjinore) dhe OZHQ6 (Uji i pastër dhe kanalizimi). Për sa i përket dinamikës, sipas raportit Shqipëria është në rrugën e duhur për të përmbushur OZHQ-të 1, 7, 9 dhe 10, por sfida mbeten ende veçanërisht në OZHQ 11, 12, 13, 14, 15, 16 dhe 17.

Objekti i Zhvillimit të Qëndrueshëm 1: Zhdukja e varfërisë

OZHQ1 ka si objektiv parësor zhdukjen e varfërisë në të gjitha format e saj në gjithë botën, duke përfshirë synimet e mëposhtme:

1.1 Deri në vitin 2030, zhdukja e varfërisë së skajshme për të gjithë njerëzit në gjithë botën, e matur për njerëzit që jetojnë me më pak se 1.25 dollarë në ditë;

1.2 Deri në vitin 2030, ulja, të paktën deri në 50%, e numrit të burrave, grave dhe fëmijëve të të gjitha moshave që jetojnë në varfëri, në të gjitha përmasat e saj, sipas përkufizimeve kombëtare;

1.3 Zbatimi kombëtar i sistemeve të duhura të mbrojtjes sociale dhe masave për të gjithë, duke përfshirë nivelin bazë dhe arritje e mbulimit themelor të të varfërve dhe personave në nevojë deri në vitin 2030;

1.4 Deri në vitin 2030, sigurimi i të drejtave të barabarta për të gjithë burrat dhe gratë, veçanërisht të varfrit dhe të pambrojturit, për burimet ekonomike, si dhe akses të shërbimet bazë, pronësinë dhe kontrollin mbi tokën dhe forma të tjera të pronës, trashëgimia, teknologjitë e reja të përshtatshme dhe shërbimet financiare, përfshirë mikrofinancën;

1.5 Deri në vitin 2030, ndërtimi i qëndrueshmërisë së të varfërve dhe personave në situata të pambrojtura dhe zvogëlimi i ekspozimit dhe cenueshmërisë së tyre ndaj ngjarjeve ekstreme të lidhura me klimën, goditjet dhe fatkeqësitë e tjera ekonomike, sociale dhe mjedisore, si dhe katastrofat;

1.a Sigurimi i mobilizimit domethënës të të ardhurave nga një sërë burimesh, duke përfshirë zgjerimin e bashkëpunimit për zhvillim, në mënyrë që të sigurohen mjete të përshtatshme dhe të parashikueshme për vendet në zhvillim, në veçanti për vendet më pak të zhvilluara, për zbatimin e programeve dhe politikave për t'i dhënë fund varfërisë në të gjitha përmasat e saj;

1.b Krijimi i kornizave të politikave të shëndosha në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, bazuar në strategjitë e zhvillimit në favor të të varfërve dhe me ndjeshmëri ndaj çështjeve gjinore, për të mbështetur investimin e përshpejtuar në masat për zhdukjen e varfërisë.

Raporti mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm¹ i vitit 2024 tregon se ecuria e Shqipërisë në arritjen e OZHQ1 rezulton pozitive dhe më e kënaqshme se në të gjitha OZHQ-të e tjera. Raporti tregon se Shqipëria e ka arritur objektivin për OZHQ 1 dhe se është në progres të mirë për të ruajtur këtë rezultat për vitin 2030. Raporti i referohet dy treguesve për matjen e nivelit të varfërisë për frymë, 2.15US\$ dhe 3.65US\$ në ditë, për të cilët Shqipëria rezulton respektivisht në nivelin 0.6% dhe 0.98%, me prioritet uljeje gjatë dekadës së fundit dhe objektiv (sipas synimit OZHQ 1.1) vlerën 0% për vitin 2030.

Kuadri thelbësor strategjik: Edhe pse Shqipëria rezulton me objektiv të përmbushur në adresimin e zhdukjes së varfërisë në kuadër të Agjendës 2030, ka ende për të bërë për trajtimin e kësaj problematike në të ardhmen, veçanërisht për shtresat më të marginalizuara të shoqërisë (*leave no one behind*). Zhdukja e varfërisë në vend arrihet përmes një rritjeje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, shoqëruar me zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe funksionimin e sistemit të mbrojtjes sociale. Qasja e SKZHIE 2030 synon adresimin e varfërisë në vend deri në vitin 2030, duke rritur shënjestrimin e individëve, fëmijëve dhe familjeve të varfra, si dhe integrimin social të tyre, duke rritur në 50 për qind pjesën e përfituesve të përfshirë në skemat e punësimit, duke e kthyer nga një skemë pasive në një skemë aktive.

Vizioni i Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024-2030 synon mbrojtje sociale në një mjedis mundësues dhe fuqizues për çdo individ në nevojë, duke garantuar jetesë dinjitoze përgjatë ciklit të jetës, dhe realizohet përmes zbutjes së varfërisë për çdo individ në nevojë dhe përmirësimi i jetesës për personat me aftësi të kufizuara përmes mbështetjes me skemat financiare dhe përfitimeve të përshtatshme, të përgjegjshme gjinore, transparente, të afta për përballimin e rreziqeve e krizave (Qëllimi i politikës A) dhe zgjerimit të shërbimeve sociale të integruara, të aksesueshme e cilësore dhe të përgjegjshme gjinore, si dhe avancimi i deinstitutionalizimit të kujdesit rezidencial, në partneritet me pushtetin vendor dhe aktorët e tjerë (Qëllimi i politikës B). Strategjia Kombëtare për


¹ <https://dashboards.sdgindex.org/profiles/albania>: Raporti i Zhvillimit të Qëndrueshëm (i quajtur më parë dhe Indeksi dhe Paneli i SDG) është një vlerësim global i progresit të vendeve drejt arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe shoqëron treguesit zyrtarë të OZHQ dhe Rishikimet Vullnetare Kombëtare. Sachs, J.D., Lafortune, G., Fuller, G. (2024). The SDGs and the UN Summit of the Future. Sustainable Development Report 2024. Paris: SDSN, Dublin: Dublin University Press. 10.25546/108572.

Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 synon që Shqipëria të jetë më e sigurt, e qëndrueshme, e aftë për të zvogëluar risqet e fatkeqësive natyrore dhe efektet e ndryshimeve klimatike, për të përgatitur, përballuar dhe për t'u rimëkëmbur, integruar në të gjithë sektorët me kapacitete të zhvilluara për të siguruar parandalimin e risqeve të reja dhe menaxhimin e riskut të mbetur, që të gjitha së bashku të ndihmojnë në forcimin e aftësisë ripërtëritëse dhe si rezultat në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë.

Objektivat që synohen të arrihen deri në vitin 2030 sipas treguesve globalë të OZHQ-ve janë si vijon:

1.2.1 Përqindja e popullsisë që jeton nën kufirin kombëtar të varfërisë, sipas gjinisë dhe moshës.

Synimi për këtë tregues është zvogëlimi me mesatarisht 0.3% në vit deri në vitin 2030. Ky tregues i varfërisë deri në vitin 2030 synohet të reduktohet në 20.8% në shkallë kombëtare (21.4% në 2027) dhe 27.3% (27.9% në 2027) për fëmijët e moshës 0-17 vjeç.



1.5.1 Numri i vdekjeve, personave të zhdukur dhe personave të prekur drejtpërdrejt nga fatkeqësitë për 100,000 banorë

Falë masave të marra, treguesi synohet të zvogëlohet me rreth 10% deri në vitin 2030, duke arritur vlerën 146.8, nga 163.15 që ishte në vitin 2018.

1.5.3 Numri i vendeve që miratojnë dhe zbatojnë strategji kombëtare për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë në përputhje me Kuadrin Sendai për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2015–2030

Shqipëria e ka të miratuar strategjinë kombëtare deri në vitin 2030 ndaj treguesi rezulton i arritur.

1.5.4 Përqindja e qeverive vendore që miratojnë dhe zbatojnë strategjitë lokale të reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë në përputhje me strategjitë kombëtare për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë

Objektivi është që në vitin 2030 të gjitha (100%) njësitë e qeverive vendore të miratojnë dhe zbatojnë strategjitë lokale të reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë në përputhje me strategjinë kombëtare.

1.a.2 Përqindja e shpenzimeve totale të qeverisë për shërbimet thelbësore (arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale)

Referuar SKZHIE 2030 dhe kuadrit makroekonomik, shpenzimet totale të qeverisë për shërbimet thelbësore (arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale) për vitin 2030 do të arrijnë në 20% të PBB-së.

Sfida dhe mundësi

Ndryshimet demografike në vend dhe lëvizjet migratore brenda dhe jashtë vendit paraqesin sfida reale që mund të ndikojnë së tepërmi në tregun e punës, sistemin e pensioneve dhe varfërinë në vend. Referuar Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, popullsia banuese në Republikën e Shqipërisë në Shtator 2023 rezultonte 2,402,113 banorë, krahasuar me Censin e vitit 2011, sipas të cilit popullsia banuese ishte 2,821,977 banorë me një rënie prej rreth 420 mijë banorë.

Varfëria është ende e pranishme, veçanërisht në zonat rurale ku qasja në shërbime bazë është e kufizuar. Situata e pandemisë ka përkeqësuar gjendjen ekonomike të shumë familjeve shqiptare, duke rritur papunësinë dhe pasigurinë ekonomike. Pabarazia e zhvillimit dhe mundësive midis zonave urbane dhe rurale është një sfidë e madhe për uljen e varfërisë në shkallë vendi e veçanërisht në zonat rurale. Ndërkohë që të ardhurat për frymë janë rritur, kostot e jetesës, përfshirë çmimet e konsumit dhe strehimit janë rritur me ritme shpesh edhe më të shpejta, veçanërisht në qytetet kryesore. Kjo ndikon negativisht në standardet e jetesës dhe shton presionin mbi familjet me të ardhura të ulëta.

Transformimet dinamike të strukturës së ekonomisë dhe tregut të punës nga njëra anë përmes rritjes së produktivitetit e modernizimit në bujqësi, zhvillimit të shpejtë të turizmit dhe të shërbimeve teknologjike e digjitale dhe nga ana tjetër precipitimit të aktiviteteve prodhuese të industrisë së fasonëve që ende kontribuon në punësim, kërkojnë një qasje efektive në përgatitjen dhe mbështetjen e kapitalit njerëzor që t'i përshtatet këtij procesi transformues dhe sigurojë punësim të denjë në Shqipëri. Informaliteti i lartë në punësim, pa mbrojtje sociale apo të drejta të punës ndikon në pasigurinë ekonomike dhe varësinë nga punësimi i paqëndrueshëm.

Institucionet më të rëndësishme të përfshira në arritjen e OZHQ1:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Ministria e Financave

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Ministria e Mbrojtjes

Bashkitë

Shërbimi Social Shtetëror

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

Ndërlidhjet më të rëndësishme në Agjendën 2030 sipas kontekstit të Shqipërisë:

OZHQ 2, 3, 4, 5, 8, 10, 11, 16.

Lidhja kryesore me SKZHIE 2030:

Shtylla III: Mbështetja Sociale

Lidhja parësore me kapitujt e integritimit evropian:

Kapitulli 11: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural; Kapitulli 17: Politika Ekonomike dhe Monetare; Kapitulli 19: Politikat Sociale dhe të Punësimit

Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 2: Zero uri

OZHQ2 ka si objektiv parësor zhdukjen e urisë, arritjen e sigurisë ushqimore dhe përmirësimin e ushqyerjes, si dhe nxitjen e bujqësisë së qëndrueshme përmes synimeve të mëposhtme:

2.1 Deri në vitin 2030, dhënia fund urisë dhe sigurimi i aksesit në ushqim të sigurt, me vlera ushqyese dhe të mjaftueshëm gjatë gjithë vitit për të gjithë njerëzit, në veçanti të varfrit dhe njerëzit në nevojë, përfshirë foshnjat.

2.2 Deri në vitin 2030, dhënia fund të gjitha formave të kequshqyerjes, duke përfshirë arritjen deri në vitin 2025 të objektivave të rënë dakord ndërkombëtarisht për parandalimin e mungesës së zhvillimit të duhur dhe humbjes së fëmijëve nën moshën 5 vjeç, dhe trajtimin e nevojave ushqimore të vajzave adoleshente, grave shtatzëna dhe gjidhënëse, si dhe personave të moshuar.

2.3 Deri në vitin 2030, dyfishimi i prodhueshmërisë bujqësore dhe i të ardhurave të prodhuesve të ushqimit në sasi të vogël, në veçanti të grave, popujve indigjenë, fermerëve familjarë, blegtorëve dhe peshkatarëve, edhe nëpërmjet aksesit së sigurt dhe të barabartë të toka, burimet e tjera prodhuese dhe ushqimi, njohuritë, shërbimet financiare, tregjet dhe mundësitë për shtimin e vlerës dhe punësimin jashtë sektorit bujqësor.

2.4 Deri në vitin 2030, sigurimi i sistemeve të qëndrueshme të prodhimit të ushqimit dhe zbatimi i praktikave të qëndrueshme bujqësore që rrisin produktivitetin dhe prodhimin, ndihmojnë ruajtjen e ekosistemeve, forcojnë kapacitetin për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike, motit ekstrem, thatësirës, përmbytjeve dhe fatkeqësive të tjera dhe përmirësojnë në mënyrë progresive cilësinë e tokës dhe dherave.

2.5 Deri në vitin 2030, ruajtja e varieteteve gjenetike të farërave, bimëve të kultivuara, kafshëve të kultivuara dhe të zbutura dhe specieve të egra që lidhen me to, edhe nëpërmjet menaxhimit të mirë dhe të larmishëm të farërave dhe bankave bimore në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, dhe promovimi i aksesit dhe ndarjes së barabartë të përfitimeve që rrjedhin nga shfrytëzimi i burimeve gjenetike dhe njohurive tradicionale shoqëruese, siç është rënë dakord ndërkombëtarisht.

2.a Rritja e investimeve, edhe nëpërmjet zgjerimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në infrastrukturën rurale, kërkimet bujqësore dhe shërbimet e ekstensionit, zhvillimin e teknologjisë dhe bankat e gjeneve bimore dhe blegtorale, për rritjen e kapacitetit prodhues bujqësor në vendet në zhvillim, veçanërisht në vendet më pak të zhvilluara.

2.b Korrigjimi dhe parandalimi i kufizimeve tregtare dhe deformimeve të tregjeve botërore bujqësore, duke përfshirë heqjen paralelisht të të gjitha formave të subvencioneve të eksporteve bujqësore dhe të gjitha masave të eksportit me efekt të njëjtë, në përputhje me mandatin e Rrjetit të Zhvillimit të Dohas.

2.c Miratimi i masave për të siguruar funksionimin e duhur të tregjeve të mallrave ushqimore dhe derivateve të tyre dhe për të lehtësuar aksesin në kohë tek informacionet e tregut, përfshirë rezervat e ushqimit, në mënyrë që të ndihmohet kufizimi i luhatshmërisë ekstreme të çmimeve të ushqimeve.

Raporti mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm i vitit 2024 tregon se ecuria e Shqipërisë në arritjen e OZHQ2 rezulton pozitive por ende me sfida të rëndësishme për t'u përballur deri në vitin 2030. Raporti tregon se referuar treguesve të monitorimit Shqipëria ka arritur rezultatin dhe është në rrugën e duhur për disa aspekte të objektivit (përhapja e mosushqimit dhe pafuqisë tek fëmijët, produktiviteti në prodhim drithërash) por ka ende për të bërë në disa aspekte problematike të tij (obeziteti dhe zhvillimi tek fëmijët etj.) për vitin 2030.

Kuadri thelbësor strategjik: Duke mos qenë problem i përhapur në Shqipëri, çështja e urisë nuk trajtohet në mënyrë specifike nga strategjitë kombëtare, përfshirë SKZHIE 2030. Prodhimi bujqësor, siguria e ushqimit dhe ajo ushqimore janë pjesë e strategjive sektoriale – Strategjisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021–2027 dhe Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023–2027. Strategjia e parë ka si funksion kryesor sigurimin e ushqimit duke synuar që zonat rurale dhe sektorët e bujqësisë, agroindustrisë dhe peshkimit, të zhvillohen në mënyrë të qëndrueshme, të efektshme, bazuar në inovacion dhe në digjitalizim, që të përballojnë më mirë presionet e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar, si edhe sfidat që lidhen me ndryshimet klimatike, biodiversitetin, dhe ekonominë e gjelbër, nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë të jetës së banorëve dhe rritur atraktivitetin ndaj zonave rurale. E dyta bazohet në parimin se shëndeti i njerëzve është i lidhur ngushtë me shëndetin e bimëve, kafshëve dhe mjedisin e përbashkët dhe se një politikë e qartë kombëtare për sigurinë agroushqimore është themeli për zbatimin efektiv të parimeve të “One Health” përmes zinxhirit ushqimor nga ferma në tavolinë. Të dyja strategjitë janë nën ombrellën e SKZHIE 2030 si pjesë e bujqësisë dhe zhvillimit rural, në


shtyllën e dytë të SKZHIE 2030. Aspekte të mirushqimit nën këtë OZHQ, nga këndvështrimi i *leave-no-one-behind* trajtohen dhe nga dokumente të tjerë strategjikë si Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026.

Objektivat që synohen të arrihen deri në vitin 2030 sipas treguesve globalë të OZHQ-ve janë si vijon:

2.2.1 Prevalenca e moszhvillimit (lartësia për moshën <-2 devijimi standard nga mesatarja e Standardeve të Rritjes së Fëmijëve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh)) të fëmijët nën 5 vjeç.

Referuar nivelit 11% të matur në vitin 2018, ky tregues synohet të reduktohet në 6% deri në vitin 2030.

2.2.2 Prevalenca e kequshqyerjes (pesha për gjatësi $>+2$ ose <-2 devijimi standard nga mesatarja e Standardeve të Rritjes së Fëmijëve të OBSh-së) tek fëmijët nën 5 vjeç, sipas llojit (nën dhe mbipeshë)



Duke qenë se në kontekstin e Shqipërisë mbipesha paraqet një problem shqetësues, ky tregues, për mbipeshën e fëmijëve, synohet të reduktohet në 11% në vitin 2030 nga 16% i raportuar në vitin 2018.

2.3.1 Sasia e prodhimit për njësi të punës sipas madhësisë së ndërmarrjes bujqësore/baritore/pyjore

Për fermat bujqësore, ky tregues parashikohet të arrijë në 111.9 Euro në vitin 2030, bazuar në pritshmëritë e ecures së produktivitetit bujqësor dhe të dhënat e punës në fermë sipas censurit bujqësor të realizuar në vitin 2017.

2.5.2 Përqindja e racave lokale të klasifikuara në rrezik zhdukjeje

Nga 26 raca/ekotipa autoktone në vend, në vitin 2019 rezultuan se 13 prej tyre ose 50% klasifikohen si në gjendje kritike ose rrezik zhdukjeje. Për vitin 2030, ky tregues mendohet të arrijë në 65.4%.

2.a.1 Indeksi i orientimit për bujqësi i shpenzimeve të qeverisë

Të dhënat e INSTAT-it tregojnë se ky tregues në vitin 2022 ishte 0.13. Duke pasur parasysh rritjen e buxhetit për bujqësinë, treguesi do të arrijë në 0.17 në vitin 2030.

2.b.1 Subvencionet e eksportit bujqësor

Shqipëria është e angazhuar pranë OBT për të mos përdorur subvencione eksporti në bujqësi. Një praktikë e tillë nuk është përdorur asnjëherë dhe do të vijojë të mos përdoret në të ardhmen.

Sfida dhe mundësi

Bujqësia është e dominuar nga ferma të vogla (madhësia mesatare prej 1.2 ha) dhe të fragmentuara, të cilat janë shpesh jo produktive dhe kanë akses të kufizuar në teknologji moderne, farëra dhe inpute

bujqësore cilësore. Megjithatë, fermat e vogla luajnë rol të rëndësishëm për sigurimin e ushqimit të popullsisë shqiptare, si dhe për uljen e varfërisë në zonat rurale, por janë të integruar në mënyrë të pamjaftueshme në zinxhirët e shkurtër të furnizimit. Investimet në sektorin e bujqësisë dhe peshkimit, modernizimi i sektorit dhe rritja e produktivitetit, punësimi i lartë dhe potenciali ende i pashfrytëzuar sa duhet, shoqëruar me mbështetjen në rritje të sektorit, paraqesin mundësi të mira për zhvillimin e tij dhe forcimin e sigurisë së ushqimit në vend.

Fermerët, veçanërisht në zonat rurale, shpesh përballen me vështirësi në qasjen në tregje për të tregtuar produktet e tyre. Infrastruktura e dobët, mungesa e kapaciteteve të përpunimit dhe ruajtjes së produkteve ushqimore, dhe infrastruktura e pazhvilluar e transportit janë disa nga sfidat që ndikojnë negativisht në këtë aspekt. Shumë fermerë kanë vështirësi në sigurimin e financimeve për të investuar në aktivitetet e tyre bujqësore. Kreditimi i kufizuar dhe politikat e pamjaftueshme mbështetëse shpesh i pengojnë fermerët të zhvillojnë plotësisht potencialin e tyre. Shumë të rinj dhe të aftë për punë po migrojnë nga zonat rurale drejt qyteteve ose jashtë vendit në kërkim të mundësive më të mira ekonomike. Kjo çon në plakjen e popullsisë bujqësore dhe në një forcë punëtore më pak produktive në sektorin bujqësor.

Degradimi i tokës, erosi, zjarret, dhe ndotja paraqesin sfida madhore për bujqësinë në Shqipëri. Ndryshimet klimatike përfshirë pasojat me përmbytjet, thatësitat, dhe ndryshimet në rënien e reshjeve po krijojnë sfida të reja për fermerët, të cilët duhet të përshtaten me kushtet e reja klimatike për të siguruar prodhimtarinë.

Ndërsa uria e skajshme nuk është një problem kryesor, ekzistojnë sfida të tjera që lidhen me sigurinë ushqimore dhe ushqyerjen, siç janë mbipesha dhe obeziteti, sidomos në zonat urbane. Dieta jo e balancuar dhe qasja në ushqim të shëndetshëm janë çështje të rëndësishme që duhet të adresohen edhe më shumë në të ardhmen.

Promovimi dhe fuqizimi i bujqësisë së qëndrueshme, përmirësimi i aksesit të fermerëve në financim dhe tregje, përmirësimi i menaxhimit të tokës dhe burimeve natyrore, dhe adresimi i ndikimeve të ndryshimeve klimatike në bujqësi janë drejtimet në të cilat duhet të arrihet përmbushja e OZHQ2.

Institucionet më të rëndësishme të përfshira në arritjen e OZHQ2:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Instituti i Shëndetit Publik

Ndërlidhjet më të rëndësishme në Agjendën 2030 sipas kontekstit të Shqipërisë:

OZHQ 1, 3, 4, 5, 8, 12.

Lidhja kryesore me SKZHIE 2030:

Shtylla II: Bujqësia dhe zhvillimi rural

Lidhja parësore me kapitujt e integritetit evropian:

Kapitulli 11: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural; Kapitulli 12: Politikat e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve; Kapitulli 13: Peshkimi

Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 3: Shëndeti i mirë dhe mirëqenie

OZHQ3 ka si objektiv parësor sigurimin e jetës së shëndetshme dhe promovimin e mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat përmes synimeve të mëposhtme:

3.1 Deri në vitin 2030, ulja e raportit global të vdekshmërisë së nënave në më pak se 70 për 100,000 lindje të gjalla.

3.2 Deri në vitin 2030, dhënia fund vdekjeve të parandalueshme të të sapolindurve dhe fëmijëve nën moshën pesë vjeç, me të gjitha shtetet të synojnë të ulin vdekshmërinë foshnjore në të paktën deri

në 12 për 1,000 lindje të gjalla dhe vdekshmërinë e fëmijëve nën 5 vjeç deri në të paktën 25 për 1,000 lindje të gjalla.

3.3 Deri në vitin 2030, dhënia fund e epidemive të AIDS-it, tuberkulozit, malaries dhe sëmundjeve tropikale të neglizhuara dhe luftimi i hepatitit, sëmundjeve të mbartura nga uji dhe sëmundjeve të tjera të transmetueshme.

3.4 Deri në vitin 2030, ulja me një të tretën e vdekshmërisë së parakohshme nga sëmundjet e patransmetueshme, nëpërmjet parandalimit dhe trajtimit e promovimit të shëndetit mendor dhe të mirëqenies.

3.5 Forcimi i parandalimit dhe trajtimit të abuzimit me substancat, duke përfshirë abuzimin me drogën dhe përdorimin e dëmshëm të alkoolit.

3.6 Deri në vitin 2030, përgjysmimi i numrit global të vdekjeve dhe dëmtimeve nga aksidentet në trafikun rrugor.

3.7 Deri në vitin 2030, sigurimi i aksesit universal të shërbimet e kujdesit të shëndetit seksual dhe riprodhues, përfshirë planifikimin familjar, informimin dhe arsimimin dhe integrimin e shëndetit riprodhues në strategjitë dhe programet kombëtare.

3.8 Arritja e mbulimit shëndetësor universal, duke përfshirë mbrojtjen nga rreziqet financiare, aksesin të shërbimet cilësore bazë të kujdesit shëndetësor dhe akses të sigurt, efektiv, cilësor dhe të përballueshëm tek medikamentet dhe vaksinat bazë për të gjithë.

3.9 Deri në vitin 2030, zvogëlimi i ndjeshëm i numrit të vdekjeve dhe sëmundjeve nga kimikatet e rrezikshme dhe ndotja e ajrit, ujit dhe dherave.

3.a Fuqizimi i zbatimit të Konventës Kuadër të Organizatës Botërore të Shëndetësisë mbi Kontrollin e Duhanit në të gjitha vendet, sipas rastit;

3.b Mbështetja e kërkimit dhe zhvillimit të vaksinave dhe medikamenteve për sëmundjet ngjitëse dhe jo-ngjitëse që prekin kryesisht vendet në zhvillim, ofrimi i aksesit në ilaçe dhe vakcina të përballueshme, në përputhje me Deklaratën e Dohas mbi Marrëveshjen e TRIPS-it dhe Shëndetin Publik, e cila pohon të drejtën e vendeve në zhvillim që të përdorin plotësisht dispozitat e Marrëveshjes për Aspektet Tregtare të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale lidhur me fleksibilitetin për mbrojtjen e shëndetit publik dhe, në veçanti, ofrimin e aksesit në medikamente për të gjithë;

3.c Rritja e ndjeshme e financimit të shëndetësisë dhe rekrutimi, zhvillimi, trajnimi dhe mbajtja e fuqisë punëtore në sektorin e shëndetësisë në vendet në zhvillim, veçanërisht në vendet më pak të zhvilluara dhe shtetet e vogla ishullore në zhvillim;

3.d Forcimi i kapaciteteve të të gjitha vendeve, në veçanti të vendeve në zhvillim, për paralajmërimin e hershëm, zvogëlimin e rrezikut dhe menaxhimin e rreziqeve kombëtare dhe globale të shëndetit.

Raporti mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm i viti 2024 tregon se ecuria e Shqipërisë në arritjen e OZHQ3 rezulton pozitive por ende me sfida të rëndësishme për t'u përballur deri në vitin 2030. Shqipëria rezulton se i ka arritur objektivat e Agjendës 2030 për një pjesë të madhe të treguesve të monitorimit të OZHQ3, përfshirë ato të vdekshmërisë amtare, vdekshmërisë foshnjore dhe fëmijëve nën 5 vjeç, rasteve të reja me HIV etj. Për disa nga treguesit Shqipëria i ka plotësuar me kohë objektivat e Agjendës 2030, p.sh. synimi 3.1 përcakton deri në vitin 2030, uljen e raportit global të vdekshmërisë së nënave në më pak se 70 për 100,000 lindje të gjalla, ndërkohë që të dhënat tregojnë se ky tregues për Shqipërinë ka qenë nën 15 për 100,000 lindje të gjalla gjatë dekadave të fundit, ndonëse ka ende vend për përmirësime krahasuar me vendet e tjera. Raporti tregon se mbetet ende punë për t'u kryer për arritjen e objektiveve në tregues si incidenca e tuberkulozit, shkalla e vdekjeve nga ndotja e ajrit dhe aksidentet rrugore, jetëgjatësia e pritshme etj.

Kuadri thelbësor strategjik: Sistemi i fortë dhe më i aksesueshëm i kujdesit shëndetësor është pjesë e shtyllës së tretë (Kohezioni Social) të SKZHIE 2030 që synon një qasje të integruar të funksionimit në të gjitha nivelet e sistemit, duke vendosur në qendër shëndetin e qytetarëve. Tri shtylla kryesore përbëjnë vizionin 2030 për sektorin e shëndetësisë: i. Kujdes shëndetësor universal; ii. Modernizim i infrastrukturës dhe teknologjisë shëndetësore; dhe iii. Fuqizimin e burimeve njerëzore. Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021-2030 është dokumenti kryesor strategjik sektorial që shtjellon reformat dhe ecurinë e sektorit të shëndetësisë në vend deri në vitin 2030. Një numër i konsiderueshëm strategjish dhe planesh veprimi, specifike për nënsektorë dhe trajtimin e sëmundjeve të ndryshme, plotësojnë kuadrin strategjik të sektorit.

Objektivat që synohen të arrihen deri në vitin 2030 sipas treguesve globalë të OZHQ-ve janë si vijon:

3.1.1 Vdekshmëria amtare

Të dhënat tregojnë se mesatarja e këtij treguesi në Shqipëri gjatë dekadës së fundit është nën 5 për 100,000 dhe në vitin 2022 ishte zero (asnjë rast) duke rezultuar shumë më kënaqshëm se objektivi global i Agjendës 2030 (70 për 100,000). Objektivi i vitit 2030 për këtë tregues në Shqipëri është 1.5 për 100,000.

3.1.2 Përqindja e lindjeve të ndjekura nga personel i kualifikuar shëndetësor


Të dhënat tregojnë se ky tregues gjatë viteve të fundit në Shqipëri ka qenë 100% dhe objektivi për vitin 2030 është që të jetë mbi 99%.

3.2.1 Shkalla e vdekshmërisë nën 5 vjeç

Treguesi ka pasur vlerën 9 për 100,000 në fillimin e Agjendës 2030 (2015) dhe ka arritur në 7.6 në vitin 2022. Objektivi për vitin 2030 është që treguesi të mbahet nën 11 për 100,000.

3.2.2 Shkalla e vdekshmërisë foshnjore

Treguesi ka pasur vlerën 5.2 për 100,000 në fillimin e Agjendës 2030 (2015) dhe ka arritur në 4.6 në vitin 2022. Objektivi për vitin 2030 është që treguesi të mbahet nën 3.7 për 100,000.



3.3.1 Numri i infeksioneve të reja me HIV për 1000 popullsi të painfektuar, sipas gjinisë, moshës dhe popullatave kryesore

Treguesi ka pasur vlerën 0.03 në fillimin e Agjendës 2030 (2015) dhe ka arritur në 0.04 në vitin 2022. Objektivi për vitin 2030 është që treguesi të mbahet nën 0.045. Gjithashtu, synimi është që deri në 2030 të mos ketë asnjë fëmijë të lindur me HIV në Shqipëri.

3.3.2 Incidenca e tuberkulozit për 100,000 banorë

Treguesi (rastet e reja) ka pasur vlerën 14.5 në fillimin e Agjendës 2030 (2015) dhe ka arritur në 9.5 në vitin 2022. Objektivi për vitin 2030 është që treguesi të mbahet nën 10.9.

3.3.4 Incidenca e hepatitit B për 100,000 banorë

Treguesi (rastet e reja) ka pasur vlerën 2.2 në fillimin e Agjendës 2030 (2015) dhe ka arritur në 9.6 në vitin 2022. Objektivi për vitin 2030 është që treguesi të mbahet nën 14.3.

3.4.1: Shkalla e vdekshmërisë që u atribuohet sëmundjeve kardiovaskulare, kancerit, diabetit ose sëmundjeve kronike të frymëmarrjes

Objektivi për vitin 2030 është që treguesi të mbahet nën 11.7.

3.4.2 Shkalla e vdekshmërisë nga vetëvrasjet

Treguesi ka pasur vlerën 7.7 për 100,000 në fillimin e Agjendës 2030 (2015) dhe ka arritur në 6.9 në vitin 2022. Objektivi për vitin 2030 është që treguesi të zvogëlohet me 10% në vit duke arritur nën 115 raste (total).

3.5.2 Përdorimi i dëmshëm i alkoolit, i përcaktuar sipas kontekstit kombëtar si konsumi i alkoolit për frymë (të moshës 15 vjeç e lart) brenda një viti kalendarik në litra alkool të pastër

Për këtë tregues strategjia e shëndetësisë përcakton synimin që në vitin 2030 nën 15% e adoleshentëve të jenë dehur të paktën një herë gjatë jetës.

3.6.1 Shkalla e vdekjeve për shkak të aksidenteve në trafikun rrugor

Treguesi ka pasur vlerën 9.4 për 100,000 në fillimin e Agjendës 2030 (2015) dhe ka arritur në 5.9 në vitin 2022. Objektivi për vitin 2030 është që treguesi të zvogëlohet me 20% krahasuar me vitin 2022.

3.b.1 Përqindja e popullsisë e mbuluar nga të gjitha vaksinat e përfshira në programin e tyre kombëtar

Treguesi ka pasur vlerën 98.8% në fillimin e Agjendës 2030 (2015) dhe ka arritur në 95% në vitin 2022. Objektivi për vitin 2030 është që treguesi të arrijë në 98% të popullsisë. Gjithashtu, përqindja e fëmijëve që marrin të dyja dozat e vaksinës kundër fruthit sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit të jetë nga 95% (2019) në nivelin 97% (në vitin 2030).

Sfida dhe mundësi

Dinamika e ndryshimeve demografike gjatë viteve të fundit ka prodhuar ndryshime të rëndësishme të strukturës moshore të popullsisë, gjë që kërkon adresimin e duhur për ofrimin e shërbimit shëndetësor, fuqizimin e grupmoshave të ndryshme dhe promovimin e jetëgjatësisë. Ndërsa qasja në kujdesin shëndetësor është përmirësuar në vitet e fundit, ende ekzistojnë pabarazi midis zonave urbane dhe rurale. Në zonat rurale dhe të largëta, qasja në shërbime shëndetësore cilësore, përfshirë mjekët dhe teknologjinë moderne, është e kufizuar. Reduktimi i pabarazive shëndetësore është një nga sfidat kryesore në krijimin e kushteve për një nivel të lartë në cilësinë e jetës, ku do të jetë e nevojshme të përmirësohet gjendja shëndetësore e popullatës në të gjitha rajonet, veçanërisht e të moshuarve, komuniteteve të marginalizuara shoqërore dhe atyre më pak të arsimuara.

Menaxhimi i pandemisë COVID-19 vuri përballë një prove të vështirë çdo hallkë të sistemit shëndetësor, duke mundësuar, gjithashtu, përshtatjen më të mirë ndaj krizave të ngjashme që mund të shfaqen në të ardhmen, forcuar kapacitetet parandaluese, diagnostikuese dhe trajtimin sipas protokolleve më të mira shëndetësore në të gjithë strukturat publike. Modernizimi i mëtejshëm i shërbimeve dhe konsolidimi i infrastrukturës digjitale në sistemin shëndetësor përbën, gjithashtu, një domosdoshmëri për të ardhmen.

Ndërsa është bërë progres në trajtimin e disa sëmundjeve infektive, sëmundjet kronike si diabeti, hipertensioni, dhe sëmundjet kardiovaskulare janë në rritje. Menaxhimi i këtyre sëmundjeve kërkon një qasje të qëndrueshme dhe shërbime të specializuara. Shëndeti mendor mbetet një sfidë e

rëndësishme, me qasje të kufizuar në kujdesin e ndaj tij dhe një nivel të lartë stigme sociale ndaj problemeve të krijuara. Mungesa e mbështetjes dhe ndërgjegjësimit për shëndetin mendor përkeqëson gjendjen për ata që kanë nevojë për ndihmë. Megjithatë janë bërë përparime në përmirësimin e shëndetit të nënave dhe fëmijëve, ka ende sfida në sigurimin e kujdesit prenatal dhe neonatal të cilësisë së lartë, sidomos në zonat rurale.

Sistemi shëndetësor përballet me problematikën e largimit nga vendi të mjekëve dhe punonjësve shëndetësorë, në kërkim të kushteve më të mira pune jashtë vendit, duke krijuar një mungesë të burimeve njerëzore në shëndetësi. Kjo krijon një ngarkesë më të madhe për stafin e mbetur dhe ndikon në cilësinë e shërbimeve.

Institucionet më të rëndësishme të përfshira në arritjen e OZHQ3:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Ministria e Punëve të Brendshme

Instituti i Shëndetit Publik

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Ndërlidhjet më të rëndësishme në Agjendën 2030 sipas kontekstit të Shqipërisë:

OZHQ 1, 2, 4, 5, 6, 8, 10, 11, 12, 13, 15, 16, 17.

Lidhja kryesore me SKZHIE 2030:

Shtylla III: Sistem i fortë dhe më i aksesueshëm i kujdesit shëndetësor

Lidhja parësore me kapitujt e integritetit evropian:

Kapitulli 28: Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik

Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 4: Arsim cilësor

OZHQ4 ka si objektiv parësor sigurimin e arsimit përfshirës dhe të barabartë dhe promovimin e mundësive të të nxënit gjatë të gjithë jetës për të gjithë, përmes synimeve të mëposhtme:

4.1 Deri në vitin 2030, sigurimi që të gjitha vajzat dhe djemtë ta përfundojnë arsimin bazë tërësisht pa pagesë, të barabartë dhe cilësor, i cili çon në rezultate të përshtatshme dhe efektive të të nxënit.

4.2 Deri në vitin 2030, sigurimi që të gjitha vajzat dhe të gjithë djemtë të kenë akses te zhvillimi cilësor në fëmijërinë e hershme, të kujdesi dhe arsimit parashkollor, në mënyrë që të jenë gati për arsimin bazë

4.3 Deri në vitin 2030, sigurimi i aksesit të barabartë për të gjitha gratë dhe burrat në arsim të përballueshëm cilësor, teknik, profesional dhe të lartë, përfshirë universitetin

4.4 Deri në vitin 2030, rritja thelbësore e numrit të të rinjve dhe të të rriturve të cilët kanë aftësi, përfshirë aftësitë teknike dhe profesionale, për punësim, punë të denja dhe sipërmarrje

4.5 Deri në vitin 2030, zhdukja e pabarazive gjinore në arsim dhe sigurimi i aksesit të barabartë në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit profesional për personat në nevojë, përfshirë dhe personat me aftësi të kufizuara, popullsitë indigjene dhe fëmijët në situata të cënueshme

4.6 Deri në vitin 2030, sigurimi se të gjithë të rinjtë dhe një përqindje e konsiderueshme e të rriturve, gra dhe burra, arrijnë të shkruajnë, lexojnë dhe numërojnë

4.7 Deri në vitin 2030, sigurimi se të gjithë nxënësit i marrin njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm, duke përfshirë ndërmjet të tjerash, arsimin për zhvillim të qëndrueshëm dhe stile jetese të qëndrueshme, të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, promovimin e kulturës së paqes dhe mospërdorimit të dhunës, qytetarisë globale dhe vlerësimit të diversitetit kulturor, si dhe kontributit të kulturës në zhvillimin e qëndrueshëm

4.a Ndërtimi dhe përmirësimi i objekteve të arsimit që janë të ndjeshëm ndaj fëmijës, aftësive të kufizuara dhe gjinisë dhe që sigurojnë mjedise të sigurta të nxëni, jo të dhunshme, gjithëpërfshirëse dhe efektive për të gjithë

4.b Deri në vitin 2030, shtrirje domethënëse në nivel global e numrit të bursave në dispozicion të vendeve në zhvillim, në veçanti për vendet më pak të zhvilluara, shtetet e vogla ishullore në zhvillim dhe vendet afrikane, për t'u regjistruar në arsimin e lartë, duke përfshirë trajnimin profesional dhe teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, programet teknike, inxhinierike dhe shkencore, në vendet e zhvilluara dhe vendet e tjera në zhvillim

4.c Deri në vitin 2030, rritje e ndjeshme e mësuesve të kualifikuar, nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar për trajnimin e mësuesve në vendet në zhvillim, veçanërisht në vendet më pak të zhvilluara dhe shtetet e vogla ishullore në zhvillim

Raporti mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm i viti 2024 tregon se ecuria e Shqipërisë në arritjen e OZHQ4 rezulton pozitive por ende me sfida për t'u përballur deri në vitin 2030. Shqipëria rezulton se i ka arritur objektivat e Agjendës 2030 për tre nga katër treguesit e monitorimit të këtij raporti (pjesëmarrja në arsimin parashkollor, dhe ciklin e ulët, si dhe shkalla e leximit) ndërkohë që rezulton ende në nivel të ulët në pjesëmarrjen neto në arsimin bazë.

Kuadri thelbësor strategjik: Arsimi cilësor për të gjithë është komponenti i parë i shtyllës së tretë (Kohezioni Social) të SKZHIE 2030 që synon një sistem arsimor gjithëpërfshirës të bazuar në parimet e barazisë dhe mësimi gjatë gjithë jetës, që mundëson formimin cilësor të të gjithë individëve, duke kontribuar në mirëqenien personale të tyre, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian. Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe Plani i Veprimit për Zbatimin e saj, Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e saj, Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj si dhe Dokumenti i Politikave të Arsimit të Lartë 2030 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj, janë dokumentet kryesore që plotësojnë kuadrin strategjik në këtë sektor të rëndësishëm.

Objektivat që synohen të arrihen deri në vitin 2030 sipas treguesve globalë të OZHQ-ve janë si vijon:

4.b.1 Flukset zyrtare të asistencës zhvillimore për bursat sipas sektorëve dhe llojit të studimit.

Mbështetja e drejtpërdrejtë e nxënësve në arsimin parauniversitar gjatë vitit 2024 është rreth 2.3 mld lekë (transport nxënës dhe mësues 1.2 mld lekë, tekstet shkollore falas 890 mln lekë, bursa 225 mln lekë). Në po të njëjtin nivel është dhe mbështetja në arsimin e lartë (bursa, paga minimale në sektorë prioritarë, akomodimi, reduktim tarife). Vlerësohet që ky financim do të jetë në të njëjtën masë edhe në vitin 2030 pasi ndryshimi i inflacionit është i njëjtë me ndryshimin e numrit të nxënësve dhe studentëve.

4.c.1 Përqindja e mësuesve në arsimin: a) parashkollor; b) fillor; c) i mesëm i ulët; dhe d) arsimi i mesëm i lartë të cilët kanë marrë të paktën trajnimin minimal të organizuar të mësuesve (p.sh. trajnimi pedagogjik) para shërbimit ose gjatë shërbimit të kërkuar për mësimdhënie në nivelin përkatës në një vend të caktuar.

Më poshtë paraqitet përqindja e mësuesve që kanë marrë të paktën trajnimin minimal, për vitin 2023 dhe 2030:

Përqindja e mësuesve që kanë marrë të paktën trajnimin minimal		
Cikli i arsimit	2023	2030
Parashkollor	65%	80%
Fillor	60%	75%
I mesëm i ulët	65%	75%
I mesëm i lartë	65%	75%

Sfida dhe mundësi

Sistemi arsimor në Shqipëri ndodhet në epiqendër të sfidave me të cilat përballlet vendi, përfshirë ato demografike me ndryshimet e vrullshme të strukturës së popullsisë, vështirësitë e krijuara dhe mbartura nga periudha e COVID-19, nevojat për punësim dhe dinamikat e tregut të punës e orientimit drejt teknologjive të reja, dhe transformimet e mësimnxënies dhe institucioneve arsimore në vend. Një sistem arsimor i fuqizuar dhe i aftë për t'iu përgjigjur këtyre sfidave është çelësi kryesor për formimin e kapitalit njerëzor dhe të ardhmen e zhvillimit të vendit. Pabarazitë në qasjen ndaj arsimit ndërmjet zonave urbane dhe rurale përbëjnë një nga sfidat kryesore të arsimit pasi fëmijët në zonat rurale kanë shpesh më pak akses në shkolla cilësore, mësues të kualifikuar dhe burime edukative, duke përforcuar pabarazitë ekzistuese në formimin e tyre dhe cilësinë e arsimit që ata marrin.

Ndërkohë që përfshirja në arsimin fillor dhe të mesëm, është e lartë, cilësia e edukimit mbetet ende një sfida për t'u adresuar në të ardhmen. Cilësia e mësimdhënies, trajnimet e vazhdueshme për mësuesit, infrastruktura arsimore e vjetruar ose e pamjaftueshme, mungesa e ambienteve të përshtatshme, pajisjeve moderne, dhe teknologjisë ndikon negativisht në cilësinë e arsimit dhe përvojën e nxënësve, veçanërisht në zonat rurale. Qasja e kufizuar në internet, kompjuterë dhe burime të tjera teknologjike në të gjitha shkollat ndikon në hendekun digjital dhe pengon nxënësit të përgatiten për tregun e punës.

Fëmijët nga komunitetet romë dhe egjiptiane, si dhe fëmijët me aftësi të kufizuara, përballen me sfida të mëdha për të përfutur një arsim cilësor. Braktisja e shkollës mbetet një problem, veçanërisht në zonat rurale dhe në grupet e marginalizuara. Faktorët ekonomikë, socialë dhe kulturorë shpesh detyrojnë nxënësit të largohen nga shkolla, duke i privuar ata nga mundësitë për një të ardhme më të mirë.

Institucionet më të rëndësishme të përfshira në arritjen e OZHQ4:

Ministria e Arsimit

Ndërlidhjet më të rëndësishme në Agjendën 2030 sipas kontekstit të Shqipërisë:

OZHQ 1, 2, 4, 5, 8, 10.

Lidhja kryesore me SKZHIE 2030:

Shtylla III: Arsim cilësor për të gjithë

Lidhja parësore me kapitujt e integritetit evropian:

Kapitulli 26: Arsimi dhe Kultura

Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 5: Barazi gjinore

OZHQ5 ka si objektiv parësor arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave, përmes synimeve të mëposhtme:

5.1 Dhënia fund të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave kudo;

5.2 Zhdukja e të gjitha formave të dhunës kundër të gjitha grave dhe vajzave në sferat publike dhe private, duke përfshirë trafikimin, shfrytëzimin dhe llojet e tjera të shfrytëzimit;

5.3 Zhdukja e praktikave të dëmshme, të tilla si martesat e hershme të fëmijëve dhe ato me detyrim, dhe gjymtimi gjenital i femrave;

5.4 Njohja dhe vlerësimi i kujdesit të papaguar dhe punës në shtëpi nëpërmjet ofrimit të shërbimeve publike, infrastrukturës dhe politikave të mbrojtjes sociale, dhe promovimi i përgjegjësisë të përbashkëta brenda banesës sipas specifikave kombëtare;

5.5 Sigurimi i pjesëmarrjes së plotë dhe efektive të grave dhe mundësive të barabarta në pozicione drejtuese në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike;

5.6 Sigurimi i aksesit universal në shëndetin seksual dhe riprodhues dhe të drejtat riprodhuese, siç është rënë dakord me Programin e Masave të Konferencës Ndërkombëtare mbi Popullsinë dhe

Zhvillimin dhe Platformën e Pekinit për Veprim dhe dokumentet e rezultateve të konferencave për rishikimin e tyre;

5.a Kryerja e reformave për t'u dhënë grave të drejta të barabarta mbi burimet ekonomike, si dhe akses te pronësia dhe kontrolli mbi tokën dhe format e tjera të pronës, te shërbimet financiare, trashëgimia dhe burimet natyrore, në përputhje me ligjet kombëtare;

5.b Rritja e përdorimit të teknologjisë mundësuese, në veçanti e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, për të promovuar fuqizimin e grave;

5.c Miratimi dhe forcimi i politikave të shëndosha dhe legjislacionit detyrues për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave në të gjitha nivelet.

Raporti mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm i vitit 2024 tregon se me gjithë progresin e arritur, Shqipëria ka ende sfida të rëndësishme për t'u përballur në arritjen e OZHQ5 deri në vitin 2030. Raporti tregon se Shqipëria rezulton se i ka arritur objektivat e Agjendës 2030 për pjesëmarrjen e femrave në tregun e punës, krahasuar me meshkujt, por në tre tregues të rëndësishëm – numri i grave deputete, raporti meshkuj/femra sipas arsimimit dhe përqindja e femrave që përdorin mjete moderne të planifikimit familjar, rezulton ende e ulët krahasuar me objektivin 2030. Sidoqoftë, angazhimi i vajzave dhe grave në punët e shtëpisë i vendos ato në pozita jo të barabarta me meshkujt, sikurse dhe rezultatet pozitive në treguesit e arsimimit të tyre, jo detyrimisht përkthehen në pjesëmarrje më të lartë e aktive në të gjithë sektorët e ekonomisë.

Shqipëria ka bërë progres të rëndësishëm në zhvillimin e politikave dhe legjislacionit që synojnë promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave. Megjithatë, mbeten ende sfida në realizimin e plotë të potencialit të treguesit OZHQ 5.c. Është krijuar një kuadër ligjor i fortë, duke përfshirë buxhetimin gjinor dhe përpjekjet për të harmonizuar politikat kombëtare me konventat ndërkombëtare si CEDAW. Pavarësisht këtij progresi, zbatimi i këtyre politikave shpesh ndeshet me kufizime institucionale dhe burimore, duke kufizuar efektivitetin e tyre në nivele të ndryshme të qeverisjes. Shqipëria renditet ndër të paktat vende që ndjekin Treguesin OZHQ 5.c.1, sipas bazës së të dhënave të OZHQ. Megjithatë, nevojiten veprime të mëtejshme për të forcuar sistemet e monitorimit dhe zbatimit për të siguruar që politikat e barazisë gjinore të financohen vazhdimisht dhe të zbatohen në mënyrë efektive në të gjithë sektorët.

Veçanërisht njohja dhe vlerësimi i kujdesit të papaguar dhe punës shtëpiake është thelbësor për arritjen e OZHQ 5.4. Veprimet duhet të fokusohen në zhvillimin e shërbimeve publike dhe infrastrukturës që mbështesin rolet e kujdesit, së bashku me politikat e mbrojtjes sociale që promovojnë përgjegjësitë e përbashkëta brenda familjeve. Kjo përfshin rritjen e aksesit në kujdesin e përballueshëm të fëmijëve dhe promovimin e politikave miqësore me familjen për të lehtësuar barazinë gjinore në përkujdesje. Përpjekjet duhet të synojnë të rrisin ndërgjegjësimin për vlerën ekonomike të punës së papaguar, duke nxitur një zhvendosje kulturore drejt përgjegjësisë të përbashkëta të brendshme.

Kuadri thelbësor strategjik: SKZHIE 2030 e trajton barazinë gjinore në kuadër të shtyllës së tretë (Kohezioni social), nën fuqizimin e mbrojtjes shoqërore dhe sigurimeve shoqërore, duke synuar një shoqëri e cila vlerëson barazinë dhe drejtësinë gjinore si kushte të domosdoshme drejt zhvillimit të qëndrueshëm social, ekonomik e politik të vendit, fuqizon të gjithë individët për të gëzuar të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës, nuk lejon që askush të mbetet pas, si dhe mbështetet në parimin e tolerancës zero kundër praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, duke ndëshkuar dhunuesit dhe duke mbrojtur, rehabilituar e riintegruar personat e dhunuar. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 është dokumenti kryesor strategjik që pasqyron politikat mbi barazinë gjinore deri në vitin 2030 përmes katër qëllimeve parësore: i. Përmbytja e të drejtave ekonomike dhe sociale nga të gjitha grupet; ii. Përmbytja e të drejtave të

të gjitha grupeve, për pjesëmarrje, përfaqësim dhe udhëheqje të barabartë në vendimmarrjen politike e publike; iii. Zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje; dhe iv. zbatimi i integritetit gjinor si mjeti kryesor për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore në shoqëri.

Objektivat që synohen të arrihen deri në vitin 2030 sipas treguesve globalë të OZHQ-ve janë si vijon:

5.2.1 Përqindja e grave dhe vajzave partnere të moshës 15 vjeç e lart, që kanë pësuar dhunë fizike, seksuale ose psikologjike nga një partner aktual ose ish-partner në 12 muajt e fundit, sipas formës së dhunës dhe moshës

Objektivi për vitin 2030 për këtë tregues është reduktimi me 5 për qind i rasteve.

5.3.1 Përqindja e grave të moshës 20–24 vjeç të martuara ose në një bashkim para moshës 15 dhe para moshës 18 vjeç


Objektivi për vitin 2030 për këtë tregues është 0 raste.

5.4.1 Përqindja e kohës së shpenzuar në punë të papaguar në shtëpi dhe përkujdesje, sipas gjinisë, moshës dhe vendndodhjes

Objektivi për vitin 2030 për këtë tregues është 7 për qind e kohës (1.41 orë/ditë) për meshkujt dhe 17.7 për qind (4.15 orë/ditë) për gratë.

5.5.2 Përqindja e grave në poste drejtuese

Objektivi për vitin 2030 për këtë tregues është 35 për qind.



5.c.1 Përqindja e vendeve me sisteme për të gjurmuar buxhetim publik për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave

Shqipëria kryen buxhetimin publik mbi bazë barazinë gjinore në nivel qendror që nga viti 2016 dhe në nivel lokal që nga viti 2017, ndaj ky tregues do të vazhdojë të raportohet si i tillë nga Ministria e Financave.

Sfida dhe mundësi

Me gjithë problematikën e pasqyruar në Raportin mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm të vitit 2024, indeksi i Barazisë Gjinore e rendit Shqipërinë më mirë se mesatarja e anëtarëve të BE-së pasi zbatimi i kuotave gjinore ka rezultuar në një rritje të ndjeshme të përfaqësimit të grave në jetën politike dhe vendimmarrje, edhe pse ky proces duhet të shtrihet në të gjitha nivelet e drejtimit. Në legjislaturën 2021–2025, gratë zënë 50 mandate nga 140 gjithsej, ose 35.7 për qind, kryetarja e Kuvendit 1 grua; nënkryetare/nënkryetarë 1 grua dhe 1 burrë; nga 8 Komisione të Përhershme gjithsej 4 ose 50 për qind drejtohen nga gra; Këshilli i Ministrave aktualisht drejtohet nga: 1 Kryeministër burrë, 1

zëvendëskryeministre grua dhe përbëhet nga 17 ministre/ministër nga të cilët 9 gra. Shqipëria renditet, gjithashtu, si ndër vendet më të suksesshme në botë në promovimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në institucionet publike. Për të formuluar politika të efektshme dhe monitoruar progresin drejt barazisë gjinore, nevojiten statistika gjinore të besueshme dhe të përditësuara.

Dhuna me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje, është ende një problem, shpesh jo i raportuar sa duhet për shkak të frikës, stigmatizimit, dhe mungesës së besimit në institucionet ligjore. Shërbimet mbështetëse për viktimat e dhunës janë të kufizuara, veçanërisht në zonat rurale. Gratë në Shqipëri shpesh përballen me diskriminim në tregun e punës, duke u paguar më pak për të njëjtën punë dhe duke pasur më pak mundësi për pozita drejtuese. Normat dhe stereotipat gjinore tradicionale janë të mbrujtura në shoqërinë shqiptare dhe ndikojnë në ndarjen e punëve në familje, qasjen në edukim, dhe mundësitë për zhvillim personal dhe profesional për gratë dhe vajzat. Edukimi dhe ndërgjegjësimi i shoqërisë janë, gjithashtu, thelbësore për të krijuar një kulturë të shëndetshme të barazisë gjinore.

Pavarësisht progresit të arritur, përjashtimi me bazë gjinore mbetet problematik për shumicën e vajzave dhe grave në Shqipëri, veçanërisht në arsimim, punësim dhe pjesëmarrjen e fuqisë punëtore, aksesin dhe kontrollin e burimeve duke përfshirë tokën, apo ekzistencën e dhunës ndaj grave dhe vajzave si dhe aksesin e tyre në sistemin e drejtësisë. Përjashtimi është edhe më i theksuar në pronësinë e tokës (lidhur me OZHQ 5.a), ndërkohë që bujqësia është burimi kryesor i punësimit për gratë (41.6% krahasuar me 32.3% meshkuj). Në këtë kuadër është i nevojshëm koordinimi mes institucioneve të përfshira në monitorimin e treguesve mbi të drejtat e pronësisë (MBZHR, MD, MSHCS, INSTAT) dhe bashkëpunimi i ngushtë me organizatat, si FAO për përcaktimin e përgjegjësisë institucionale mbi monitorimin e këtyre treguesve (5.a.1 dhe 5.a.2).

Institucionet më të rëndësishme të përfshira në arritjen e OZHQ5:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Ministria e Financave

Ministria e Drejtësisë

Ministria e Punëve të Brendshme

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

INSTAT

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore

Bashkitë

Ndërlidhjet më të rëndësishme në Agjendën 2030 sipas kontekstit të Shqipërisë:

OZHQ 1, 2, 3, 4, 8, 10, 15, 16, 17.

Lidhja kryesore me SKZHIE 2030:

Shtylla III: Fuqizimi i mbrojtjes shoqërore dhe sigurimeve shoqërore

Lidhja parësore me kapitujt e integritetit evropian:

Kapitulli 19: Politikat Sociale dhe të Punësimit

Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 6: Ujë i pastër dhe kanalizime

OZHQ6 ka si objektiv parësor sigurimi e aksesit në furnizimin me ujë dhe kanalizime për të gjithë, përmes synimeve të mëposhtme:

6.1 Deri në vitin 2030, arritja universale e aksesit të drejtë, të sigurt dhe të përballueshëm për të gjithë tek uji i pijshëm

6.2 Deri në vitin 2030, arritja e aksesit të shërbimet sanitare dhe higjiena e përshtatshme dhe e barabartë për të gjithë dhe zhdukja e defekimit të hapur, duke u kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të grave dhe vajzave dhe atyre në nevojë

6.3 Deri në vitin 2030, përmirësimi i cilësisë së ujit duke ulur ndotjen, duke ndaluar hedhjen e mbetjeve në mënyrë të pakontrolluar dhe minimizimi i çlirimit të kimikateve dhe materialeve të rrezikshme, duke përgjysmuar përqindjen e ujërave të zeza të patrajuara dhe duke rritur ndjeshëm riciklimin dhe ripërdorimin e sigurt në nivel global

6.4 Deri në vitin 2030, rritje në mënyrë të ndjeshme e efikasitetit në përdorimin e ujit në të gjithë sektorët, dhe sigurimi i nxjerrjes dhe furnizimit të qëndrueshëm të ujërave të ëmbla për të zgjidhur mungesën e ujit dhe për të zvogëluar ndjeshëm numrin e njerëzve që vuajnë nga mungesa e ujit

6.5 Deri në vitin 2030, zbatimi i menaxhimit të integruar të burimeve ujore në të gjitha nivelet, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkuftar sipas nevojës

6.6 Deri në vitin 2030, mbrojtje dhe rirregullim i ekosistemeve të lidhura me ujin, duke përfshirë malet, pyjet, ligatinat, lumenjtë, ujëmbledhësit dhe liqenet

6.a Deri në vitin 2030, zgjerimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe mbështetja për ndërtimin e kapaciteteve për vendet në zhvillim në aktivitetet dhe programet e lidhura me ujin dhe kanalizimet, duke përfshirë mbledhjen e ujit, shkripëzimin, përdorimin efikas të ujit, trajtimin e ujërave të zeza, riciklimin dhe teknologjitë e ripërdorimit

6.b Mbështetje dhe forcim i pjesëmarrjes së komuniteteve lokale për përmirësimin e menaxhimit të ujit dhe kanalizimeve


Raporti mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm i vitit 2024 tregon se me gjithë progresin e arritur, Shqipëria ka ende sfida të rëndësishme për t'u përballur në arritjen e OZHQ6 deri në vitin 2030. Raporti tregon se Shqipëria rezulton se i ka arritur objektivat e Agjendës 2030 për treguesit e stresit të përdorimit të ujit (*freshwater withdrawal*) dhe pajisjes me sisteme sanitare të popullsisë, por ka ende sfida për të arritur objektivin 2030 në treguesit e furnizimit me ujë të pijshëm dhe varësisë nga importet, ndërsa mbetet ende prapa objektivit për sa i përket trajtimit të ujërave të ndotura.

Kuadri thelbësor strategjik: SKZHIE 2030 e trajton furnizimin me ujë dhe kanalizimet si pjesë e veçantë e shtyllës së dytë (Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ndërlidhjen dhe rritjen e gjelbër), duke synuar furnizimin me ujë, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura që plotëson nevojat për zhvillimin ekonomik dhe të shoqërisë në tërësi, duke ruajtur dhe mbrojtur mjedisin, shëndetin dhe sigurinë e popullsisë. Strategjia Kombëtare e Ujësijellës Kanalizimeve 2023 – 2030 është dokumenti kryesor strategjik i sektorit që detajon në politika konkrete vizionin e mësipërm. Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018–2027 paraqet politikat për menaxhimin e burimeve ujore në vend. Përmbushja e nevojave bazë të jetesës, konkurrueshmëria e përdorueseve dhe vendosja e përparësive drejt përfitimit ekonomik, duke marrë në konsideratë qëndrueshmërinë e ekosistemeve, përbëjnë thelbin e vizionit 2030 për sektorin.

Objektivat që synohen të arrihen deri në vitin 2030 **sipas treguesve globalë të OZHQ-ve janë si vijon:**

6.1.1 Përqindja e popullsisë që përdor shërbimet e ujit të pijshëm të menaxhuar në mënyrë të sigurt

Bazuar në strategjinë sektoriale, ky tregues parashikohet të arrijë në 90% në vitin 2030 (99% në zonat urbane dhe 85% në zonat rurale)



6.2.1 Përqindja e popullsisë që përdor: a) shërbime higjienike të menaxhuara në mënyrë të sigurt; dhe b) një strukturë për larjen e duarve me sapun dhe ujë.

Treguesi (b) nuk është domethënës për kontekstin e Shqipërisë, ndërsa ai (a) synohet të realizohet në vlerën 65.5% deri në vitin 2030.

6.3.2 Përqindja e trupave ujqorë me cilësi të mirë të ujit të ambientit

Treguesi do të jetë në masën 100% në vitin 2030

6.4.1 Ndryshimi në efikasitetin e përdorimit të ujit me kalimin e kohës

Synimi është që treguesi të arrijë në 60% në vitin 2027.

6.4.2 Niveli i stresit ujqor: tërheqja e ujqorave të ëmbla si pjesë e burimeve të disponueshme të ujqorave të ëmbla

Synimi është që treguesi të arrijë në 40% në vitin 2027.

6.5.1 Shkalla e menaxhimit të integruar të burimeve ujqore

Strategjia përcakton se 100% e burimeve ujqore do të kenë menaxhim të integruar në vitin 2030.

6.5.2 Përqindja e zonës ndërkufitare të basenit me një marrëveshje operacionale për bashkëpunimin ujqorë

Në vitin 2030 të gjitha basenet ndërkufitare (100%) do të menaxhohen përmes marrëveshjeve operacionale për bashkëpunimin ujqor.

Sfida dhe mundësi

Qëndrueshmëria e sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, efienca e operatorëve publikë, përputhshmëria e operimit me modelin rregullator evropian, përballueshmëria e çmimeve për shërbimet e ofruara dhe transparenca në hartimin dhe zbatimin e politikave të ujit janë parimet kryesore të funksionimit të sistemit deri në vitin 2030. Me gjithë progresin në rritjen e qasjes në ujë të pijshëm, ende ekzistojnë sfida, veçanërisht në zonat rurale ku komunitetet kanë akses të kufizuar në ujë të sigurt dhe të pastër, gjë që rrit rrezikun për sëmundje të lidhura me ujin. Një pjesë e ujqorave të ndotura nga aktivitetet urbane, bujqësore dhe industriale derdhen pa trajtimin e duhur në ekosisteme ujqore, duke ndotur burimet dhe rrezikuar ekosistemet, shëndetin e njeriut, biodiversitetin dhe përdorimin e qëndrueshëm të këtyre burimeve në të ardhmen.

Ndryshimet klimatike po ndikojnë në disponueshmërinë dhe cilësinë e burimeve ujqore në Shqipëri. Përmbytjet, thatësitat dhe ndryshimet në modelet e reshjeve janë sfida të reja që kërkojnë adaptim

dhe menaxhim të qëndrueshëm të burimeve ujore. Ndërgjegjësimi për rëndësinë e kursimit të ujit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve ujore është thelbësor për të ardhmen.

Adresimi i problematikës ekzistuese, dinamikat e zhvillimit të vendit me fokus të veçantë në sektorin e turizmit, efektet afatgjata të ndryshimeve klimatike si dhe kostot e konsiderueshme për investimet në sistem përbëjnë sfidat kryesore me të cilat përballlet sektori në vitet në vijim.

Institucionet më të rëndësishme të përfshira në arritjen e OZHQ6:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Agjencia Kombëtare Ujësjellës Kanalizime

Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore

Enti Rregullator i Ujit

Ndërlidhjet më të rëndësishme në Agjendën 2030 sipas kontekstit të Shqipërisë:

OZHQ 1, 3, 5

Lidhja kryesore me SKZHIE 2030:

Shtylla III: Furnizimi me ujë dhe kanalizimet

Lidhja parësore me kapitujt e integritetit evropian:

Kapitulli 27 Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike

Objekti i Zhvillimit të Qëndrueshëm 7: Energji e përbalueshme dhe e pastër

OZHQ7 ka si objektiv parësor sigurimi e furnizimit me energji me kosto të përbalueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë, përmes synimeve të mëposhtme:

7.1 Deri në vitin 2030, sigurimi i aksesit universal në shërbime energjie me kosto të përbalueshme, të besueshme dhe moderne;

7.2 Deri në vitin 2030, rritja e ndjeshme e përqindjes së energjisë së rinovueshme në sasinë globale të energjisë;

7.3 Deri në vitin 2030, dyfishimi i nivelit global të përmirësimit të përdorimit të energjisë me efektshmëri;

7.a Deri në vitin 2030, rritje e bashkëpunimit ndërkombëtar për mundësimin e aksesit në kërkime dhe teknologji për energji të pastër, përfshirë energjinë e rinovueshme, dhe promovim i investimeve në infrastrukturën energjetike dhe teknologjinë për prodhimin e energjisë së rinovueshme;

7.b Deri në vitin 2030, zgjerimi i infrastrukturës dhe përmirësimi i teknologjisë për furnizimin me shërbime energjetike moderne dhe të qëndrueshme për të gjitha vendet në zhvillim, në veçanti për vendet më pak të zhvilluara, shtetet e vogla ishullore në zhvillim dhe vendet në zhvillim pa dalje në det në përputhje me programet përkatëse të mbështetjes.

Sipas Raportit mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm të vitit 2024, Shqipëria thuhet se ka arritur synimet 2030 për OZHQ7 ndonëse ka pak sfida për t'u përballur deri në përfundim të Agjendës 2030. Raporti tregon se Shqipëria rezulton se i ka arritur objektivat e Agjendës 2030 për tre tregues të rëndësishëm të OZHQ7, pjesën e popullsisë që përdor energjinë elektrike, emetimet e CO₂ për energjinë elektrike të prodhuar dhe pjesa e energjive të rinovueshme në konsumin total të energjisë. Mbetet ende për t'u arritur plotësisht treguesi i përqindjes së popullsisë që përdor për gatim lëndë djegëse të pastra dhe teknologji.


Kuadri thelbësor strategjik: SKZHIE 2030 e trajton energjinë së bashku me burimet natyrore si pjesë të shtyllës së dytë (Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ndërlidhjen dhe rritjen e gjelbër), që e konsideron sistemin e burimeve kombëtare të energjisë të aftë për të përmbushur kërkesën vendëse për energji që funksionon në një sistem rajonal të integruar dhe të diversifikuar të energjisë bazuar në parimet e tregut, dhe kontribuon për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë, duke garantuar sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, mbrojtjen e mjedisit dhe veprimet klimatike, dhe

rritjen e mirëqenies me kosto sociale minimale. Strategjia Kombëtare e Energjisë 2021-2030 shtjellon në detaje reformat që do të kryhen për të rritur sigurinë e furnizimit me burime energjetike dhe optimizimin e burimeve për mbulimin e nevojave me synim kryesor zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë për të ardhmen. Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën 2021-2030 përcakton objektivin kombëtar të reduktimit të Gazeve me Efekt Serë deri në vitin 2030 në përputhje me NDC.

Objektivat që synohen të arrihen deri në vitin 2030 **sipas treguesve globalë të OZHQ-ve janë si vijon:**

7.1.1 Përqindja e popullsisë me akses në energji elektrike

Objektivi për këtë tregues është që në vitin 2030 e gjithë popullsia të ketë akses në përdorimin e energjisë elektrike (100%).



7.2.1: Pjesa e energjisë së rinovueshme në konsumin total të energjisë

Synimi për këtë tregues është që në vitin 2030 energjia e rinovueshme të përbëjë 54% të energjisë që konsumohet në vend.

Sfida dhe mundësi

Politika energjetike mbështet stimulimin e diversifikimit të prodhimit të energjisë përmes investimeve të reja, rritjes së bashkëpunimit rajonal dhe integrimit dhe ndërlidhjes me rrjetet rajonale dhe Evropiane të energjisë elektrike dhe gazit natyror në përputhje me *acquis* të Traktatit të Komunitetit të Energjisë duke synuar: i. mbështetje për zhvillimin ekonomik; ii. rritjen e sigurisë së furnizimit me energji; iii. mbrojtjen e mjedisit. Energjia e rinovueshme, veçanërisht e ndryshme nga ajo hidro, është një zgjidhje për uljen e varësisë strategjike nga importet e energjisë dhe zbutjen e ndikimit të ndryshimeve klimatike që rezultojnë në prodhimin sezonal nga hidrocentralet. Suksesi i investimeve private në prodhimin e energjisë së rinovueshme, veçanërisht në PV dhe hidrocentrale mbështet zhvillimin e potencialit të lartë energjetik që Shqipëria zotëron, duke ndihmuar punësimin dhe fuqizimin e pavarësisë energjetike të vendit në të ardhmen.

Varësia e lartë nga burimet hidroenergjetike për prodhimin e energjisë elektrike e bën vendin të ndjeshëm ndaj ndryshimeve klimatike, të cilat mund të ndikojnë ndjeshëm në furnizimin me energji elektrike. Për të përmbushur OZHQ7, Shqipëria duhet të diversifikojë edhe më shumë burimet e energjisë duke investuar më shumë në burimet e rinovueshme, si energjia diellore dhe ajo e erës.

Përvoja e krizës energjetike me nisjen e agresionit në Ukrainë tregoi se përballueshmëria e energjisë është një sfidë e vazhdueshme, sidomos në periudhat e rritjes së çmimeve globale të energjisë, nga të cilat Shqipëria mbetet e varur. Infrastruktura energjetike, përfshirë rrjetin e

shpërndarjes dhe transmetimit të energjisë, ka nevojë për modernizim për të minimizuar humbjet e energjisë dhe ndërprerjet e furnizimit, duke ndikuar në cilësinë e shërbimeve të sektorit.

Progresi i arritur në zhvillimin e energjive të rinovueshme do të shoqërohet me krijimin e një tregu të qëndrueshëm dhe tërheqës për investitorët në këtë fushë, gjë që do të mundësojë zhvillimin e tregut dhe rritjen e investimeve. Kuadri rregullator dhe politikat mbështetëse që nxisin investimet në burime energjie të rinovueshme do të ndërtohen mbi bazën e parimeve të tregut evropian të energjisë.

Institucionet më të rëndësishme të përfshira në arritjen e OZHQ7:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Agjencia Kombëtare Burimeve Natyrore

Agjencia për Eficiencën e Energjisë

Enti Rregullator i Energjisë

Ndërlidhjet më të rëndësishme në Agjendën 2030 sipas kontekstit të Shqipërisë:

OZHQ 1

Lidhja kryesore me SKZHIE 2030:

Shtylla III: Energjia dhe burimet natyrore

Lidhja parësore me kapitujt e integritetit evropian:

Kapitulli 15: Energjia

Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 8: Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike

OZHQ8 ka si objektiv parësor nxitjen e rritjes ekonomike të pandërprerë, përfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimit të plotë e produktiv dhe punës së denjë për të gjithë, përmes synimeve të mëposhtme:

8.1 Mbështetja e rritjes ekonomike për frymë në përputhje me rrethanat kombëtare dhe, në veçanti, sigurimi i të paktën 7 për qind rritjeje vjetore të produktit të brendshëm bruto në vendet më pak të zhvilluara;

8.2 Arritja e niveleve më të larta të produktivitetit ekonomik, nëpërmjet diversifikimit, modernizimit të teknologjisë dhe novacionit, dhe nëpërmjet vëmendjes ndaj sektorëve me vlerë të lartë të shtuar dhe punë intensive;

8.3 Nxitja e politikave të orientuara nga zhvillimi, që mbështesin veprimtaritë produktive, krijimin e punës së denjë, sipërmarrjen, krijimtarinë dhe novatorizmin, si dhe nxisin formalizimin dhe rritjen e NMVM-ve, edhe nëpërmjet aksesit në shërbime financiare;

8.4 Përmirësimi në mënyrë progresive, deri në vitin 2030, i efektshmërisë globale të burimeve për konsum dhe prodhim, dhe përpjekja për të ndarë rritjen ekonomike nga degradimi i mjedisit, në përputhje me Kuadrin 10-vjeçar të Programeve të Konsumit dhe Prodhimit të Qëndrueshëm, ku drejtimin e marrin vendet e zhvilluara;

8.5 Deri në vitin 2030, arritja e punësimit produktiv dhe punës së denjë për të gjitha gratë dhe burrat, përfshirë të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe paga e barabartë për punë me vlerë të barabartë;

8.6 Deri në vitin 2030, zvogëlimi i ndjeshëm i përqindjes së të rinjve që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin arsimim ose trajnim;

8.7 Marrje e masave të menjëhershme dhe efektive për të zhdukur punën e detyruar, për t'i dhënë fund skllavërisë moderne dhe trafikimit të qenieve njerëzore dhe për të siguruar ndalimin dhe zhdukjen e formave më të këqija të punës së fëmijëve, duke përfshirë rekrutimin dhe përdorimin e fëmijëve si ushtarë dhe, deri në vitin 2025, eliminimin e punës së fëmijëve në të gjitha format e saj;

8.8 Mbrojtja e të drejtave në punë dhe nxitja e mjediseve të sigurta e të siguruara të punës për të gjithë punonjësit, përfshirë punonjësit migrantë, veçanërisht, për gratë migrante dhe ato me punësim të pasigurt;

8.9 Deri në vitin 2030, hartimi dhe zbatimi i politikave për promovimin e turizmit të qëndrueshëm që krijon vende pune dhe promovon kulturën dhe produktet vendëse;

8.10 Forcimi i kapaciteteve të institucioneve financiare të brendshme për të inkurajuar dhe zgjeruar aksesin në shërbimet bankare, shërbimet e sigurimeve dhe ato financiare për të gjithë;

8.a Rritja e Ndhmës për mbështetjen e Tregtisë për vendet në zhvillim, në veçanti vendet më pak të zhvilluara, nëpërmjet Kuadrit të Integruar për Ndhmën Teknike të Tregtisë për Vendet më Pak të Zhvilluara;

8.b Deri në vitin 2030, zhvillimi dhe funksionalizimi i një strategjie globale për punësimin e të rinjve dhe zbatimin e Paktit Global të Punës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

OZHQ8 është një ndër 3 objektivat për të cilat Raporti mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm i vitit 2024 tregon se Shqipëria ka sfida të konsiderueshme për të përmbushur në arritjen e tyre deri në vitin 2030. Raporti tregon se Shqipëria rezulton se i ka arritur objektivat e Agjendës 2030 për dy tregues të OZHQ8, rritjen ekonomike dhe numrin e aksidenteve në punë të lidhura me importet në vend. Por nga ana tjetër raporti tregon se mbeten ende shumë sfida për arritjen e treguesve si numri i personave me llogari bankare apo që kryejnë transferta *online*, shkalla e papunësisë, apo sigurimi i plotë i të drejtave themelore në punë.

Kuadri thelbësor strategjik: OZHQ8 shtrihet në një spektër më të gjerë fushash por punësimi i denjë për të gjithë është objekti parësor. Rritja e mundësive të punësimit është pjesë e shtyllës së dytë (Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ndërlidhjen dhe rritjen e gjelbër) së SKZHIE 2030, që synon punësim cilësor dhe aftësim të vijueshëm për të gjithë duke u fokusuar në zhvillimin e aftësive dhe lidhje më e mirë e kërkesës me ofertën në tregun e punës për punësim më të lartë, dhe mundësimin e punësimit të denjë nëpërmjet zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse të tregut të punës. Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030 plotëson kuadrin strategjik mbi punësimin, duke detajuar politikat dhe reformat që do të kryhen deri në vitin 2030.

Objektivat që synohen të arrihen deri në vitin 2030 **sipas treguesve globalë të OZHQ-ve janë si vijon:**

8.1.1 Norma vjetore e rritjes së PBB-së reale për frymë

SKZHIE 2030 përcakton se Shqipëria do të synojë të mbajë një rritje reale vjetore të PBB-së prej 4% deri në vitin 2030.

8.3.1 Përqindja e punësimit informal në punësimin jo-bujqësor, sipas gjinisë


Sipas gjinisë, shkalla e punësimit informal në punësimin jo-bujqësor në vitin 2030 synohet të arrijë në 29.6% për meshkujt dhe 18.2% për femrat.

8.5.2 Shkalla e papunësisë, sipas gjinisë, moshës dhe personave me aftësi të kufizuara

Synimi për vitin 2030 është që shkalla e papunësisë së të rinjve të grup-moshës 15-24 vjeç të jetë nga 24.5% në vitin 2023 në 22% në vitin 2026 dhe 18.3% në vitin 2030. Sipas gjinisë, për këtë kategori, shkalla e papunësisë së të rinjve meshkuj do të zvogëlohet nga 22.7% në vitin 2023, në 17.5% në vitin 2030, ndërsa për të rejat, shkalla e papunësisë do të zvogëlohet nga 27.2% në vitin 2023, në 20.5% në vitin 2030.

8.6.1 Përqindja e të rinjve (të moshës 15–24 vjeç) jo në arsim, punësim ose trajnim

Synimi për vitin 2030 është që treguesi të ulet nga vlera e fillimit të Agjendës 2030 duke u ulur në 15%.



8.9.1 PBB-ja direkte e turizmit në raport me PBB-në totale dhe në normën e rritjes

Projeksioni i kontributit të turizmit në PBB në vitin 2030, sipas SKZHIE 2030 synohet të arrijë në vlerën 24%.

Sfida dhe mundësi

Shkalla e papunësisë në tremujorin e katërt të vitit 2025 është 8.3%, nivel i cili konsiderohet më i ultë në vitet e fundit, me një rënie të konsiderueshme. Që nga viti 2020, niveli i papunësisë ka rënë me 3.2 pikë përqindje. Për arsye të arritjes së nivelit më të ulët historik të papunësisë, ky tregues nuk mund të konsiderohet si sfidë, por si një rezultat pozitiv që duhet të vijojë të përmirësohet në vitet në vazhdim. Referuar të dhënave më të fundit nga INSTAT-i, niveli i papunësisë së të rinjve të moshës 15-24 vjeç është ulur ndjeshëm që nga viti 2021, konkretisht nga 27.1% në vitin 2021 në 22.8% në vitin 2024. Megjithatë shkalla e punësimit është përmirësuar në vitet e fundit ajo mbetet pas mesatares së Bashkimit Evropian. Niveli i papunësisë së të rinjve të moshës 15–24 vjeç është ulur ndjeshëm që nga viti 2021, konkretisht nga 27.1% në vitin 2021 në 22.8% në vitin 2024. Ndryshimet demografike, migrimi jashtë vendit, rritja e moshës së popullsisë dhe rënia e lindjeve të reja përbëjnë sfida të rëndësishme edhe për funksionimin e tregut të punës në vend. Po kështu, pabarazia gjinore në punësim mbetet problematike, pasi sipas të dhënave të INSTAT-it, hendeuku gjinor në punësim në vitin 2024 është 12.5%. Po kështu, ekonomia informale përbën një pjesë të konsiderueshme të ekonomisë shqiptare dhe punësimi në sektorin informal shpesh është i pasigurt dhe i pambrojtur, me mungesë të të drejtave të punës dhe mbrojtjes sociale duke ndikuar negativisht në produktivitetin e punës dhe në rritjen ekonomike të qëndrueshme.

Përmirësimi i aftësive për punë dhe inovacioni është një nga tri shtyllat për fuqizimin e konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare, së bashku me përmirësimin e klimës së biznesit dhe investimeve, dhe funksionimin e një mbrojtjeje efektive sociale. Sektorët e turizmit, teknologjisë së informacionit, energjisë dhe bujqësisë mundësojnë punësim më të vrullshëm për shqiptarët dhe ku niveli i produktivitetit krijon premisa për rritje të nivelit të mirëqenies së qytetarëve përmes investimeve dhe zhvillimit të sektorit privat, është e nevojshme që tek aftësimi i të rinjve dhe të rejave, si dhe atyre të angazhuar në punë t'u paraprijë kërkesave që këta sektorë do të kenë për tregun e punës në përputhje me stadin e zhvillimit të tyre.

Garancia Rinore, si program i posaçëm që zbatohet në Shqipëri sipas modelit të suksesshëm në shtetet e BE-së dhe Ballkanin Perëndimor, synon të mbështesë integrimin e të rinjve në tregun e punës, me fokus të veçantë në grupet e të rinjve nga shtresat në nevojë. Skema e Garancisë Rinore

mbështet të rinjtë e papunë, të cilët aplikojnë për t'u bërë pjesë e Garancisë Rinore përmes *e-Albania*, të marrin nga zyrat e punës, brenda një periudhe 4-mujore, një ofertë cilësore për punësim, arsim apo trajnim profesional.

Institucionet më të rëndësishme të përfshira në arritjen e OZHQ8:

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

Ministria e Arsimit

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Agjencia Kombëtare e Rinisë

Ndërlidhjet më të rëndësishme në Agjendën 2030 sipas kontekstit të Shqipërisë:

OZHQ 1, 2, 3, 4, 5, 10, 12, 16, 17

Lidhja kryesore me SKZHIE 2030:

Shtylla III: Rritja e mundësive të punësimit

Lidhja parësore me kapitujt e integritimit evropian:

Kapitulli 19: Politikat Sociale dhe të Punësimit

Kapitulli 20: Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale

Objekti i Zhvillimit të Qëndrueshëm 9: Industria, inovacioni dhe infrastruktura

OZHQ9 ka si objektiv parësor ndërtimin e një infrastrukture rezistuese, promovimin e industrializimit të qëndrueshëm dhe të inovacionit, përmes synimeve të mëposhtme:

9.1 Zhvillimi i një infrastrukture cilësore, të besueshme, të qëndrueshme dhe elastike, përfshirë infrastrukturën rajonale dhe ndërkufitare, në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies njerëzore, duke u përqendruar tek përdorimi i drejtë dhe me kosto të përballueshme për të gjithë;

9.2 Promovimi i industrializimit përfshirës dhe të qëndrueshëm dhe deri në vitin 2030, rritje e ndjeshme e përfshirjes së industrisë në punësim dhe në prodhimin e brendshëm bruto, në përputhje me veçoritë kombëtare, dhe dyfishimi i pranisë së saj në vendet më pak të zhvilluara;

9.3 Rritja e aksesit të ndërmarrjeve të vogla industriale dhe ndërmarrjeve të tjera, në veçanti në vendet në zhvillim, të shërbimet financiare, duke përfshirë kreditimin e përballueshëm dhe integrimin e tyre në tregje dhe zinxhirë vlere;

9.4 Deri në vitin 2030, përmirësimi i infrastrukturës dhe industrive, për t'i bërë ato të qëndrueshme, me rritje të efikasitetit në shfrytëzimin e burimeve dhe përdorim më të madh të teknologjive dhe proceseve industriale të pastra e të sigurta mjedisore, ku të gjitha vendet veprojnë në përputhje me kapacitetet e tyre përkatëse;

9.5 Rritja e kërkimit shkencor, rritja e kapaciteteve teknologjike të sektorëve industrialë në të gjitha vendet, veçanërisht në vendet në zhvillim, duke përfshirë, deri në vitin 2030, inkurajimin e novacionit dhe duke rritur në mënyrë të konsiderueshme numrin e punonjësve të kërkimit dhe zhvillimit për 1 milion njerëz dhe shpenzimet publike dhe private për kërkim dhe zhvillim;

9.a Mundësimi i zhvillimit të qëndrueshëm dhe fleksibël të infrastrukturës në vendet në zhvillim nëpërmjet rritjes së mbështetjes financiare, teknologjike dhe teknike në vendet afrikane, vendet më pak të zhvilluara, vendet në zhvillim pa dalje në det dhe shtetet e vogla ishullore në zhvillim;

9.b Mbështetja e zhvillimit të teknologjive vendëse, kërkimit dhe novacionit në vendet në zhvillim, duke përfshirë sigurimin e një mjedisi të favorshëm politikash, ndër të tjera, për diversifikimin industrial dhe shtimin e vlerës së mallrave;

9.c Rritja e ndjeshme e aksesit ndaj teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe përpjekje për ofrim aksesit universal dhe të përballueshëm në internet në vendet më pak të zhvilluara deri në vitin 2030.

Raporti mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm i vitit 2024 tregon se Shqipëria ka ende sfida për përmbushjen e synimeve të saj në kuadër të OZHQ9. Sipas të dhënave të raportit, Shqipëria rezultoi se i ka arritur objektivat e Agjendës 2030 në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës rrugore rurale, përdorimin e internetit dhe *broadband*-it. Por nga ana tjetër raporti tregon se mbetet ende për t'u kryer në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës në tërësi, përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë dhe nivelit akademik të pasqyruar në kontributet në botimet prestigjioze. Raporti tregon se shpenzimet për kërkim shkencor si pjesë e PBB janë në nivel të ulët, ndonëse shifrat e referuara si më të fundit i përkasin një periudhe të largët (vitit 2008).

Kuadri thelbësor strategjik: OZHQ9 shtrihet në një spektër të gjerë fushash që përfshijnë industrializimin, zhvillimin e infrastrukturës dhe promovimin e teknologjive e inovacionit. Industrializimi në kontekstin e Shqipërisë nuk është konsideruar si pjesë specifike e SKZHIE 2030 por qeveria ka miratuar një dokument të posaçëm - Dokumenti i Strategjisë për Industrinë Joushqimore 2016-2025, i cili paraqet vizionin për nxitjen e zhvillimin e degëve që sigurojnë shfrytëzimin më racional të potencialeve natyrore e njerëzore, konkurruese në treg, sigurojnë të ardhura maksimale në dobi të vendit, nëpërmjet një politike mbështetëse, lehtësuese, monitoruese, për veprimtari prodhuese të sigurt për shëndetin e mjedisin, në përshtatje me eksperiencat bashkëkohore, e legjislacionin e BE-së, sipas një strategjie të mirëharmonizuar me të gjithë aktorët e faktorët ndikues në arritjen e këtij qëllimi. Komponentët e tjerë të OZHQ9 janë pjesë e shtyllës së dytë (Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ndërlidhjen dhe rritjen e gjelbër) së SKZHIE 2030, konkretisht si “Infrastruktura e ndërlidhjeve: transporti dhe telekomunikacioni” me synim zhvillimi i infrastrukturës në mënyrë të qëndrueshme, inteligjente, si edhe të integruar me rrjetet Evropiane dhe rajonale, bazuar në shfrytëzimin e gjelbër të burimeve, si edhe duke siguruar nxitje të zhvillimit ekonomik dhe shërbime me cilësi për qytetarët; dhe “Zgjerimi i kërkimit shkencor dhe inovacionit” që synon krijimin e një sistemi kërkimor dhe inovator të aftë të përballojë me sukses sfidat e ardhshme të zhvillimit të vendit të tilla si, rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore, çështje të energjisë, çështje mjedisore, çështje të shëndetit publik, çështje të inovacionit, dhe të kohezionit social. Strategjia Kombëtare e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit plotëson kuadrin strategjik për pjesën e inovacionit ndërsa Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale, Broadband 2020–2025 shtjellon zhvillimin e sektorit deri në vitin 2025.

Objektivat që synohen të arrihen deri në vitin 2030 **sipas treguesve globalë të OZHQ-ve janë si vijon:**

9.1.2 Transporti i pasagjerëve dhe mallrave, sipas mënyrës së transportit

Objektiivi për transportin ajror të pasagjerëve është që numri i tyre të arrijë në 4,327,000 nga 4,197,000 që ishte në vitin 2022, ndërsa volumi i mallrave të arrijë në 6,302,000 ton, nga 5,473,000 që ishte në vitin 2022.

9.c.1 Përqindja e popullsisë së mbuluar nga një rrjet celular, sipas teknologjisë

Në vitin 2030, e gjithë popullsia (100%) synohet të jetë e mbuluar nga shërbimi të paktën 4G.

Sfida dhe mundësi

Shqipëria përballlet me sfida të rëndësishme për përmbushjen e OZHQ9, përfshirë ndërtimin e rrjetit rrugor kombëtar e lidhjen e tij sipas standardeve evropiane me korridoret që kalojnë përmes vendit, duke siguruar akses të barabartë për të gjithë qytetarët, ndërtimin e infrastrukturës për transportin elektrik, përmirësimin e sigurisë rrugore, reformimin e transportit ndër dhe brenda qyteteve, rivitalizimin dhe modernizimin e transportit hekurudhor e detar apo ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e këtij transporti. Zhvillimi i teknologjive të reja *mobile* e *broadband*-it, siguria e rrjeteve dhe aksesit i barabartë mbeten sfidat kryesore për sektorin deri në vitin 2030.

Në kuadër të përmbushjes së OZHQ9 është i nevojshëm adresimi i pabarazive në infrastrukturë midis zonave urbane që kanë përfituar nga përmirësimet infrastrukturë, dhe atyre rurale që shpesh mbeten të izoluara dhe me qasje të kufizuar në rrugë të mira, furnizim me energji elektrike dhe shërbime të tjera bazë. Industrializimi është i ngadalshëm dhe i varur nga sektorë tradicionalë si bujqësia dhe turizmi. Mungesa e diversifikimit dhe zhvillimit të sektorëve të rinj industrialë kufizon kapacitetet e vendit për të krijuar vende të reja pune dhe për të siguruar rritje ekonomike të qëndrueshme. Tregu i brendshëm është relativisht i vogël, gjë që kufizon kërkesën për produkte industriale dhe kufizon eksportet në një gamë të ngushtë produktesh me vlerë të ulët të shtuar duke e bërë ekonominë të cenueshme ndaj luhatjeve në tregjet ndërkombëtare.

Ndryshimet klimatike dhe sfidat mjedisore, si ndotja dhe degradimi i burimeve natyrore, ndikojnë në infrastrukturën dhe zhvillimin industrial. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve dhe adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike janë të nevojshme për të siguruar që zhvillimi industrial të jetë i qëndrueshëm dhe i rezistueshëm ndaj sfidave të së ardhmes.

Institucionet më të rëndësishme të përfshira në arritjen e OZHQ9:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor, dhe Inovacionit

Ndërlidhjet më të rëndësishme në Agjendën 2030 sipas kontekstit të Shqipërisë:

OZHQ 1, 2, 8, 11, 13, 17

Lidhja kryesore me SKZHIE 2030:

Shtylla II: Infrastruktura e ndërlidhjeve: transporti dhe telekomunikacioni; Zgjerimi i kërkimit shkencor dhe inovacionit

Lidhja parësore me kapitujt e integritetit evropian:

Kapitulli 14: Politika e Transportit

Kapitulli 20: Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale

Kapitulli 25: Shkenca dhe Kërkimi Shkencor

Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 10: Zvogëlim i pabarazive

OZHQ10 ka si objektiv parësor uljen e pabarazive brenda dhe mes vendeve, përmes synimeve të mëposhtme:

10.1 Deri në vitin 2030, arritja në mënyrë progresive dhe ruajtja e rritjes së të të ardhurave për 40 përqindëshin më të ulët të popullsisë me një ritëm më të lartë se mesatarja kombëtare;

10.2 Deri në vitin 2030, fuqizimi dhe promovimi i përfshirjes sociale, ekonomike dhe politike të të gjithëve, pavarësisht moshës, gjinisë, aftësive të kufizuara, racës, përkatësisë etnike, origjinës, fesë, gjendjes ekonomike apo gjendjeje tjetër;

10.3 Sigurimi i mundësive të barabarta dhe zvogëlimi i pabarazive në rezultate, duke përfshirë shfuqizimin e ligjeve, politikave dhe praktikave diskriminuese dhe promovimin e legjislacionit, politikave dhe veprimeve përkatëse në këtë drejtim;

10.4 Miratimi i politikave të pagave dhe të mbrojtjes sociale dhe arritja në mënyrë progresive e barazisë;

10.5 Përmirësimi i rregulloreve dhe monitorimit të tregjeve dhe institucioneve financiare globale dhe forcimi i zbatimit të këtyre rregulloreve;

10.6 Sigurimi i përfaqësimit të gjerë dhe zëdhënies së vendeve në zhvillim në vendimmarrjen e institucioneve globale ndërkombëtare ekonomike dhe financiare për të ofruar institucione më efektive, të besueshme, të përgjegjshme dhe legjitime;

10.7 Lehtësimi i migrimit të organizuar, të sigurt, të rregullt dhe të përgjegjshëm dhe lëvizshmërisë së njerëzve, duke përfshirë zbatimin e politikave të planifikuara dhe të menaxhuara mirë të migracionit;

10.a Zbatimi i parimit të trajtimit të veçantë dhe të diferencuar për vendet në zhvillim, veçanërisht për vendet më pak të zhvilluara, në përputhje me marrëveshjet e Organizatës Botërore të Tregtisë;

10.b Inkurajimi i ndihmës zyrtare për zhvillim dhe flukseve financiare, duke përfshirë investimet e huaja të drejtpërdrejta, për vendet ku nevoja është më e madhe, në veçanti në vendet më pak të zhvilluara, vendet afrikane, shtetet e vogla ishullore në zhvillim dhe vendet në zhvillim pa dalje në det, në përputhje me planet dhe programet e tyre kombëtare;

10.c Deri në vitin 2030, ulja në më pak se 3 për qind e kostove të transaksioneve për remitancat e emigrantëve dhe heqja e korridoreve të remitancave me kosto më të larta se 5 për qind.

Raporti mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm i vitit 2024 tregon se për OZHQ 10 Shqipëria është në rrugën e duhur për arritjen e objektivit 2030 dhe ka ende pak sfida për t'u përmbushur. Vlerësimi i raportit bazohet në dy tregues të pabarazisë, në njërin prej të cilëve (koeficienti Gini) Shqipëria rezulton se i ka arritur objektivat e Agjendës 2030, ndërkohë që është shumë pranë arritjes së rezultatit për treguesin e dytë (faktori Palma).

Kuadri thelbësor strategjik: OZHQ10 përmbledh veprimet që kryhen në kuadër të Agjendës 2030 kryesisht për zvogëlimin e pabarazive, përfshirjen sociale dhe migrimin. SKZHIE 2030 e trajton përfshirjen sociale në kuadër të shtyllës së tretë, kohezioni social (Fuqizimi i mbrojtjes shoqërore dhe sigurimeve shoqërore) dhe migrimin si pjesë të shtyllës së parë, demokracia e fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes së mirë (menaxhimi i migracionit). Dokumenti i Politikave të Përfshirjes Sociale 2023 – 2027 është dokumenti kryesor që trajton përfshirjen sociale, me vizion garantimin e një sistemi për monitorimin dhe matjen e përfshirjes sociale në të gjitha fushat e politikave të uljes së varfërisë dhe të mbrojtjes sociale, punësimit dhe aftësive për sipërmarrjen, arsimin dhe formimin, shëndetit, strehimit, nevojave bazë dhe të drejtave të njeriut, si dhe nxitjen e transparencës dhe llogaridhënies mbi mënyrën se si matet dhe përdoret përfshirja sociale për të mbështetur me informacione performancën e shërbimeve sociale. Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024–2030 dhe Plani i saj i Veprimit 2024-2026 është dokumenti kryesor strategjik mbi migracionin, që synon qeverisjen e efektshme të migracionit në Shqipëri, nëpërmjet adresimit dhe menaxhimit të problematikave dhe sfidave që lindin nga lëvizjet e migratore, duke synuar rritjen e ndikimit të migracionit tek zhvillimi, në të mirë të migrantëve dhe shoqërisë shqiptare.

Objektivat që synohen të arrihen deri në vitin 2030 **sipas treguesve globalë të OZHQ-ve janë si vijon:**

Nuk ka.

Sfida dhe mundësi

Ndryshimet e rëndësishme demografike gjatë viteve të fundit, ku migracioni brenda dhe jashtë vendit ka një rol të konsiderueshëm, përbëjnë sfida të mëdha veçanërisht për tregun e punës e njëkohësisht dhe për konsumin e brendshëm, zhvillimin e biznesit vendës, qëndrueshmërinë e sistemit të pensioneve apo përballjes me problematika të sektorëve specifikë si zhvillimi i bujqësisë, turizmit etj. Parandalimi i emigrimit të parregullt të shtetasve shqiptarë në zonën Shengen dhe vende të tjera të zhvilluara, trajtimi efektiv i flukseve të përziera migratore që vijnë nga zonat e konfliktit, forcimi i mekanizmit të riintegrit me qëllim garantimin e një kthimi të qëndrueshëm të shtetasve shqiptarë dhe integrimi i tyre dhe imigrantëve, përfshirë aksesin në shërbimet parësore, në përputhje me standardet ndërkombëtare, janë disa nga sfidat që Shqipëria do të vazhdojë të përballet gjatë zbatimit të Agjendës 2030. Mbrojtja, integrimi e gjithëpërfshirja, nëpërmjet zvogëlimit të pabarazive dhe diskriminimit për Romët dhe Egjiptianët, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët në nivel

kombëtar dhe vendor, vajzat dhe gratë viktimë të dhunës, trafikimit dhe shfrytëzimit, janë, gjithashtu, aspekte të rëndësishme në arritjen e objektivit 10.

Pabarazitë midis zonave urbane dhe rurale janë të pranishme, ku zonat rurale shpesh mbeten pas në zhvillim ekonomik dhe infrastrukturor duke krijuar një hendek social dhe ekonomik që ndikon në mirëqenien e përgjithshme të popullsisë dhe pabarazi në të ardhura dhe qasje në shërbime bazë, si arsimi, shëndetësia dhe punësimi. Pavarësisht progresit, zona të caktuara janë në varfëri dhe me mundësi të kufizuara zhvillimi duke krijuar kushte të pabarabarta për qytetarët dhe përforcuar ciklet e varfërisë. Grupe të marginalizuara, përfshirë komunitetet romë dhe egjiptiane, personat me aftësi të kufizuara, dhe grupet LGBTI+, përballen me diskriminim dhe pabarazi në qasje në arsim, punësim, dhe shërbime shëndetësore. Ndërsa qasja në arsim është përmirësuar në Shqipëri, pabarazitë në cilësinë e arsimit dhe mundësitë për punësim mbeten një sfidë. Fëmijët dhe të rinjtë nga familjet me të ardhura të ulëta dhe zonat rurale shpesh kanë më pak mundësi për arsimim cilësor dhe për të gjetur punë të mirëpaguara. Pabarazitë gjinore janë të pranishme veçanërisht në tregun e punës dhe në qasjen ndaj burimeve ekonomike. Gratë përballen me paga më të ulëta për punë të barabartë, përfaqësim të ulët në pozita drejtuese dhe diskriminim në punësim dhe arsim. Krijimi i politikave gjithëpërfshirëse dhe zbatimi efektiv i tyre, së bashku me investimet në edukim, shëndetësi dhe infrastrukturë, do të jenë thelbësore për të reduktuar pabarazitë dhe për të promovuar një shoqëri më të barabartë dhe të drejtë.

Ndryshimet klimatike kanë një ndikim disproporcional mbi komunitetet më të varfra dhe të ndjeshme, duke përkeqësuar pabarazitë ekzistuese, përfshirë ato gjinore. Përmbytjet, thatësitat dhe ndotja mjedisore prekin më shumë zonat rurale dhe popullatat e marginalizuara, duke rritur vulnerabilitetin e tyre ekonomik dhe shoqëror.

Institucionet më të rëndësishme të përfshira në arritjen e OZHQ10:

Ministria e Punëve të Brendshme

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit

Ndërlidhjet më të rëndësishme në Agjendën 2030 sipas kontekstit të Shqipërisë:

OZHQ 1, 4, 5, 8, 16, 17

Lidhja kryesore me SKZHIE 2030:

Shtylla I: Menaxhimi i migracionit

Shtylla III: Fuqizimi i mbrojtjes shoqërore dhe sigurimeve shoqërore

Lidhja parësore me kapitujt e integritetit evropian:

Kapitulli 2: Lëvizja e Lirë e Punëtorëve

Kapitulli 19: Politikat Sociale dhe të Punësimit

Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 11: Qytete dhe komunitete të qëndrueshme

OZHQ11 ka si objektiv parësor bërjen e qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore përfshirëse, të sigurt, të forta e të qëndrueshme, përmes synimeve të mëposhtme:

11.1 Deri në vitin 2030, sigurimi i aksesit në strehim të përshtatshëm, të sigurt dhe të përballueshëm dhe shërbime bazë për të gjithë dhe përmirësimi i lagjeve të varfra

11.2 Deri në vitin 2030, sigurimi i aksesit në sisteme transporti të sigurt, të përballueshme dhe të qëndrueshme për të gjithë, duke përmirësuar sigurinë rrugore, sidomos nëpërmjet shtrirjes së transportit publik, me vëmendje të veçantë ndaj nevojave të atyre që gjenden në nevojë, gra, fëmijë, persona me paafësi dhe të moshuar

11.3 Deri në vitin 2030, rritja e urbanizimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe kapacitetit për planifikim dhe menaxhim pjesëmarrës, të integruar dhe të qëndrueshëm të vendbanimeve njerëzore në të gjitha vendet

11.4 Forcimi i përpjekjeve për mbrojtjen dhe garantimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të botës

11.5 Deri në vitin 2030, ulja e ndjeshme e numrit të vdekjeve dhe numrit të personave të prekur, si dhe zvogëlimi i ndjeshëm i humbjeve të drejtpërdrejta ekonomike nga fatkeqësitë, përfshirë fatkeqësitë që lidhen me ujin, në raport me produktin e brendshëm bruto botëror, duke u përqendruar tek mbrojtja e të varfërve dhe njerëzve në nevojë

11.6 Deri në vitin 2030, zvogëlimi i ndikimit negativ për frymë, mbi mjedisin e qyteteve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë cilësisë së ajrit dhe menaxhimit të mbetjeve bashkiake dhe mbetjeve të tjera

11.7 Deri në vitin 2030, ofrimi i aksesit universal në hapësira të sigurta, gjithëpërfshirëse, të arritshme, të gjelbra dhe publike, veçanërisht për gratë dhe fëmijët, personat e moshuar dhe personat me paafësi

11.a Mbështetja e lidhjeve pozitive ekonomike, shoqërore e mjedisore midis zonave urbane, pranë qyteteve dhe rurale, duke forcuar planifikimin për zhvillim kombëtar e rajonal

11.b Deri në vitin 2030, rritja e ndjeshme e numrit të qyteteve dhe vendbanimeve të njerëzve nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të politikave dhe planeve të integruara drejt përfshirjes, efikasitetit të burimeve, zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, elasticitetit ndaj fatkeqësive, si dhe hartimi dhe zbatimi, në përputhje me Kornizën Sendai për Uljen e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2015-2030, i menaxhimit tërësor të rrezikut nga fatkeqësitë në të gjitha nivelet

11.c Mbështetja e vendeve më pak të zhvilluara, me ndihmë financiare dhe teknike, për ndërtimin e ndërtesave të qëndrueshme dhe elastike duke shfrytëzuar materialet lokale

Raporti mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm i vitit 2024 tregon se për OZHQ 11 Shqipëria ka ende sfida të rëndësishme për të arritur objektivin 2030. Vlerësimi i raportit bazohet në ecurinë e tre treguesve të ndryshëm. Në të parin, që tregon përqindjen e personave që jetojnë në kushte të papërshtatshme dhe izoluara (*slums*) Shqipëria rezulton se e ka arritur objektivin për të eliminuar këtë fenomen brenda vitit 2030. Treguesi i dytë, që lidhet me cilësinë e ajrit (PM2.5) tregon se progresi i kryer është i pamjaftueshëm për arritjen e objektivit 2030. Treguesi i tretë, tregon përqindjen e popullsisë që përdor ujë të pijshëm nga tubacionet e ujësjellësve dhe niveli i fundit i disponueshëm (viti 2022) është i pamjaftueshëm për objektivin 2030.

Kuadri thelbësor strategjik: OZHQ11 përmbledh veprimet që kryhen në kuadër të Agjendës 2030 kryesisht për urbanizimin e qëndrueshëm dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore. SKZHIE 2030 e trajton këtë tematikë në kuadër të shtyllës së dytë, Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ndërlidhjen dhe rritjen e gjelbër (Planifikimi hapësinor, zhvillimi i qëndrueshëm urban dhe rajonal), që synon përmirësimin e situatës socio-ekonomike dhe cilësisë së jetës të banorëve të të gjitha rajoneve të Shqipërisë nëpërmjet mobilizimit efikas të potencialeve specifike rajonale dhe territoriale dhe zhvillimit më të balancuar dhe të qëndrueshëm rajonal; dhe shtyllën e tretë, kohezioni social (Fuqizimi i artit, kulturës dhe sporteve). Plani i Përgjithshëm Kombëtar “Shqipëria 2030” është instrumenti më i lartë i planifikimit territorial në Shqipëri, i cili adreson në mënyrë të integruar çështjet e planifikimit, duke e parë territorin shqiptar si një të tërë. Në bazë të parimeve, objektivave dhe specifikimeve të tij, janë detajuar dhe vënë në zbatim Planet e Përgjithshme Vendore dhe Planet e Detajuara për Zonat e Rëndësishme Kombëtare, në përputhje me parashikimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar “Shqipëria 2030”.


Objektivat që synohen të arrihen deri në vitin 2030 sipas treguesve globalë të OZHQ-ve janë si vijon:

11.5.2 Humbja e drejtpërdrejtë ekonomike që u atribuohet fatkeqësive në lidhje me produktin e brendshëm bruto (PBB)

Objektivi për këtë tregues në vitin 2030 është zvogëlimi i tij me 5% nga niveli bazë i matjes së tij në vitin 2018, kur treguesi ishte 0.36% e PBB.

11.6.1 Përqindja e mbetjeve bashkiake të grumbulluara rregullisht dhe me shkarkim përfundimtar të rregullt, nga totali i mbetjeve bashkiake të krijuara, sipas qyteteve

Objektivi për këtë tregues për vitin 2030 është që 100% e mbetjeve bashkiake dhe 90% e atyre rurale, të mblidhen dhe depozitohen rregullisht sipas përkufizimit të këtij treguesi.



Sfida dhe mundësi

Zhvillimi rajonal i bazuar tek vendi dhe i nxitur nga partneriteti në Shqipëri do të fokusohet tek zhvillimi policentrik, i cili synon në mënyrë specifike të sigurojë shpërndarjen e përfitimeve në rrethinat e largëta të zonave të identifikuara të zhvillimit të rajoneve. Vetëm mjedisi i ndërtuar me cilësi të lartë nuk mjafton për të mbajtur popullatën dhe për të tërhequr vizitorë dhe investitorë dhe duhet të plotësohet me jetë komunitare-kulturore, sociale, etj. Fokusi tek komunitetet etnike synon në veçanti ndërtimin e strukturës shoqërore në rajone dhe përdorimin e larmisë kulturore dhe etnike si një mjet për të pasuruar cilësinë e jetës për të gjithë. Fokus i veçantë do t'i kushtohet veçanërisht tek të moshuarit nga të kuptuarit se popullsia tashmë të moshuar të rajoneve duhet t'u ofrohet mbështetje për të ofruar cilësi më të mirë të jetës, por, gjithashtu, nga mënyra se si përvoja e tyre mund të përdoret për të pasuruar jetën e të rinjve.

Gjatë tranzicionit, vendi ka përjetuar një urbanizim të shpejtë dhe të pakontrolluar që ka sjellë shpesh zhvillim të parregullt të qyteteve, me ndërtime informale dhe mungesë të planifikimit urban. Qytetet përballen me sfida në infrastrukturë, përfshirë rrugët e dëmtuara, kanalizimet e pamjaftueshme, dhe furnizimin me ujë. Këto probleme përkeqësohen në zonat ku infrastruktura nuk arrin të përmbushë kërkesat e popullsisë në rritje. Sistemet e transportit publik janë të kufizuara dhe joefikase, duke sjellë një përdorim të tepruar të automjeteve private, dhe shkaktuar trafik të rënduar, ndotje të ajrit dhe probleme të parkimit. Shqipëria është një vend i prekshëm nga tërmetet dhe përmbytjet. Mungesa e një planifikimi urban të mirë dhe ndërtimet informale rrisin rrezikun e dëmeve të mëdha gjatë fatkeqësive natyrore.

Ruajtja dhe integrimi i trashëgimisë kulturore në zhvillimin urban është një tjetër sfidë e rëndësishme zhvillimi me të cilën përballlet zhvillimi urban në vend. Pa investime të mëdha në transportin publik, strehimin e përballueshëm, hapësirat e gjelbra dhe infrastrukturën e qëndrueshme, do të jetë e vështirë që përmbushja e OZHQ11 të realizohet brenda Agjendës 2030.

Institucionet më të rëndësishme të përfshira në arritjen e OZHQ11:

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit

Ministria e Mjedisit

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit

Agjencia Kombëtare Ujësjiellës Kanalizime

Bashkitë

Ndërlidhjet më të rëndësishme në Agjendën 2030 sipas kontekstit të Shqipërisë:

OZHQ 1, 3, 4, 9, 13, 17

Lidhja kryesore me SKZHIE 2030:

Shtylla II: Planifikimi hapësinor, zhvillimi i qëndrueshëm urban dhe rajonal

Shtylla III: Fuqizimi i artit, kulturës dhe sporteve

Lidhja parësore me kapitujt e integritetit evropian:

Kapitulli 22, Politikat Rajonale dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore.

Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 12: Konsum dhe prodhim i përgjegjshëm

OZHQ12 ka si objektiv parësor konsumin dhe prodhimin e përgjegjshëm, përmes synimeve të mëposhtme:

12.1 Zbatimi i Kuadrit 10-vjeçar të Programeve për Modelet e Qëndrueshme të Konsumit dhe Prodhimit, ku të merren masa nga të gjitha vendet, dhe vendet e zhvilluara të udhëheqin procesin duke marrë parasysh zhvillimin dhe kapacitetet e vendeve në zhvillim;

12.2 Deri në vitin 2030, arritja e menaxhimit të qëndrueshëm dhe përdorimit eficient të burimeve natyrore;

12.3 Deri në vitin 2030, përgjysmimi i shpërdorimit të ushqimeve në nivel global, në nivel shitjesh me pakicë dhe konsumatori, si dhe ulja e humbjeve të ushqimit përgjatë zinxhirëve të prodhimit dhe furnizimit, duke përfshirë dhe humbjet pas mbledhjes së të mbjellave;

12.4 Deri në vitin 2030, arritje e menaxhimit të shëndoshë mjedisor të kimikateve dhe të të gjitha mbetjeve gjatë gjithë ciklit të tyre, në përputhje me kornizat e miratuara ndërkombëtare dhe zvogëlimi në mënyrë të konsiderueshme i çlirimit të tyre në ajër, ujë dhe tokë, në mënyrë që të minimizohen ndikimet negative mbi shëndetin e njeriut dhe mjedis;

12.5 Deri në vitin 2030, ulja e ndjeshme e gjenerimit të mbetjeve nëpërmjet parandalimit, uljes së sasisë, riciklimit dhe ripërdorimit;

12.6 Subjektet tregtare, përfshirë shoqëritë evropiane dhe grupimet ekonomike me interes evropian, detyrohen të integrojnë standarde të qëndrueshmërisë në veprimtarinë e tyre ekonomike dhe në raportimin vjetor, duke siguruar transparencë mbi ndikimin mjedisor dhe social, veçanërisht gjatë proceseve të shndërrimit, bashkimit apo ndarjes, me qëllim garantimin e rritjes ekonomike në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian;

12.7 Promovimi i praktikave të prokurimeve publike që janë të qëndrueshme, në përputhje me politikat dhe përparësitë kombëtare;

12.8 Deri në vitin 2030, sigurimi që njerëzit, kudo, të kenë informacionin dhe ndërgjegjësimin e duhur për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mënyrën e jetesës në harmoni me natyrën;

12.a Mbështetja e vendeve në zhvillim për të forcuar kapacitetet e tyre shkencore dhe teknologjike për të lëvizur drejt modeleve më të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit;

12.b Hartimi dhe zbatimi i instrumenteve të monitorimit për ndikimet e zhvillimit të qëndrueshëm, për një turizëm të qëndrueshëm, që krijon vende pune e promovon kulturën e produktet vendëse;

12.c Racionalizimi i subvencioneve joefikase të lëndëve djegëse fosile që inkurajojnë konsumimin e tepërt duke shmangur deformimet e tregut, në përputhje me rrethanat kombëtare, duke përfshirë heqjen graduale të subvencioneve të dëmshme, aty ku ekzistojnë, për të pasqyruar ndikimet e tyre mjedisore, duke marrë parasysh plotësisht nevojat specifike dhe kushtet e vendeve në zhvillim dhe minimizimin e ndikimeve të mundshme negative mbi zhvillimin e tyre në një mënyrë që mbron të varfrit dhe komunitetet e prekura.


Raporti mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm i vitit 2024 tregon se për OZHQ 12 Shqipëria ka ende sfida të rëndësishme për të arritur objektivin 2030. Vlerësimi i raportit bazohet në ecurinë e shtatë treguesve të ndryshëm, nga të cilët rezulton se Shqipëria ka përmbushur dy për arritjen e objektivave 2030. Këta tregues përfshijnë nivelin e emetimeve të nitrogjenit që lidhet me importet dhe sasinë për frymë të eksportit të mbetjeve plastike. Në katër tregues të tjerë Shqipëria ka ende për të bërë për arritjen e objektivit dhe këtu përfshihet sasia e mbetjeve që trajtohen nga bashkitë, mbetjet e pajisjeve elektronike, ndotja e ajrit nga importet dhe niveli i nitrogjenit që lidhet me proceset prodhuese në vend. Së fundi, në një tregues të rëndësishëm, ndotjen e ajrit nga aktivitetet prodhuese në vend, Shqipëria rezulton ende larg arritjes së objektivit 2030.

Kuadri thelbësor strategjik: OZHQ12 përfshin synime komplekse në kuadër të Agjendës 2030 që përfshijnë konsumin e përgjegjshëm, ushqimor dhe industrial, menaxhimin e mbetjeve dhe kimikateve, ekonominë qarkulluese dhe promovimin e modeleve të qëndrueshme të biznesit. SKZHIE 2030 e përfshin këtë tematikë në kuadër të shtyllës së dytë, Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ndërlidhjen dhe rritjen e gjelbër (Menaxhimi i integruar i mbetjeve dhe ekonomia qarkulluese), duke synuar përmirësimi e cilësisë së mjedisit dhe shëndetit të qytetarëve përmes përmirësimit të menaxhimit të mbetjeve në përputhje me kërkesat ligjore të planifikimit dhe harmonizimit të kuadrit ligjor me BE e siguruar financimin e qëndrueshëm të menaxhimit të mbetjeve, por dhe duke fuqizuar ekonominë qarkulluese mbështetur në kërkim, inovacione dhe përmirësime teknologjike e menaxhimi, dhe angazhimeve të tjera të Shqipërisë në kuadër të Deklaratës së Sofies mbi Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Dokumenti i Politikave Strategjike të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020-2035 është dokumenti kryesor strategjik që detajon politikat për trajtimin e mbetjeve duke synuar krijimin e kuadrit strategjik dhe rregullator në Shqipëri, për të ulur sasinë e mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhuar në mënyrë të integruar mbetjet e gjeneruara në linjë me objektivat e Direktivës Kuadër të Mbetjeve të BE dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Objektivat që synohen të arrihen deri në vitin 2030 **sipas treguesve globalë të OZHQ-ve janë si vijon:**

12.5.1 Shkalla kombëtare e riciklimit, materiale të ricikluara (ton)

Synimi për këtë tregues është që shkalla kombëtare e riciklimit në vitin 2030 të arrijë në 30%.



Sfida dhe mundësi

Tranzicioni i gjelbër do të sjellë zhvendosjen graduale të ekonomisë shqiptare dhe punësimit nga sektorë si industria minerare apo ndërtimi, drejt aktiviteteve më produktive si turizmi i mbështetur në mbrojtjen e ekosistemeve dhe biodiversitetit, bujqësia produktive e bazuar në metodat e qëndrueshme të prodhimit ushqimor, traditën dhe vlerat e veçanta të prodhimit vendës, promovimin e ekonomisë qarkulluese, si dhe trajtimin efektiv të mbetjeve, ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës apo kontributit në reduktimin e emetimeve përmes investimeve në energjitë e rinovueshme. Mbrojtja e mjedisit dhe reduktimi i mbetjeve do të jenë në thelb të funksionimit të ekonomisë qarkulluese mbështetur veçanërisht në kërkim, inovacione dhe përmirësime teknologjike e menaxhimi, si një ndër angazhimet e Shqipërisë në kuadër të Deklaratës së Sofies mbi Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Mbështetja në ekonominë qarkulluese do të ndihmojë bizneset vendëse të integrohen natyrshëm në zinxhirët e vlerës së produkteve që prodhohen dhe tregtohen në rajon dhe BE.

Menaxhimi i mbetjeve është një sfidë e rëndësishme, me infrastrukturë të kufizuar për grumbullimin, trajtimin dhe riciklimin e tyre. Shkalla e ulët e riciklimit bën që shumica e mbetjeve të riciklueshme të përfundojnë në landfille, dhe ndërgjegjësimi i publikut për rëndësinë e riciklimit është ende i ulët. Shumë biznese përdorin teknologji të vjetruara dhe praktika jo të qëndrueshme që çojnë në ndotje të madhe dhe konsum të lartë të energjisë dhe burimeve natyrore gjë që kërkon investime në teknologji më të pastërta dhe praktika të qëndrueshme prodhimi. Për të arritur modele të qëndrueshme të prodhimit dhe konsumit, është e nevojshme përfshirja e sektorit privat në adoptimin e praktikave të qëndrueshme. Për këtë gjë, bizneset përballen me sfida në kalimin drejt metodave më të qëndrueshme për shkak të kostove fillestare dhe kuadrit ligjor për ofrimin e stimuljeve.

Shqipëria përballlet me sfida në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, si pyjet, ujërat dhe toka. Shfrytëzimi i këtyre burimeve rrezikon degradimin e mjedisit dhe humbjen e biodiversitetit. Ndotja e ajrit, ujërave dhe tokës për shkak të aktiviteteve industriale dhe bujqësore të pakontrolluara përbën një sfidë madhore për qëndrueshmërinë e mjedisit në Shqipëri. Degradimi i mjedisit ndikon negativisht në cilësinë e jetës dhe mund të pengojë zhvillimin e qëndrueshëm. Edukimi mbi përdorimin efikas të burimeve, riciklimin dhe reduktimin e mbetjeve është i nevojshëm për të ndryshuar sjelljen e konsumatorëve dhe për të nxitur një kulturë të qëndrueshme.

Institucionet më të rëndësishme të përfshira në arritjen e OZHQ12:

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit

Ministria e Mjedisit

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Agjencia Kombëtare Ujësjiellës Kanalizime
Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve

Ndërlidhjet më të rëndësishme në Agjendën 2030 sipas kontekstit të Shqipërisë:

OZHQ 1, 2, 3, 8, 13, 14, 15, 17

Lidhja kryesore me SKZHIE 2030:

Shtylla II: Menaxhimi i integruar i mbetjeve dhe ekonomia qarkulluese

Lidhja parësore me kapitujt e integritimit evropian:

Kapitulli 27 Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike

Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 13: Veprim për klimën

OZHQ13 ka si objektiv parësor ndërmarrjen e veprimeve urgjente për të luftuar ndryshimin e klimës dhe efektet e tij, përmes synimeve të mëposhtme:

13.1 Forcimi i qëndrueshmërisë dhe kapacitetit përshtatës të të gjitha vendeve ndaj rreziqeve që lidhen me klimën dhe katastrofat natyrore në të gjitha vendet;

13.2 Integrimi i masave për ndryshimin e klimës në politikat, strategjitë dhe planifikimin kombëtar;

13.3 Përmirësimi i edukimit, ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve njerëzore e institucionale për zbutjen, përshtatjen, uljen e ndikimit të ndryshimit të klimës dhe paralajmërimin e hershëm;

13.a Zbatimi i angazhimit të marrë përsipër nga vendet e zhvilluara që janë palë në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike, me qëllim mobilizimin bashkërisht të 100 miliardë dollarëve në vit deri në vitin 2030 nga të gjitha burimet, për të trajtuar nevojat e vendeve në zhvillim në kuadrin e veprimeve mundësuese për zbutje dhe transparencë në zbatimin dhe funksionalizimin e plotë të Fondit të Klimës së Gjellbër nëpërmjet kapitalizimit të saj sa më shpejt që të jetë e mundur;

13.b Promovimi i mekanizmave për ngritjen e kapaciteteve për planifikim dhe menaxhim efektiv lidhur me ndryshimet klimatike në vendet më pak të zhvilluara dhe shtetet e vogla ishullore në zhvillim, duke u përqendruar tek gratë, të rinjtë dhe komunitetet lokale dhe të marginalizuara.

Raporti mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm i vitit 2024 tregon se për OZHQ 13 Shqipëria ka arritur progres të kënaqshëm dhe është drejt arritjes së objektivit 2030 ndonëse mbeten ende sfida të rëndësishme për t'u përballur. Vlerësimi i raportit bazohet në ecurinë e dy treguesve mjedisorë, një prej të cilëve – emetimet e CO₂ nga lëndët djegëse fosile dhe prodhimi i çimentos – Shqipëria rezulton se e ka të përmbushur, dhe i dyti që lidhet me emetimet CO₂ që vijnë nga importet (GHG) rezulton se ka ende për të kryer që të shkojë drejt objektivit zero.

Kuadri thelbësor strategjik: OZHQ13 është i fokusuar në adresimin e problematikës së ndryshimeve klimatike në kuadër të Agjendës 2030. SKZHIE 2030 e përfshin këtë tematikë në kuadër të shtyllës së dytë, Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ndërlidhjen dhe rritjen e gjellbër (Qëndresa dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike), duke synuar një ekonomi të fortë dhe të qëndrueshme për Shqipërinë përmes një rruge me zero emetime dhe Rritje Ekonomike të Gjellbër. Mbrojtja Civile dhe Emergjencat nga fatkeqësitë natyrore përfshihen nën shtyllën I, demokracia e fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes së mirë, (Fuqizimi i rendit publik, mbrojtjes së vendit dhe përgatitja për rastet e emergjencave civile). Strategjia e Ndryshimeve Klimatike 2020–2030 dhe Planet e Veprimit janë dokumentet kryesore strategjike sektoriale që lidhen me ndryshime klimatike dhe arritjen e OZHQ13. Masat zbutëse, adaptimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm janë shtyllat kryesore të strategjisë e cila synon zhvillimin drejt ekonomisë me karbon të ulët për arritjen e objektivave

globalë të zbutjes dhe për të lejuar një reagim të përshtatur të brezit të ardhshëm me kosto të arsyeshme mjedisore, ekonomike dhe sociale. Strategjia Kombëtare Shqiptare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë është dokumenti kryesor strategjik që shtjellon politikat për të zvogëluar risqet e fatkeqësive natyrore dhe efektet e ndryshimeve klimatike, si dhe për të përgatitur, përballuar dhe për t'u rimëkëmbur, integruar në të gjithë sektorët me kapacitete të zhvilluara për të siguruar parandalimin e risqeve të reja dhe menaxhimin e riskut të mbetur, që të gjitha së bashku të ndihmojnë në forcimin e aftësisë ripërtëritëse dhe si rezultat në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë.

Objektivat që synohen të arrihen deri në vitin 2030 sipas treguesve globalë të OZHQ-ve janë si vijon:

13.1.1 Numri i vdekjeve, personave të zhdukur dhe personave të prekur drejtpërdrejt nga fatkeqësitë për 100,000 banorë

Synimi për këtë tregues është që në vitin 2030 të mbahet nën 146.8, që përfaqëson një zvogëlim me 10% nga niveli bazë i vitit 2018 (163.15).

13.1.2 Numri i vendeve që miratojnë dhe zbatojnë strategji kombëtare për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë në përputhje me Kornizën Sendai për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2015–2030

Shqipëria e ka të miratuar një strategji të tillë ndaj treguesi është i arritur.

13.1.3 Përqindja e qeverive vendore që miratojnë dhe zbatojnë strategjitë lokale të reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë në përputhje me strategjitë kombëtare për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë

Synimi për këtë tregues është që në vitin 2030 të gjitha bashkitë të kenë të miratuara planet/strategjitë lokale për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë në përputhje me strategjinë kombëtare.

Sfida dhe mundësi

Sipas SKZHIE 2030, ndryshimet klimatike paraqesin një ndër 6 sfidat kryesore me të cilat Shqipëria përballlet deri në vitin 2030, për faktin se vendi është shumë i prekshëm ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, për shkak të katastrofave natyrore që lidhen me klimën, si përmbytjet, thatësira, zjarret etj. Skenarët klimatikë për të ardhmen në Shqipëri parashikojnë ndryshime të theksuara, si rritje të temperaturave, ulje të reshjeve dhe reduktim të burimeve ujore dhe tokës së punueshme. Reshjet në verë do të vijnë të zvogëlohen, ndërsa muajt e dimrit parashikohet të kenë rritje, duke përfshirë rritjen e shpeshtësisë dhe intensitetit të shirave të rrëmbyeshëm. Gjithashtu, ndryshimet klimatike pritet të ndikojnë negativisht në rrjedhën e lumenjve, gjë që do të ndikojë në kapacitetin gjenerues të hidrocentraleve, në disponueshmërinë e ujit, përfshirë sektorin e bujqësisë dhe sigurinë e popullsisë për shkak të fatkeqësive të shtuara. Ndikimi i këtyre efekteve në ekonomi dhe në zhvillimin e vendit kërkon kapacitete dhe burime financiare të cilat aktualisht janë të pamjaftueshme sa duhet.

Detyrimi kombëtar për burime të përballueshme, të qëndrueshme, të gjindshme dhe të sigurta energjetike dhe ujore do të jetë, në periudhën e ardhshme të parashikuar, një nxitës kryesor i ndryshimeve të mëdha dhe zhvillimit në këta sektorë dhe në ata mbështetës. Ndryshimet klimatike ndikojnë ndjeshëm në burimet ujore, me periudha të zgjatura thatësie dhe përmbytje të shpeshta. Këto ndryshime kërkojnë menaxhim më të mirë të burimeve ujore dhe një planifikim më të kujdesshëm për të siguruar furnizim të qëndrueshëm me ujë për bujqësinë, industrinë dhe konsumatorët. Adaptimi i sektorit bujqësor ndaj kushteve të reja klimatike është thelbësor për qëndrueshmërinë e sektorit dhe sigurinë ushqimore. Ndryshimet klimatike mund të kontribuojnë në migrimin e brendshëm dhe jashtë vendit për shkak të kushteve të pafavorshme të jetesës. Shqipëria duhet të përgatitet për të adresuar këto sfida të mundshme të migrimit klimatik dhe për të siguruar mbështetje për komunitetet e prekura.

Megjithëse aktualisht vendi ka emetime të ulëta të gazrave serrë krahasuar me vendet e industrializuara, ka ende nevojë për politika për reduktimin e mëtejshëm të këtyre emetimeve përfshirë përmirësimin e efikasitetit energjetik, promovimin e burimeve të rinovueshme të energjisë dhe reduktimin e ndotjes nga sektori i transportit.

Institucionet më të rëndësishme të përfshira në arritjen e OZHQ13:

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit

Ministria e Mjedisit

Ministria e Mbrojtjes

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

Ndërlidhjet më të rëndësishme në Agjendën 2030 sipas kontekstit të Shqipërisë:

OZHQ 1, 3, 9, 11, 15, 17

Lidhja kryesore me SKZHIE 2030:

Shtylla I: Fuqizimi i rendit publik, mbrojtjes së vendit dhe përgatitja për rastet e emergjencave civile

Shtylla II: Qëndresa dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike

Lidhja parësore me kapitujt e integritetit evropian:

Kapitulli 27 Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike

Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 14: Jeta nën ujë

OZHQ14 ka si objektiv parësor ruajtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të oqeanëve, deteve dhe burimeve detare për zhvillim të qëndrueshëm, përmes synimeve të mëposhtme:

14.1 Deri në vitin 2027, parandalimi dhe ulja domethënëse e ndotjes ujore të të gjitha llojeve, veçanërisht nga aktivitetet tokësore, duke përfshirë mbetjet ujore dhe ndotjet nga lëndët ushqyese;

14.2 Deri në vitin 2030, menaxhimi dhe mbrojtja e qëndrueshme e ekosistemeve detare dhe bregdetare, për shmangien e efekteve të shumta negative, nëpërmjet rritjes së qëndrueshmërisë së tyre dhe ndërmarrjes së veprimeve për ripërtëritjen e tyre, për përfitim të oqeanëve të shëndetshme e prodhimtare;

14.3 Minimizimi dhe trajtimi i ndikimeve të acidifikimit të oqeanëve, duke përfshirë rritjen e bashkëpunimit shkencor në të gjitha nivelet;

14.4 Deri në vitin 2030, rregullimi efektiv i mbarështimit të peshqve dhe shmangia e peshkimit të tepërt, praktikave të peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar dhe praktikave shkatërruese të peshkimit, dhe zbatimi i planeve të menaxhimit të bazuara në shkencë, me qëllim rikrijimin e rezervave të peshqve në kohën më të shkurtër të mundshme, të paktën në nivele që mund të prodhojnë qëndrueshmëri maksimale, siç përcaktohet nga karakteristikat e tyre biologjike;

14.5 Deri në vitin 2030, mbrojtja e të paktën 10 për qind e zonave bregdetare e detare, në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar dhe mbështetur në informacionin më të mirë shkencor në dispozicion;

*14.6 Deri në vitin 2030, ndalimi i formave të caktuara të subvencionimit të peshkimit që kontribuojnë për tejkalimin e kapacitetit për peshkim dhe peshkimin e tepërt, heqja e subvencioneve që kontribuojnë për peshkimin e paligjshëm, të paregjistruar dhe të parregulluar dhe frenimi i prezantimit të subvencioneve të reja të këtij lloji, duke pranuar se trajtimi i veçantë dhe i diferencuar i përshtatshëm dhe efektiv për vendet në zhvillim dhe më pak të zhvilluara duhet të jenë pjesë përbërëse e negocimit nga Organizata Botërore e Tregtisë*** të subvencioneve për peshkimin;*

14.7 Deri në vitin 2030, rritja e përfitimeve ekonomike për shtetet e vogla ishullore në zhvillim dhe vendet më pak të zhvilluara nga përdorimi i qëndrueshëm i burimeve detare, duke përfshirë menaxhimin e qëndrueshëm të peshkimit, akuakulturës dhe turizmit;

14.a Rritja e njohurive shkencore, zhvillimi i kapaciteteve kërkimore dhe transferimi i teknologjisë detare, duke marrë parasysh kriteret dhe Udhëzimet e Komisionit Ndërqeveritar të Oqeanografisë për Transferimin e Teknologjisë Detare, me qëllim përmirësimin e shëndetit të oqeanëve dhe rritjen e kontributit të biodiversitetit detar në zhvillimin e vendet në zhvillim, në veçanti të shteteve të vogla ishullore në zhvillim dhe vendet më pak të zhvilluara;

14.b Sigurimi i aksesit për peshkatarët e vegjël artizanalë në burimet dhe tregjet detare;

14.c Rritja e konservimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të oqeanëve dhe burimeve të tyre duke zbatuar të drejtën ndërkombëtare, siç reflektohet në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Detit, e cila ofron kuadrin ligjor për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të oqeanëve dhe burimeve të tyre, sikundër nënvizohet në paragrafin 158 të “Së ardhmes që duam”.

Raporti mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm i vitit 2024 tregon se OZHQ 14 është një ndër tre OZHQ-ve, në të cilat Shqipëria ka arritur progres të pamjaftueshëm për të përmbushur synimet e Agjendës 2030, duke pasur sfida të rëndësishme për t’u tejkaluar deri në vitin 2030. Ky vlerësim i raportit bazohet në ecurinë e treguesve të OZHQ14. Konkretisht, në njërin prej tyre, kërcënimi i biodiversitetit ujon nga importet, Shqipëria e ka përmbushur objektivin. Në dy prej tyre ka ende punë për të bërë në arritjen e objektivit (sipërfaqja e zonave të mbrojtura të diversitetit ujon, dhe indeksi i pastërtisë së ujit të detit). Ndërsa në dy tregues të tjerë, që lidhen me peshkimin, progresi është i pamjaftueshëm (sasia e peshkimit me rrjeta të tërhequra në tabanin e detit dhe sasia e peshkimit që hidhet sërish në det).

Kuadri thelbësor strategjik: OZHQ14 është i fokusuar kryesisht në ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit të detit e liqeneve, peshkimin dhe promovimin e teknologjive të reja në këto fusha. SKZHIE 2030 e përfshin këtë tematikë në kuadër të shtyllës së dytë, Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ndërlidhjen dhe rritjen e gjelbër (Ekonomia blu), duke synuar zhvillimin dhe shndërrimin e ekonomisë detare të Shqipërisë në një kontribues kryesor të rritjes së qëndrueshme duke rikthyer traditën e lundrimit dhe mbështetur zhvillimin e turizmit detar, peshkimit, sportiv dhe argëtues me mekanizma dhe mjete të pajtueshme me mjedisin në të gjithë bregdetin. Ndonëse strategjia për ekonominë blu që është mjaft komplekse dhe trajton të gjitha aspektet e OZHQ 14 është ende në proces, Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021–2027 është dokumenti strategjik sektorial për peshkimin.

Objektivat që synohen të arrihen deri në vitin 2030 sipas treguesve globalë të OZHQ-ve janë si vijon:

14.4.1 Përqindja e rezervave të peshkut brenda niveleve biologjikisht të qëndrueshme

Synimi për këtë tregues është që në vitin 2030 rreth 70% e rezervave të peshkut të jenë brenda niveleve biologjikisht të qëndrueshme

14.5.1 Mbulimi i zonave të mbrojtura në raport me zonat detare

Synimi për vitin 2030 për këtë tregues është që të gjitha zonat detare të jenë mbrojtura (100%).

14.6.1 Shkalla e zbatimit të instrumenteve ndërkombëtare që synojnë të luftojnë peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar

Synimi për vitin 2030 për këtë tregues është që peshkimi i paligjshëm të jetë nën 1%.

14.7.1 Peshkimi i qëndrueshëm si përqindje e PBB-së në shtetet ishuj të vegjël në zhvillim, vendet më pak të zhvilluara dhe të gjitha vendet

Synimi për këtë tregues është që në vitin 2030 peshkimi të përbëjë 2.5% të PBB.

Sfida dhe mundësi

Sipas SKZHIE 2030, ndryshimet klimatike paraqesin një ndër 6 sfidat kryesore me të cilat Shqipëria përballlet deri në vitin 2030, për faktin se vendi është shumë i prekshëm ndaj efekteve të

ndryshimeve klimatike, për shkak të katastrofave natyrore që lidhen me klimën, si përmbytjet, thatësira, zjarret etj. Skenarët klimatikë për të ardhmen në Shqipëri parashikojnë ndryshime të theksuara, si rritje të temperaturave, ulje të reshjeve dhe reduktim të burimeve ujore dhe tokës së punueshme. Reshjet në verë do të vijojnë të zvogëlohen, ndërsa muajt e dimrit parashikohet të kenë rritje, duke përfshirë rritjen e shpeshtësisë dhe intensitetit të shirave të rrëmbyeshëm. Gjithashtu, ndryshimet klimatike pritet të ndikojnë negativisht në rrjedhën e lumenjve, gjë që do të ndikojë në kapacitetin gjenerues të hidrocentraleve, në disponueshmërinë e ujit, përfshirë sektorin e bujqësisë dhe sigurinë e popullsisë për shkak të fatkeqësive të shtuara.

Ndikimi i këtyre efekteve në ekonomi dhe në zhvillimin e vendit kërkon kapacitete dhe burime financiare të cilat aktualisht janë të pamjaftueshme sa duhet. Detyrimi kombëtar për burime të përbalueshme, të qëndrueshme, të gjindshme dhe të sigurt energjetike dhe ujore do të jetë, në periudhën e ardhshme të parashikuar, një nxitës kryesor i ndryshimeve të mëdha dhe zhvillimit në këta sektorë dhe në ata mbështetës.

Një nga sfidat më të mëdha është ndotja e deteve nga mbetjet plastike, ujërat e patrajuara, dhe kimikatet industriale. Ndotja nga aktivitetet bregdetare dhe turistike, gjithashtu, ndikon në cilësinë e ujit detar dhe biodiversitetin detar.

Shqipëria ka një biodiversitet të pasur detar, por shumë specie dhe habitate janë të kërcënuara nga aktivitetet njerëzore, përfshirë peshkimin e tepërt, jo të qëndrueshëm dhe me metoda të ndaluara, si dhe ndotja e ndryshimet klimatike. Ndryshimet klimatike po ndikojnë në detet e Shqipërisë, me rritje të temperaturës së ujit, acidifikimin e ujit të detit dhe ngritjen e nivelit të detit. Këto ndryshime kanë ndikime të mëdha në ekosistemet detare dhe në komunitetet bregdetare që varen nga burimet detare për jetesën e tyre.

Institucionet më të rëndësishme të përfshira në arritjen e OZHQ14:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit

Ministria e Mjedisit

Ndërlidhjet më të rëndësishme në Agjendën 2030 sipas kontekstit të Shqipërisë:

OZHQ 1, 2, 12, 15, 17

Lidhja kryesore me SKZHIE 2030:

Shtylla II: Ekonomia blu

Lidhja parësore me kapitujt e integritetit evropian:

Kapitulli 13: Peshkimi

Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 15: Jeta në tokë

Objektivi parësor i OZHQ15 është mbrojtja, rimëkëmbja dhe nxitja e shfrytëzimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, pyjeve të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme, luftimi i shkretëtimit, ndalimi dhe prapësimi i procesit të degradimit të tokës, si dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit, përmes synimeve të mëposhtme:

15.1 Deri në vitin 2030, siguri që konservimi, rimëkëmbja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i ekosistemeve tokësore dhe i ujërave të ëmbla dhe shërbimet e tyre, veçanërisht, në pyje, ligatina, male dhe tokë të thatë, të jenë në përputhje me detyrimet e parashikuara në marrëveshjet ndërkombëtare;

15.2 Deri në vitin 2030, promovimi i zbatimit të menaxhimit të qëndrueshëm të të gjitha llojeve të pyjeve, ndalimi i shpyllëzimit, ripërtëritja e pyjeve të degraduara dhe rritja e ndjeshme e pyllëzimit dhe ripyllëzimit globalisht;

15.3 Deri në vitin 2030, luftimi i shkretimit dhe rimëkëmbja e tokës dhe dheut të degraduar, duke përfshirë tokën e prekur nga shkretëzimi, thatësira dhe përmytjet, si dhe përmbushja e përpjekjeve për arritjen e një bote pa degradim toke

15.4 Deri në vitin 2030, sigurimi i ruajtjes së ekosistemeve malore, përfshirë biodiversitetin e tyre, me qëllim rritjen e kapacitetit të tyre për të ofruar përfitime që janë thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm;

15.5 Ndërmarrja e veprimeve urgjente dhe të rëndësishme për të ulur degradimin e habitateve natyrore, për të ndaluar humbjen e biodiversitetit dhe, deri në vitin 2030, për të mbrojtur dhe parandaluar zhdukjen e specieve në rrezik;

15.6 Promovimi i ndarjes së drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që rrjedhin nga shfrytëzimi i burimeve gjenetike dhe promovimi i aksesit të duhur në burime të tilla, siç është rënë dakord ndërkombëtarisht;

15.7 Ndërmarrja e veprimeve urgjente për t'i dhënë fund gjuetisë pa leje dhe trafikimit të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës dhe trajtimi i kërkesës dhe ofertës së produkteve të paligjshme të kafshëve të egra;

15.8 Deri në vitin 2030, prezantimi i masave për të parandaluar futjen dhe zvogëlimin e ndjeshëm të ndikimit të specieve të panjohura invazive në ekosistemet e tokës dhe ujit, dhe kontrolli ose zhdukja e specieve prioritare;

15.9 Deri në vitin 2030, integrimi i vlerave të ekosistemit dhe biodiversitetit në planifikimin kombëtar e lokal, në proceset e zhvillimit, strategjitë dhe raportet për uljen e varfërisë;

15.a Mobilizimi dhe rritja domethënëse e burimeve financiare nga të gjitha burimet për të ruajtur dhe përdorur në mënyrë të qëndrueshme biodiversitetin dhe ekosistemet;

15.b Mobilizimi i burimeve financiare të konsiderueshme nga të gjitha burimet dhe në të gjitha nivelet për të financuar menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe për të siguruar stimujt e duhur për vendet në zhvillim për të çuar më përpara një menaxhim të tillë, duke përfshirë konservimin dhe ripyllëzimin;

15.c Rritja e mbështetjes globale për luftimin kundër gjuetisë së paligjshme dhe trafikimit të specieve të mbrojtura, duke përfshirë rritjen e kapacitetit të komuniteteve lokale për të përdorur mundësi jetese të qëndrueshme.

Raporti mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm i vitit 2024 tregon se Shqipëria ka kryer progres të mirë për arritjen e OZHQ 15 por ka ende sfida të rëndësishme për t'u tejkaluar deri në përmbushjen e synimeve të Agjendës 2030. Ky vlerësim i raportit bazohet në ecurinë e treguesve të OZHQ15, të cilët tregojnë se katër nga pesë prej tyre janë të realizuar ose drejt realizimit të plotë deri në vitin 2030 (zonat e mbrojtura të liqeneve me rëndësi për biodiversitetin, indeksi i Listës së kuqe së specieve në mbijetim, shpyllëzimi i përherëshëm dhe shpyllëzimi i importuar). Por në njërin prej treguesve – sipërfaqja e zonave të mbrojtura, me rëndësi për biodiversitetin – progresi i kryer rezulton ende i pamjaftueshëm për arritjen e objektivit 2030.


Kuadri thelbësor strategjik: OZHQ15 është i fokusuar kryesisht në ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të biodiversitetit në tokë. SKZHIE 2030 e përfshin këtë tematikë në kuadër të shtyllës së dytë, Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ndërlidhjen dhe rritjen e gjelbër (Zhvillim i qëndrueshëm mjedisor), duke synuar mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit në vend, zhvillimin e sektorit të turizmit dhe realizimin e veprave të rëndësishme të infrastrukturës në vend duke pasur në konsideratë të përherëshme zhvillimin e qëndrueshëm, mbrojtjen e vlerave natyrore dhe biodiversitetin, si dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje. Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit është dokumenti kryesor strategjik që ka për qëllim sigurimin e një

zbatimi më efektiv dhe koherent të Konventës mbi Biodiversitetin në Shqipëri.

Objektivat që synohen të arrihen deri në vitin 2030 **sipas treguesve globalë të OZHQ-ve janë si vijon:**

15.1.1 Sipërfaqja pyjore në raport me sipërfaqen totale të tokës

Synimi për këtë tregues është që në vitin 2030 sipërfaqja pyjore të përbëjë 48% të sipërfaqes totale të tokës.



15.1.2 Përqindja e zonave të rëndësishme për biodiversitetin tokësor dhe të ujërave të ëmbla që mbulohen nga zonat e mbrojtura, sipas llojit të ekosistemit

Synimi për këtë tregues është që në vitin 2030 përqindja e zonave të rëndësishme për biodiversitetin tokësor dhe të ujërave të ëmbla që mbulohen nga zonat e mbrojtura të jetë 30%.

Sfida dhe mundësi

Rritja e sipërfaqes së zonave të mbrojtura kërkon rritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore për menaxhimin dhe monitorimin në terren të këtyre sipërfaqeve, përfshirjen e komuniteteve lokale në procesin e menaxhimit, duke mundësuar dhe promovimin e produkteve lokale si dhe përfshirjen e zonave të mbrojtura në zhvillimin ekonomik të vendit, përfshirë paketat ekoturistike të zonave të mbrojtura si destinacione turistike duke ndikuar pozitivisht në rritje të numrit të turistëve dhe ekonominë e vendit. Mungesa e kapaciteteve të duhura për menaxhimin dhe monitorimin në terren të këtyre zonave çon në shkelje të rregullave, si gjuetia dhe shfrytëzimi i paligjshëm i burimeve natyrore, duke ndikuar negativisht në ruajtjen e biodiversitetit. Shfrytëzimi i paqëndrueshëm i burimeve natyrore, përfshirë pyjet, ujërat dhe mineralet, përbën një sfidë të madhe për qëndrueshmërinë afatgjatë të ekosistemeve tokësore.

Degradimi i tokës, shpyllëzimi dhe erozioni janë probleme të mëdha në shumë zona rurale të Shqipërisë, të cilat ndikohen nga bujqësia intensive, mbishfrytëzimi i tokës, dhe ndërtimet pa planifikim. Shqipëria ka një biodiversitet të pasur, por ai është i kërcënuar nga shpyllëzimi, ndotja, zhvillimi urban dhe ndryshimet klimatike. Ndryshimet klimatike po ndikojnë në ekosistemet tokësore, me pasoja për pyjet, tokën bujqësore dhe biodiversitetin. Ngrohja globale, thatësitat, dhe reshjet e parregullta kontribuojnë në degradimin e habitateve natyrore dhe zhdukjen e specieve.

Institucionet më të rëndësishme të përfshira në arritjen e OZHQ15:

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit

Ministria e Mjedisit

Ndërlidhjet më të rëndësishme në Agjendën 2030 sipas kontekstit të Shqipërisë:

OZHQ 1, 3, 5, 10, 13, 14, 16

Lidhja kryesore me SKZHIE 2030:

Shtylla II: Zhvillim i qëndrueshëm mjedisor

Lidhja parësore me kapitujt e integritetit evropian:

Kapitulli 27: Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike

Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 16: Paqe dhe drejtësi, institucione të forta

Objektivi i OZHQ16 është promovimi i shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet, përmes synimeve të mëposhtme:

16.1 Ulja në mënyrë të ndjeshme e të gjitha formave të dhunës dhe niveleve përkatëse të vdekjeve kudo;

16.2 Dhënia fund abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe të gjitha formave të dhunës dhe torturimit të fëmijëve;

16.3 Promovimi i shtetit të së drejtës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe sigurimi i aksesit të barabartë në drejtësi për të gjithë;

16.4 Deri në vitin 2030, zvogëlimi i ndjeshëm i prurjeve të paligjshme financiare dhe armëve, forcimi i gjetjes dhe kthimit të pasurive të vjedhura dhe luftimi i të gjitha formave të krimit të organizuar;

16.5 Ulja në mënyrë të konsiderueshme e korrupsionit dhe mitmarrjes në të gjitha format e tyre;

16.6 Zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet;

16.7 Sigurimi i vendimmarrjes reaguese, përfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet;

16.8 Zgjerimi dhe forcimi i pjesëmarrjes së vendeve në zhvillim në institucionet e qeverisjes globale;

16.9 Deri në vitin 2030, sigurimi i identitetit ligjor për të gjithë, përfshirë regjistrimin e lindjeve;

16.10 Sigurimi i aksesit të publikut në informacion dhe mbrojtja e lirive themelore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare;

16.a Forcimi i institucioneve përkatëse kombëtare, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, për ndërtimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin;

16.b Promovimi dhe zbatimi i ligjeve dhe politikave jodiskriminuese për zhvillim të qëndrueshëm.

Raporti mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm i vitit 2024 tregon se OZHQ16 është një ndër tre objektivat e Agjendës 2030, për të cilat Shqipëria ka ende progres për të kryer e sfida të rëndësishme për t'u tejkaluar deri në përmbushjen e synimeve të Agjendës 2030. Vlerësimi i raportit bazohet në ecurinë e treguesve të OZHQ16, të cilët tregojnë se tre prej tyre janë të realizuar ose drejt realizimit të plotë deri në vitin 2030 (kontrolli efektiv mbi krimin, regjistrimet në lindje nga zyrat e gjendjes civile dhe eksporti i armëve konvencionale). Por Shqipëria ka ende progres për të kryer në arritjen e dy treguesve (numri i vrasjeve dhe fëmijët në punë) ndërkohë që sfidat janë edhe më të mëdha në arritjen e tre treguesve (indeksi i lirisë së shtypit, qasja dhe përballueshmëria e sistemit të drejtësisë, dhe kohëzgjatja e procedurave administrative). Së fundi, raporti tregon se progresi i deritanishëm është i pamjaftueshëm për arritjen synimeve 2030 në tre tregues (përqindja e të burgosurve ende të padënuar, indeksi i perceptimit të korrupsionit dhe kryerja e shpronësimeve që janë ligjore dhe të kompensuara si duhet).

Aksesi në drejtësi shihet si një nga komponentët kyç të qeverisjes shqiptare i ndërlidhur ngushtë me zbatimin e reformës në drejtësi, Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND), Strategjinë

Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur (SNDM), Strategjinë Ndërsektoriale të Mbrojtjes së Viktimave të Krimit (SNMVK), si dhe masat e tjera të ndërmarra nga qeveria në përmbushje të misionit të saj për një qeverisje të hapur, transparente dhe llogaridhënëse.

Në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024–2030, duke qenë se aksesit shihet si një komponent i rëndësishëm i reformës në drejtësi ky dokument synon ndër të tjera garantimin e aksesit në drejtësi për gratë dhe grupet vulnerabël si shtyllë themelore e shtetit të së drejtës dhe e barazisë gjinore. Ai parashikon rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut mbi ligjin, sistemin e drejtësisë dhe të drejtat procedurale përmes fushatave informuese dhe materialeve shpjeguese, përmirësimin e komunikimit të institucioneve me qytetarët si dhe krijimin e mekanizmave që lehtësojnë aksesin në drejtësi, veçanërisht për grupet më të cenueshme. Gjithashtu, me qëllim garantimin më të gjerë të aksesit në drejtësi, rritjen e efektivitetit dhe eficiencës në ofrimin e shërbimeve juridike falas për shtetasit në nevojë si dhe optimizimin e përdorimit të burimeve buxhetore, do të ndryshohet ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Ndryshimet në ligjin e ndihmës juridike synojnë ndërtimin e një sistemi më të qartë dhe të drejtë ku rregullat e përfitimit dhe zbatimit të ndihmës juridike të jenë të unifikuara dhe të kuptueshme për qytetarët dhe institucionet. Përmes zgjerimit të aksesit në drejtësi, rritjes së mbrojtjes për grupet më të ekspozuara dhe përmirësimit të bashkërendimit institucional krijohen kushte për vendimmarrje më të përgjegjshme, përdorim më të kontrolluar të burimeve publike dhe ulje të hapësirave për trajtim të pabarabartë duke forcuar kështu besimin e publikut dhe funksionimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të sistemit të drejtësisë.

Lidhur me sfidën e treguesit “*përqindja e të burgosurve ende të padënuar*”, duke qenë se varet nga shumë faktorë, konstatohet se referuar statistikave të datës 21.4.2026 në institucionet e paraburgimit në Shqipëri mbahen 2,391 shtetas me masë sigurie “*arrest në burg*”, prej të cilëve 14 të mitur dhe 34 gra. Numri i shtetasve të dënuar me vendim të formës së prerë është 1,965 prej të cilëve 6 të mitur dhe 33 gra. Gjithashtu, sistemi i burgjeve ka nën kujdes edhe 485 shtetas me masa mjekësore përfshirë mjekim të përkohshëm dhe mjekim të detyruar.

Gjatë dhjetë viteve të fundit numri i të paraburgosurve ka qenë më i lartë se numri i të dënuarve (në një raport 50:50 në vitin 2015), ndërsa aktualisht ky raport është 54.8% të paraburgosur dhe 45.2% të dënuar sipas të dhënave të datës 21.4.2026. Sipas të dhënave të publikuara nga *SPACE* për vitin 2024 vetëm 28% e popullatës së burgosur janë të paraburgosur.

Ky raport disproporcional ndërmjet të dënuarve dhe të paraburgosurve është krijuar për disa faktorë si:

a) Që prej vitit 2009 në Shqipëri funksionon shërbimi i provës dhe ka filluar aplikimi në masë të gjerë i dënimeve alternative;

b) Koha e qëndrimit në paraburgim është llogaritur mesatarisht 247 ditë, ndërsa gjatë këtij tremujori është 205 ditë. Kjo kohë nuk i tejkalon afatet e hetimit dhe gjykimit të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, por konsiderohet relativisht e gjatë;

c) Faktorë të tjerë përfshijnë mbingarkesën e sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë për shkak të mungesës së burimeve njerëzore si dhe vështirësinë e hetimit të disa veprave penale të kryera nga grupe kriminale dhe vonesat në kryerjen e ekspertizave.

Ministria e Drejtësisë e ka trajtimin e paraburgimit çështje prioritare me qëllim kufizimin e kësaj mase vetëm në raste të nevojshme dhe të domosdoshme, gjithmonë si mjet i fundit. Pavarësisht numrit të lartë të të paraburgosurve aktualisht në burgjet e vendit nuk ka mbipopullim, ku disponohen edhe 451 shtretër të lirë. Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka në prioritetin e saj përmirësimin e kushteve në burgjet e Shqipërisë.


Kuadri thelbësor strategjik

OZHQ16 është ndër objektivat më të rëndësishëm dhe kompleksë të Agjendës 2030 pasi trajton rolin e institucioneve në provimin e paqes, drejtësisë dhe kryerjen e reformave për arritjen e kësaj agjende të rëndësishme për të gjitha vendet. Nga natyra komplekse dhe shumëfunktionale e OZHQ16, sektorët që mbulohen prej tij në kuadër të Agjendës 2030 trajtohen thuajse në të gjitha seksionet e shtyllës së parë të SKZHIE 2030 (Demokracia e fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes së mirë), përjashtuar disa prej tyre që lidhen me synime specifike të OZHQ-ve të tjera të përfshira në këtë udhërrëfyes. OZHQ16 trajton nevojën e forcimit të mëtejshëm të institucioneve efikase si bazë që siguron demokracinë, konkurrencën dhe zhvillimin ekonomik të vendit duke e përgatitur atë për anëtarësim në BE. Funksionimi i sistemit të drejtësisë, modernizimi i shërbimeve publike dhe digjitalizimi, arritja e standardeve të BE-së në administratën publike, lufta ndaj korrupsionit dhe sigurimi i llogaridhënies dhe transparencës në sektorin publik, zgjerimi i decentralizimit dhe demokracisë vendore si dhe përfshirja e qytetarëve dhe shoqërisë civile në këto procese mbeten përparësi kyçe të qeverisjes së mirë për Shqipërinë. Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024–2030, Strategjia Ndërsektoriale e Mbrojtjes së Viktimave të Krimit 2024–2030, Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike 2023–2030, Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2025–2030, si dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Qeverisjen e Hapur, Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës 2023–2030, Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030, Strategjia ndërsektoriale e decentralizimit dhe qeverisjes vendore 2023–2030, Strategjia Kundër Krimit të Organizuar 2021–2025, Strategjia Kundër Terrorizmit 2021–2025, Agjenda Digjitale 2022–2026, Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2024–2030, Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur 2022–2026 etj. janë disa prej dokumenteve të tjera strategjike që mbulojnë fushat nën OZHQ16.

Objektivat që synohen të arrihen deri në vitin 2030 **sipas treguesve globalë të OZHQ-ve janë si vijon:**

16.1.1 Numri i viktimave të vrasjeve me dashje për 100,000 banorë, sipas gjinisë dhe moshës

Synimi për këtë tregues është që në vitin 2030 numri i viktimave të vrasjeve me dashje për 100,000 banorë të ulet me 10% nga mesatarja e periudhës 2019–2023 (1.9/100.000)



16.1.3 Përqindja e popullsisë, që u është nënshtruar: a) dhunës fizike; b) dhunës psikologjike; dhe c) dhunës seksuale në 12 muajt e mëparshëm

Synimi për këtë tregues është që në vitin 2030 përqindja e popullsisë që i është nënshtruar dhunës seksuale në 12 muajt e mëparshëm të ulet me 10% nga mesatarja e periudhës 2019–2023 (134 raste nga 149)

16.2.1 Përqindja e fëmijëve të moshës 1–17 vjeç që kanë përjetuar ndonjë ndëshkim fizik dhe/ose agresion psikologjik nga kujdestarët gjatë muajit të kaluar

Synimi për këtë tregues është që në vitin 2030 përqindja e fëmijëve të moshës 1-17 vjeç që kanë përjetuar ndonjë ndëshkim fizik dhe/ose agresion psikologjik nga kujdestarët gjatë muajit të kaluar të jetë sa mesatarja e periudhës 2019–2023 (46 raste ndëshkim fizik dhe 113 raste agresion psikologjik)

16.2.2 Numri i viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore për 100,000 banorë, sipas gjinisë, moshës dhe formës së shfrytëzimit

Synimi për këtë tregues është që në vitin 2030 numri i rasteve të evidentuara të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore për 100,000 banorë, sipas gjinisë, moshës dhe formës së shfrytëzimit të rritet me +2%.

Sfida dhe mundësi

Shqipëria është faktor i rëndësishëm në organizatat shumëpalëshe, duke u zgjedhur në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për 2022-2023 dhe kryesuar atë në shtator 2023, ka bashkëpropozuar dhe bashkëdrejtuar disa nisma të rëndësishme për Ukrainën dhe është në procesin e anëtarësimit në BE. Në konkluzionet e tij të fundit, të miratuara në dhjetor 2023, Këshilli Evropian përshëndeti progresin e reformave që ka bërë vendi në vitin e kaluar, duke përfshirë përfundimin me sukses të takimeve. Këshilli pret hapjen e grupit të parë të negociatave – që mbulon kapitujt mbi gjyqësorin, të drejtat themelore dhe drejtësinë. Rëndësia e Shqipërisë në rajon vërehet edhe në takime të nivelit të lartë: Takimi i Samitit të Procesit të Berlinit u mbajt në Tiranë në tetor 2023, për herë të parë dhe nëntë vjet pas fillimit të tij.

Reforma në drejtësi ka sjellë ndryshime të rëndësishme në përcaktimet institucionale të gjyqësorit shqiptar. Institucionet ekzistuese janë transformuar dhe institucione të reja janë krijuar përmes ligjeve specifike organike. Ngritja e institucioneve të reja si dhe vënia në funksionim e institucioneve ekzistuese ka nisur të japë rezultatet e para me goditjet që i janë dhënë krimit të organizuar dhe korrupsionit në vend. Institucionet shqiptare janë angazhuar në avancimin e zbatimit të reformës më gjithëpërfshirëse të ndërmarrë në sistemin e drejtësisë. Që nga fillimi i saj, reforma në drejtësi ka synuar përputhjen me standardet më të larta të arritshme të *acquis* në fushën e shtetit të së drejtës. Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës 2023-2030 ka si mision parësor konsolidimin e mëtejshëm të arritjeve të reformës në fushën e gjyqësorit në mënyrë të qëndrueshme dhe konsistente, me synimin për të rritur më tej pavarësinë llogaridhënien, cilësinë dhe efikasitetin e drejtësisë. Udhërrëfyesi planifikon vazhdimin e kryerjes së kontroleve të rregullta të përshtatshmërisë ligjore si dhe miratimin e ndryshimeve ligjore të nevojshme për konsolidimin, pavarësinë, integritetin, efikasitetin dhe rritjen e besimit të qytetarëve, në përputhje me *acquis* të BE-së dhe standardet evropiane duke përfunduar në vazhdimësi parimet e reformës së vitit 2016. Përsheptimi i reformave themelore, të përfshira në grupkapitullin “Themeloret”, synon mbështetjen e procesit të anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor në BE, përmirësimin e rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe forcimin e stabilitetit rajonal. Progresi i mëtejshëm në rikuperimin dhe kthimin e pasurive të vjedhura mbetet i nevojshëm, duke përfshirë funksionimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve. Me gjithë progresin e arritur, mbeten ende sfida në adresimin e flukseve të paligjshme financiare dhe krimit të organizuar.

Lufta ndaj korrupsionit është një nga sfidat kryesore me të cilat përballlet sistemi i reformuar i drejtësisë, duke ndikuar në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe në sektorët kryesorë të ekonomisë. Korrupsioni bren besimin e qytetarëve tek institucionet dhe pengon zhvillimin e qëndrueshëm. Dhuna

dhe kriminaliteti, përfshirë krimin e organizuar dhe trafikun e drogës, mbeten një problem me ndikim të madh në ekonominë e vendit dhe në stabilitetin social, duke krijuar pasiguri dhe pengesa për zhvillim të qëndrueshëm. Ekstremizmi dhe radikalizmi, edhe pse jo problem i madh në Shqipëri, përbëjnë një sfidë që kërkon vëmendje për të parandaluar përhapjen. Investimi në edukimin dhe integrimin e të rinjve është thelbësor për të ndaluar radikalizimin dhe për të promovuar paqen dhe stabilitetin social.

Institucionet më të rëndësishme të përfshira në arritjen e OZHQ16:

Ministria e Drejtësisë

Ministria e Punëve të Brendshme

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Ndërlidhjet më të rëndësishme në Agjendën 2030 sipas kontekstit të Shqipërisë:

OZHQ 1, 3, 5, 8, 10, 17

Lidhja kryesore me SKZHIE 2030:

Shtylla I: Reformimi i sistemit të drejtësisë;

Forcimi i të drejtave të njeriut

Forcimi i proceseve legislative dhe zgjedhore

Politika e jashtme

Lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit

Fuqizimi i rendit publik, mbrojtjes së vendit dhe përgatitja për rastet e emergjencave civile

Qeverisja e mirë, e hapur dhe administrimi publik

Transparenca dhe lufta kundër korrupsionit

Decentralizimi dhe fuqizimi i qeverisjes vendore

Lidhja parësore me kapitujt e integritetit evropian:

Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore

Kapitulli 24: Drejtësia, Liria dhe Siguria

Kriteri Themelor “Reforma në Administratën Publike”

dhe Kriteri “Funksionimi i Institucioneve Demokratike”

Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 17: Partneriteti për objektivat

Objektivi i OZHQ17 është forcimi i mjeteve të zbatimit dhe rivitalizimi i Partneritetit Global për Zhvillim të Qëndrueshëm, përmes synimeve të mëposhtme:

Financa

17.1 Forcimi i mobilizimit të burimeve të brendshme, duke përfshirë mbështetjen ndërkombëtare ndaj vendeve në zhvillim, për përmirësimin e kapacitetit të brendshëm për mbledhjen e tatimeve dhe të ardhurave;

17.2 Zbatimi plotësisht nga vendet e zhvilluara i angazhimeve zyrtare lidhur me asistencën për zhvillim, duke përfshirë angazhimin e shumë vendeve të zhvilluara për të arritur treguesin e synuar prej 0.7 përqindësh të të ardhurave kombëtare bruto për ndihmën zyrtare për zhvillim (ODA/GNI) për vendet në zhvillim, dhe 0.15 deri në 0.20 për qind të ODA-së/GNI-së për vendet më pak të zhvilluara; ofruesit e ODA-së inkurajohen të marrin parasysh përcaktimin e një objektivi për të siguruar të paktën 0.20 për qind të ODA-së/GNI-së për vendet më pak të zhvilluara;

17.3 Mobilizimi i burimeve financiare shtesë për vendet në zhvillim nga burime të shumëfishta;

17.4 Të ndihmuarit e vendeve në zhvillim për arritjen e qëndrueshmërisë afatgjatë të borxhit nëpërmjet politikave të koordinuara që kanë për qëllim nxitjen e financimit të borxhit, lehtësimin e

borxheve dhe ristrukturimin e borxhit, sipas nevojës, dhe trajtimin e borxhit të jashtëm të vendeve të varfra me borxh të lartë për të ulur shqetësimet e lidhura me borxhin

17.5 Miratimi dhe zbatimi i regjimeve të nxitjes së investimeve për vendet më pak të zhvilluara.

Teknologjia

17.6 Përforcimi i bashkëpunimit Veri-Jug, Jug-Jug dhe i bashkëpunimit trekëndor rajonal dhe ndërkombëtar lidhur me shkencën, teknologjinë dhe novacionin dhe aksesin në shkencë, teknologji dhe novacion, dhe rritja e shkëmbimit të njohurive bazuar në kushtet e dakordësuara reciprokisht, duke përfshirë përmirësimin e koordinimit midis mekanizmave ekzistues, veçanërisht në nivelin e Kombeve të Bashkuara, dhe nëpërmjet një mekanizmi global mundësimi teknologjie;

17.7 Promovimi i zhvillimit, transferimit, shpërndarjes dhe përhapjes së teknologjive të shëndosha mjedisore në vendet në zhvillim bazuar në kushte të favorshme, duke përfshirë kushtet koncesionare dhe preferenciale, ashtu siç bihet dakord reciprokisht;

17.8 Bërja plotësisht funksionale e bankës së teknologjisë dhe shkencës, mekanizmit për ndërtimin e kapaciteteve shkencore, teknologjike dhe novacionit për vendet më pak të zhvilluara deri në vitin 2017, dhe rritja e përdorimit të teknologjisë mundësuese, sidomos rritja e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Ndërtimi i kapaciteteve

17.9 Rritja e mbështetjes ndërkombëtare për realizimin e ndërtimit të kapaciteteve efektive dhe të synuara në vendet në zhvillim për të mbështetur planet kombëtare për zbatimin e të gjitha Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke përfshirë bashkëpunimin Veri-Jug, Jug-jug dhe bashkëpunimin trekëndor.

Tregtia

17.10 Promovimi i një sistemi tregtar shumëpalësh universal, të bazuar te rregullat, të hapur, jodiskriminues dhe të barabartë, në kuadrin e Organizatës Botërore të Tregtisë, duke përfshirë përfundimin e negociatave sipas Agjendës së Zhvillimit të Dohas.

17.11 Rritja domethënëse e eksporteve të vendeve në zhvillim, në veçanti për dyfishimin e përqindjes së eksporteve globale të vendeve më pak të zhvilluara deri në vitin 2030.

17.12 Realizimi i zbatimit në kohë të aksesit në tregje pa dogana dhe pa kuota, me baza të qëndrueshme, për të gjitha vendet më pak të zhvilluara, në përputhje me vendimet e Organizatës Botërore të Tregtisë, edhe nëpërmjet sigurimit që rregullat preferenciale me origjinë të zbatueshme mbi importet nga vendet më pak të zhvilluara të jenë transparente dhe të thjeshta, dhe të kontribuojnë për lehtësimin e aksesit në treg.

Çështje sistemike

Politikat dhe përputhshmëria e logjikës institucionale

17.13 Rritja e stabilitetit global makroekonomik, duke përfshirë koordinimin e politikave dhe koherencën e politikave;

17.14 Rritja e koherencës së politikave për zhvillim të qëndrueshëm;

17.15 Respektimi i hapësirës për politika dhe udhëheqje për secilin vend, për të përcaktuar dhe zbatuar politika për zhdukjen e varfërisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Partneritetet shumëpalëshe

17.16 Rritja e Partneritetit Global për Zhvillimin e Qëndrueshëm, shoqëruar me partneritete shumëpalëshe që mobilizojnë dhe ndajnë njohuri, ekspertizë, informacion mbi teknologjinë dhe burimet financiare, për të mbështetur arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në të gjitha vendet, veçanërisht në vendet në zhvillim;

17.17 Inkurajimi dhe promovimi i partneriteteve efektive publike, publike-private dhe me shoqërinë civile, duke u mbështetur te përvoja dhe strategjitë e burimeve të partneriteteve.

Të dhënat, monitorimi dhe llogaridhënia

17.18 Deri në vitin 2030, rritja e mbështetjes për ngritjen e kapaciteteve për vendet në zhvillim, duke përfshirë vendet më pak të zhvilluara dhe shtetet e vogla ishullore në zhvillim, për të rritur ndjeshëm disponueshmërinë e të dhënave me cilësi, në kohë dhe të besueshme, të ndara sipas të ardhurave, gjinisë, moshës, statusit të migracionit, aftësisë së kufizuar, vendndodhjes gjeografike dhe karakteristikave të tjera të rëndësishme në kuadrin kombëtar;

17.19 Deri në vitin 2030, mbështetja tek iniciativat ekzistuese dhe zhvillimi i tyre për matjen e progresit të zhvillimit të qëndrueshëm, që plotësojnë produktin e brendshëm bruto dhe mbështesin ndërtimin e kapaciteteve statistikore në vendet në zhvillim.

Raporti mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm i vitit 2024 tregon se progresi i Shqipërisë me OZHQ17 është i mirë por ende mbeten sfida të rëndësishme për t'u tejkaluar deri në përmbushjen e synimeve të Agjendës 2030. Vlerësimi i raportit bazohet në ecurinë e treguesve të OZHQ17, të cilët tregojnë se Shqipëria ka realizuar ose është drejt realizimit të plotë deri në vitin 2030 për dy tregues të këtij objekti (indeksi i performancës së statistikave dhe vlerësimi për parajsat fiskale). Por Shqipëria ka ende progres për të kryer në arritjen e tre treguesve të tjerë të këtij objekti (shpenzimet publike për arsim dhe shëndetësi, të ardhurat e qeverisë nga taksat e tatimet, dhe indeksi i mbështetjes shumëpalëshe të Kombeve të Bashkuara).

Kuadri thelbësor strategjik:

OZHQ17 është ndër objektivat më të rëndësishme dhe komplekse të Agjendës 2030 pasi trajton procesin e zhvillimit të qëndrueshëm nga shumë dimensione të rëndësishme, të ndërlidhura mes tyre dhe veçanërisht me objektivat e tjerë të Agjendës 2030. Nga natyra komplekse dhe shumëfunktionale e OZHQ17, fushat që mbulohen prej tij në kuadër të Agjendës 2030 trajtohen kryesisht në shtyllën e dytë Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ndërlidhjen dhe rritjen e gjelbër (Fuqizimi i sistemit financiar dhe politikës monetare, Fuqizimi i financave publike dhe stabiliteti fiskal, Zhvillimi i biznesit dhe tregtisë, mbrojtja e konkurrencës dhe promovimi i investimeve të huaja, Zgjerimi i kërkimit shkencor dhe inovacionit), si dhe statistikave që trajtohen në shtyllën e parë të SKZHIE 2030 (Demokracia e fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes së mirë), në seksionin qeverisja e mirë, e hapur dhe administrimi publik. Shqipëria është pjesë e *Open Government Partnership* që prej vitit 2011, duke ndërmarrë angazhime të vazhdueshme në drejtim të rritjes së transparencës, forcimit të llogaridhënies publike, pjesëmarrjes qytetare dhe qeverisjes së hapur. Në vijim të këtij angazhimi, aktualisht është në proces hartimi Plani Kombëtar i Veprimeve për Partneritetin për Qeverisjen e Hapur 2026–2030, i cili synon të konsolidojë më tej mekanizmat e bashkëpunimit ndër-institucional dhe dialogut me shoqërinë civile, si dhe të avancojë iniciativa konkrete në fushat e transparencës publike, aksesit në informacion, transformimit digjital dhe përmirësimit të ofrimit të shërbimeve publike, në përputhje me prioritetet kombëtare të zhvillimit dhe objektivat e OZHQ 17. Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2023-2030 është dokumenti sektorial kryesor strategjik që detajon politikat e financave publike dhe synon të sigurojë një sistem financiar publik që promovon transparencën, llogaridhënien, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe zhvillimin ekonomik. Programi i Statistikave Zyrtare 2022-2026 është dokumenti bazë që përcakton strategjinë e zhvillimit të statistikave zyrtare dhe Sistemit Kombëtar Statistikor për periudhën pesëvjeçare, duke synuar përmbushjen e kërkesave të përdoruesve për statistika cilësore.

Objektivat që synohen të arrihen deri në vitin 2030 **sipas treguesve globalë të OZHQ-ve janë si vijon:**

17.1.2 Përqindja e buxhetit të financuar nga taksat


Synimi për këtë tregues është që në vitin 2030 rreth 65% e buxhetit të financohet nga taksat kombëtare.

17.6.2 Lidhjet fikse të internetit me brez të gjerë për 100 banorë, sipas shpejtësisë

Synimi për këtë tregues është që në vitin 2030 rreth 30-35% e popullsisë të ketë lidhje fikse të internetit me brez të gjerë (nga 23% aktualisht).

17.8.1 Përqindja e individëve që përdorin internetin

Synimi për këtë tregues është që në vitin 2030 rreth 88-90%% e popullsisë të përdorë internetin (nga 83.1% aktualisht).



17.13.1 Paneli makroekonomik

Kuadri makroekonomik 2030, pjesërisht më poshtë, bashkëlidhur i plotë.

Treguesit kryesorë makroekonomik

Treguesit	Njësia	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
												Vler.	Para.	Para.	Para.	Para.	Para.	Para.	Para.
Popullsia	Milion	2.90	2.89	2.88	2.88	2.88	2.87	2.86	2.85	2.83	2.79	2.79	2.78	2.77	2.76	2.74	2.73	2.72	2.71
Inflacioni (mesatar)	%	1.9	1.6	1.9	1.3	2.0	2.0	1.4	1.6	2.0	6.7	4.8	3.0	3.0	3.0	3.0	3.0	3.0	3.0
Inflacioni (fund-viti)	%	1.9	0.7	2.0	2.2	1.8	1.8	1.1	1.1	3.7	7.4	3.7	3.0	3.0	3.0	3.0	3.0	3.0	3.0
Dellatori i PBB	%	0.3	1.5	0.6	-0.6	1.5	1.5	1.3	0.7	3.5	9.9	4.5	1.5	1.1	1.1	1.2	0.7	0.7	0.7
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	105.7	105.5	126.0	124.1	119.1	108.0	109.9	108.6	103.5	113.0	101.4	101.4	101.4	101.4	101.4	101.4	101.4	101.4
Kursi i këmbimit (fund-viti)	Lek / Euro	140.3	140.0	139.7	137.4	134.2	127.6	123.0	123.8	122.5	119.0	109.5	109.5	109.5	109.5	109.5	109.5	109.5	109.5
Kursi i këmbimit (fund-viti)	Lek / USD	102.4	113.6	126.6	128.3	112.6	108.4	109.9	101.6	106.9	108.5	100.1	100.1	100.1	100.1	100.1	100.1	100.1	100.1
Kursi i këmbimit (fund-viti)	Lek / Euro	140.2	140.1	137.7	135.3	133.2	123.5	122.2	123.5	120.8	114.9	110.0	110.0	110.0	110.0	110.0	110.0	110.0	110.0
Faktori i Konverimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPP)	Lek / USD	44.1	42.9	42.7	42.4	42.3	41.1	41.3	42.5	41.5	41.5	41.0	40.8	40.5	40.3	40.1	39.8	39.6	39.6
Faktori i Konverimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPP)	Lek / Euro	54.8	54.0	51.7	54.8	56.0	56.9	57.1	58.3	57.8	58.0	58.3	58.5	58.8	58.9	59.0	59.2	59.4	59.9
Rritja reale e PBB	%	1.0	1.8	2.2	3.3	3.8	4.0	2.1	-3.3	8.9	4.9	3.5	3.7	3.9	4.0	3.9	4.1	3.9	3.9
Rritja nominale e PBB	%	1.3	3.4	2.8	2.7	5.3	5.6	3.4	-2.6	12.7	15.2	8.1	5.3	5.1	5.2	5.1	4.8	4.7	4.6
PBB	Lek miliardë	1,350.1	1,395.3	1,434.3	1,472.5	1,550.6	1,636.7	1,691.9	1,647.4	1,656.2	2,138.3	2,311.7	2,434.3	2,557.7	2,680.5	2,828.6	2,964.0	3,104.0	3,247.1
PBB	USD miliardë	12.8	13.2	11.4	11.9	13.0	15.2	15.4	15.2	17.9	18.9	22.8	24.0	25.2	26.5	27.9	29.2	30.6	32.0
PBB	Euro miliardë	9.6	10.0	10.3	10.7	11.6	12.8	13.8	13.3	15.2	18.0	21.1	22.2	23.3	24.6	25.8	27.1	28.3	29.6
PBB për banor	Lek mijë	466.3	483.0	497.9	512.0	539.1	570.2	591.1	578.9	656.0	765.4	829.8	876.6	924.3	976.1	1,030.8	1,084.8	1,140.9	1,198.5
PBB për banor	USD	4,412.5	4,578.7	3,952.8	4,123.9	4,526.1	5,280.5	5,380.7	5,327.8	6,336.5	6,771.3	8,180.2	8,641.2	9,111.6	9,622.7	10,161.7	10,694.5	11,247.4	11,815.4
PBB për banor	Euro	3,324.5	3,450.3	3,563.0	3,727.1	4,018.3	4,469.3	4,804.9	4,677.1	5,356.4	6,433.3	7,574.9	8,001.9	8,437.4	8,910.7	9,409.8	9,903.2	10,415.2	10,941.1
PBB për banor	USD-PPP	10,571.0	11,259.3	11,658.9	12,078.8	12,757.1	13,479.6	14,366.0	14,024.0	15,433.5	18,465.9	20,017.6	21,358.0	22,678.9	24,103.2	25,565.7	27,081.6	28,645.8	30,255.8
PBB për banor	Euro-PPP	8,503.6	8,939.8	9,637.3	9,343.3	9,623.5	10,017.6	10,352.9	9,936.6	11,351.5	13,195.7	14,243.7	14,962.0	15,725.3	16,560.7	17,457.5	18,325.8	19,207.5	20,021.0
Të ardhurat e disponueshme kombëtare bruto (GNDI)	Lek miliardë	1,468.7	1,509.6	1,558.8	1,609.1	1,668.2	1,750.8	1,789.2	1,743.8	1,962.4	2,232.0	2,413.4	2,535.9	2,654.7	2,786.6	2,918.8	3,050.5	3,186.9	3,325.6
Të ardhurat e disponueshme kombëtare bruto (GNDI)	Euro miliardë	10.5	10.8	11.2	11.7	12.4	13.7	14.5	14.1	16.0	18.8	22.0	23.1	24.2	25.4	26.6	27.8	29.1	30.4
GNDI për banor	Lek mijë	507.3	522.5	541.1	559.5	579.9	610.0	625.1	612.7	693.5	799.0	866.3	913.1	959.3	1,011.0	1,063.7	1,116.5	1,171.4	1,227.5
GNDI për banor	Euro mijë	3,616.6	3,732.8	3,872.2	4,072.9	4,323.0	4,780.6	5,081.3	4,950.6	5,662.9	6,715.3	7,908.3	8,336.6	8,757.4	9,229.0	9,710.0	10,192.0	10,693.4	11,205.7
GNDI për banor	USD	4,800.2	4,953.7	4,255.8	4,505.5	4,899.3	5,648.3	5,690.2	5,639.4	6,699.0	7,068.1	8,540.2	9,001.7	9,457.1	9,966.4	10,465.8	11,006.4	11,547.9	12,101.1
GNDI për banor	USD-PPP	11,499.9	12,181.2	12,670.5	13,199.4	13,724.3	14,418.7	15,192.4	14,844.1	16,316.4	19,275.2	20,888.7	22,249.0	23,539.0	24,964.1	26,381.0	27,871.3	29,411.0	30,967.5
GNDI për banor	Euro-PPP	9,250.9	9,671.8	10,473.5	10,210.1	10,353.2	10,715.5	10,948.4	10,517.7	12,000.9	13,774.0	14,870.6	15,607.0	16,321.6	17,152.2	18,014.3	18,860.3	19,720.5	20,505.1
Rritja e GNDI në EUR / banor	%	0.9	3.2	3.7	5.2	6.1	10.6	6.3	-2.6	14.4	18.6	17.8	5.4	5.1	5.4	5.2	5.0	4.9	4.8
Norma e papunësisë (15-64 vjeç)	%	16.1	17.9	17.5	15.6	14.1	12.8	12.0	12.2	12.0	11.3	10.6	10.2	9.8	9.5	9.3	9.0	8.8	8.6

Sfida dhe mundësi

Për të arritur OZHQ17, Shqipëria do duhet të fokusohet në forcimin e kapaciteteve institucionale, përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe partneriteteve publiko-private, dhe mobilizimin efektiv të burimeve financiare dhe teknologjike. Ndërgjegjësimi publik dhe përfshirja e qytetarëve në proceset vendimmarrëse do të jenë, gjithashtu, të rëndësishme për arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm.

Shqipëria është e angazhuar plotësisht në procesin e integrimit në Bashkimin Evropian, por ky proces përballlet me sfida të shumta që kërkojnë zbatimin e reformave të nevojshme për harmonizimin e legjislationit dhe praktikave me ato të BE-së. Koordinimi efektiv ndërmjet institucioneve është thelbësor për suksesin e këtij procesi. Për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm është i nevojshëm financimi i projekteve madhore dhe rajonale në infrastrukturë, energjitë e rinovueshme, telekomunikacion etj. për të cilat kërkohen investime të huaja dhe mbështetje ndërkombëtare, që mund të jenë të kufizuara.

Shqipëria ka nevojë për kuadër më të fortë rregullator dhe politika që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm në të gjitha sektorët. Kjo përfshin zhvillimin e legjislationit që nxit partneritetet ndërkombëtare, mobilizimin e burimeve dhe përfshirjen e sektorit privat dhe shoqërisë civile në zbatimin e OZHQ-ve.

Institucionet më të rëndësishme të përfshira në arritjen e OZHQ17:

Ministria e Financave

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin

AKEP

INSTAT

AKSHI

Ndërlidhjet më të rëndësishme në Agjendën 2030 sipas kontekstit të Shqipërisë:

OZHQ 1, 3, 5, 8, 9, 10, 11, 12, 16, 17

Lidhja kryesore me SKZHIE 2030:

Shtylla I: Qeverisja e mirë, e hapur dhe administrimi publik (statistikat)

Shtylla II: Fuqizimi i sistemit financiar dhe politikës monetare

Fuqizimi i financave publike dhe stabiliteti fiskal

Zhvillimi i biznesit dhe tregtisë, mbrojtja e konkurrencës dhe promovimi i investimeve të huaja

Zgjerimi i kërkimit shkencor dhe inovacionit

Lidhja parësore me kapitujt e integrimit evropian:

Kapitulli 17: Politika Ekonomike dhe Monetare

Kapitulli 18: Statistikat

Financimi i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm

Përbushja e objektivave për zbatimin e Agjendës 2030 kërkon jo vetëm vullnet për arritjen e tyre por dhe angazhim të rëndësishëm të burimeve financiare nga të gjitha vendet e përfshira në këtë proces, përfshirë Shqipërinë. Kompleksiteti i strukturës së OZHQ-ve, ndërlidhjet mes tyre dhe procesit të zhvillimit të qëndrueshëm në vend e bën të vështirë, në mos të pamundur llogaritjen e saktë të efekteve financiare për arritjen e OZHQ-ve në Shqipëri.

Njëkohësisht është e rëndësishme të theksohet se arritja e OZHQ-ve nuk është një detyrim ekskluziv i qeverisë apo i financimit publik por procesi lidhet ngushtë edhe me disa burime të ndryshme, përfshirë financimet nga donatorët ndërkombëtarë partnerë të zhvillimit, organizatat joqeveritare që janë aktive në vend, dhe veçanërisht, financimet e sektorit privat. Pjesë e rëndësishme e këtij procesi është dhe identifikimi i mjeteve dhe instrumenteve inovative për shfrytëzimin e burimeve financiare shtesë që mund të vihen në funksion të arritjes së objektivave të Agjendës 2030 përmes një strategjie kombëtare të integruar të financimit (INFF).


Nga specifikat e strukturës së ekonomisë dhe potencialit të zhvillimit të vendit, sektori privat ka një rol parësor dhe shpesh edhe më të rëndësishëm se ai publik në financimin e disa prej synimeve të

Agjendës 2030. Më të rëndësishme në këtë aspekt vlerësohen investimet në sektorin energjetik dhe burimet natyrore në vend (OZHQ7), zhvillimi i infrastrukturës, transportit dhe telekomunikacionit (OZHQ9), zhvillimi i turizmit dhe punësimi i qëndrueshëm (OZHQ8), zhvillimi i sistemit arsimor (OZHQ4), bujqësia (OZHQ2) etj.

Gjatë periudhës 2015–2019, u arrit një progres i mirë në përafrimin e financave publike me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, me rreth 85% të shpenzimeve publike të orientuara drejt këtyre objektivave. Përafrimi ishte veçanërisht i lartë në fushat e mbrojtjes sociale, arsim, shëndetësi dhe infrastrukturë, duke reflektuar prioritetet e qeverisë për reduktimin e varfërisë, zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe të ekonomisë. Megjithatë, analiza e buxhetit gjatë kësaj periudhe identifikoi sfida në realizimin e shpenzimeve, koordinimin institucional dhe sigurimin e financimeve në fusha si veprimi për klimën, barazia gjinore dhe reformat në qeverisje. Shpenzimet për mbrojtjen sociale paraqisnin zërin kryesor në buxhet (rreth 43% të buxhetit total), kryesisht për pensione, ndihmë ekonomike dhe pagesa papunësie. Promovimi i barazisë gjinore u pasqyrua në këtë periudhë edhe në buxhet, veçanërisht përmes zbatimit të buxhetimit të ndjeshëm gjinor. Megjithatë, financimi për programet specifike gjinore mbeti minimal, duke përfaqësuar vetëm 0.03% të PBB-së. Iniciativat për fuqizimin ekonomik të grave kanë qenë të kufizuara, ndonëse përfaqësimi politik dhe pjesëmarrja në vendimmarrje njohën rritje të ndjeshme.

Gjatë kësaj kohe u krijuan premiset e duhura për një buxhetim të strukturuar dhe të harmonizuar me OZHQ-të në Shqipëri. Përvoja e fituar nga vlerësimet fillestare të shpenzimeve të lidhura me OZHQ-të dëshmoi nevojën për një koordinim më të mirë ndërinstitutional dhe mekanizma më të qëndrueshëm për ndjekjen dhe vlerësimin e shpenzimeve në funksion të OZHQ-ve. Këtu përfshihet integrimi i sistemit të shënimit të OZHQ-ve në proceset buxhetore, riallokimi i burimeve drejt objektivave më pak të financuar, si veprimi për klimën dhe barazia gjinore, si dhe shfrytëzimi i mekanizmave inovativë të financimit, obligacionet OZHQ dhe modelet e financimit publik e privat, për të reduktuar varësinë nga financimi i huaj.

Periudha pas pandemisë COVID-19 solli transformime të rëndësishme në zbatimin e financave publike të Shqipërisë, duke pasqyruar një rishikim të prioriteteve buxhetore dhe një ndryshim të dukshëm në financimin e jashtëm. Sipas të dhënave të financimit të SKZHIE 2030, identifikohen tri tendenca kryesore: investimi i vazhdueshëm në mbrojtjen sociale, intensifikimi i fokusit në rritjen ekonomike dhe zhvillimin e infrastrukturës, si dhe një reduktim gradual i rolit të financimit të jashtëm në shpenzimet publike. Gjatë periudhës 2016–2024, rreth 4.12 trilionë lekë, ose 93% e shpenzimeve totale buxhetore nga burime të brendshme dhe të jashtme, kanë kontribuar në përmbushjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri.



Financimet sipas OZHQ, në mil.Lekë (vlerësim paraprak)

Financimi i SKZHIE 2030 (më parë SKZHI 2016–2020) është përqendruar kryesisht tek shtylla e zhvillimit social dhe kohezionit, e cila ka përfshirë më shumë se 50% të buxhetit total gjatë periudhës 2016–2025. Kjo kategori përfshin financimin e sektorëve kyç si: shëndetësia, arsimi, kultura dhe mbrojtja sociale. Rritja e qëndrueshme dhe e gjelbër, që mbulon zhvillimin ekonomik, transportin, infrastrukturën e ujit dhe mbrojtjen e mjedisit, përbën mesatarisht 30% të totalit të shpenzimeve buxhetore gjatë kësaj periudhe. Ndërkohë, shpenzimet për qeverisjen e mirë, demokracinë dhe sundimin e ligjit, duke përfshirë financimin e administratës publike dhe funksionimin e institucioneve të pavarura, zënë afërsisht 18% të buxhetit në të njëjtën periudhë.

Duke marrë parasysh shkallën e financimit të nevojshëm për të arritur OZHQ-të, financimet nga buxheti i shtetit nuk janë të mjaftueshme. Për këtë arsye Shqipëria mund të shfrytëzojë modelet e financimit të përzier për të tërhequr investime private në projekte të përafruara me OZHQ-të, duke përdorur fonde publike, financime koncesionare ose garanci për të reduktuar rreziqet për investitorët privatë. Partneritetet Publiko-Private (PPP) në infrastrukturë dhe shërbime sociale mund të zgjerojnë kapacitetet buxhetore duke përfutur nga ekspertiza e sektorit privat. Instrumente të tjera si Obligacionet OZHQ dhe Obligacionet e Gjelbra ofrojnë mundësi për të siguruar kapital nga investitorët për financimin e projekteve klimatike dhe infrastrukturës së qëndrueshme.

Së fundmi, qeveria është në proces të themelimit të Bankës së Zhvillimit, e cila pritet të ofrojë financime për sektorin privat në mbështetje të rritjes së qëndrueshme. Një tjetër mjet i rëndësishëm është prokurimi publik i gjelbër: duke përfshirë kriteret e qëndrueshmërisë në politikat e prokurimit, qeveria mund të nxisë ndryshime të gjera në treg, duke promovuar prodhimin dhe konsumimin e qëndrueshëm dhe duke përforcuar prioritetet e SDG-ve në të gjithë ekonominë.

Në këtë kuadër, qeveria shqiptare dhe zyra e Kombeve të Bashkuara në Tiranë kanë krijuar Fondin e Përsheptimit të OZHQ-ve në Shqipëri. Qeveria shqiptare është angazhuar për një kontribut vjetor prej 2 milionë dollarësh në këtë fond, të mbështetur nga partnerët e zhvillimit. Fondi ka luajtur një rol vendimtar pas vitit 2019, veçanërisht në mbështetjen e nismave të rimëkëmbjes pas tërmetit në fusha të tilla si arsimi, mbrojtja sociale, barazia gjinore, mbrojtja e fëmijëve, rimëkëmbja ekonomike, bujqësia dhe infrastruktura duke krijuar interes për pjesëmarrje në financim nga partnerët si një mjet me kosto efektive.

Përafrimi i financave publike me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm është thelbësor për mobilizimin e burimeve financiare dhe garancinë që shpenzimet publike të orientohen në mënyrë


strategjike drejt projekteve dhe politikave që kontribuojnë në arritjen e OZHQ-ve. Për të maksimizuar efektivitetin e shpenzimeve buxhetore, kërkohet një kombinim i politikave efektive fiskale, instrumenteve inovative të financimit dhe një koordinim institucional më i fortë.

Një nga mekanizmat kryesorë për të forcuar përafrimin e shpenzimeve buxhetore me OZHQ-të është pasqyrimi i qartë i prioriteteve të zhvillimit të qëndrueshëm në buxhet. Aktualisht, qeveria akordon burime të konsiderueshme për shërbimet sociale, infrastrukturën dhe programet mjedisore, megjithatë, efikasiteti dhe efektiviteti i këtyre alokimeve ndryshojnë ndjeshëm. Përmes integritetit të sistemit të shënjimit të OZHQ-ve në plan-buxhete, mund të identifikohen sektorët dhe projektet që kontribuojnë më shumë në objektivat kombëtare të qëndrueshmërisë. Një sfidë madhore në këtë drejtim mbetet balancimi midis kufizimeve fiskale afatshkurtra dhe investimeve afatgjata në OZHQ-të. Investimet në forcimin e rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike, sistemet arsimore dhe shëndetësore kërkojnë kosto fillestare të larta, por sjellin përfitime të mëdha ekonomike dhe sociale në afatgjatë. Për këtë arsye, kërkohet një qasje buxhetimi me vizion të gjatë, duke integruar kuadro shumëvjeçare planifikimi që balancojnë nevojat fiskale të menjëhershme me objektivat afatgjatë të zhvillimit të qëndrueshëm.

Për shkak të faktorëve të mësipërm efektet financiare për arritjen e synimeve të përcaktuara të Agjendës 2030 mbeten komplekse për t'u identifikuar si pjesë e shpenzimeve publike deri në vitin 2030. Por ka të paktën tri mënyra që ofrojnë një vlerësim mbi këtë çështje:

a) Vlerësimet globale dhe rajonale. Sipas vlerësimeve të organizatave ndërkombëtare, kostoja për arritjen e OZHQ-ve në nivel global vlerësohet të jetë në rreth 5% deri në 10% të PBB-së globale çdo vit. Ky është një vlerësim i përgjithshëm dhe mund të ndryshojë ndjeshëm në varësi të vendit dhe nivelit të tij të zhvillimit por në vendet në zhvillim, kostoja si pjesë e PBB-së mund të jetë shumë më e lartë, duke kaluar mbi 10% të PBB-së, për shkak të hendekut më të madh në këto vende në infrastrukturë, shërbimet sociale dhe fusha të tjera që kanë nevojë për investime të konsiderueshme.

b) Analiza e përvojës së viteve të kaluara. Pjesë e një analize të kryer mbi zbatimin e OZHQ-ve në Shqipëri gjatë periudhës 2015-2024, tregoi se afërsisht, në këtë periudhë, rreth 93% e buxhetit të shpenzuar (2016-2024) ishte e lidhur drejtpërdrejt me projekte konkrete në funksion të arritjes së objektivave të Agjendës 2030, ku peshën më të lartë e kanë shpenzimet publike në OZHQ 1, 3, 4, 9 dhe 10.



c) Vlerësimi i shpenzimeve të lidhura me OZHQ-të deri në vitin 2030. Ndonëse nuk ka një vlerësim të plotë të kostove financiare për zbatimin e SKZHIE 2030, e cila përmbledh kuadrin

strategjik të vendit si dhe lidhjet përkatëse me OZHQ-të, strategjitë kryesore sektoriale dhe ndërsektoriale, një pjesë e mirë e të cilave shtrihen deri në vitin 2030, kanë të përfshira pjesën e kostimit të tyre. Nga të dhënat e disponueshme nga Dokumenti i Politikave Prioritare 2027-2029 rezulton se kosto për realizimin e objektivave të këtyre strategjive gjatë periudhës 2027–2029 është 723.9 mld lekë (ose rreth 7,4 mld euro).

Nr	Strategjia	2027	2028	2029	Totali 2027-2029 (000)
1	Strategjia Ndërsektoriale e Reformës së Administratës Publike 2025-2030, Plani i Veprimit 2025-2027	1,854,692	1,854,692	1,854,692	5,564,076
2	Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030	330,587	330,587	330,587	991,761
3	Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021-2030	44,897,500	44,897,500	44,897,500	134,692,500
4	Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024-2030	40,769,730	40,769,730	40,769,730	122,309,190
5	Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029	795,726	795,726	795,726	2,387,178
6	Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030	3,445,161	3,445,161	3,445,161	10,335,483
7	Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030	285,714	285,714	285,714	857,142
8	Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018-2030	48,604,000	48,604,000	48,604,000	145,812,000
9	Strategjia Kombëtare e Ujitjes dhe Kullimit 2019-2031 dhe Plani i Veprimit	7,940,910	7,940,910	7,940,910	23,822,730
10	Strategjia Sektoriale e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030	9,439,233	9,439,233	9,439,233	28,317,699
11	Strategjia Sektoriale e Zvogëlimit të Rrisht nga Fatkeqësitë 2023-2030	23,259,160	23,259,160	23,259,160	69,777,480
12	Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030	3,353,686	3,353,686	3,353,686	10,061,058
13	Strategjia e Specializimit Inteligent (S3) 2025-2030	20,703,321	20,703,321	20,703,321	62,109,963
14	Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023-2030	17,081,326	23,457,655	17,557,825	58,096,806
15	Strategjia Sektoriale e Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030	3,310,594	3,310,594	3,310,594	9,931,782
16	Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024-2030	262,408	262,408	262,408	787,224
17	Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë, Plani i Veprimit 2024-2030	638,264	638,264	638,264	1,914,792
18	Dokumenti Politik Kombëtar për Moshimin 2025-2030	1,449,935	1,644,557	1,782,997	4,877,489
19	Dokumenti Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Plani i Veprimit 2025-2030	119,379	125,363	125,363	370,105
20	Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025-2030 dhe Plani i Veprimit 2025-2027	171,509	171,509	171,509	514,527
21	Strategjia Afatgjatë e Rinovimit të Stokut të Ndërtesave	760,000	760,000	760,000	2,280,000
22	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2025-2030	422,446	188,967	128,011	739,424
23	Strategjia Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë 2026-2028 dhe Plani i Veprimit	4,000	4,000	4,000	12,000
24	Strategjia Kombëtare Kundër Mashtërimit për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Bashkimit Evropian, 2025-2030 dhe Planit të Veprimit	6,510	6,510	6,510	19,530
25	Strategjia për Modernizimin dhe Harmonizimin e Sistemeve të Informacionit Doganor Shqiptar në Përputhje me Sistemet e Informacionit Doganor të Bashkimit Evropian, për periudhën 2025-2030 dhe të Planit të Veprimit	274,400	196,000	235,200	705,600
27	Strategjia Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2025-2030 dhe të Planit të Veprimit 2025-2028	1,038,151	1,038,151	1,038,151	3,114,452
Strategjitë sektoriale që janë akoma në proces dhe që përfundojnë në 2027					
26	Strategjia Kombëtare e Sigurisë Ushqimore 2023-2027	481,088			481,088
27	Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027	21,882,600			21,882,600
28	Strategjia për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 dhe të Planit të saj të Veprimit	1,200,942			1,200,942
				Totali 000 (ALL)	723,966,621
				Totali 000 (€)	7,387,414

Bazuar në sa më sipër si dhe duke pasur parasysh rolin në rritje të sektorit privat në zhvillimin e vendit, një vlerësim i përgjithshëm mbi koston e arritjes së OZHQ-ve në Shqipëri deri në vitin 2030, tregon se shpenzimet do të vijojnë të mbajnë strukturë të ngjashme sipas OZHQ-ve me atë të

periudhës pararendëse 2015–2025, ndërkohë që do të kërkojë angazhimin e shpenzimeve publike vjetore në masën rreth 12% deri 15% të PBB-së.

Raportimi i dytë Vullnetar i Shqipërisë mbi arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm kërkon nga shtetet pjesëmarrëse të “kryejnë rishikime të rregullta dhe gjithëpërfshirëse të progresit në nivelet kombëtare dhe lokale, të cilat udhëhiqen nga vendi dhe drejtohen nga vendi” (paragrafi 79). Këto raportime kombëtare, janë pjesë e mekanizmit të rishikimit dhe matjes së progresit të zbatimit të Agjendës 2030 dhe shërbejnë si bazë për rishikimet e rregullta nga forumi politik i nivelit të lartë pranë Kombeve të Bashkuara. Siç përcaktohet në paragrafin 84 të Agjendës 2030, rishikimet e rregullta duhet të jenë vullnetare, të udhëhequra nga shteti, të ndërmarra si nga vendet e zhvilluara ashtu edhe nga ato në zhvillim dhe të përfshijnë shumë aktorë. VNR-të, gjithashtu, synojnë të forcojnë politikat dhe institucionet e qeverive dhe të mobilizojnë mbështetjen dhe partneritetet e shumë palëve për zbatimin e OZHQ-ve.

Në vitin 2018, Shqipëria ka paraqitur Raportin e parë Vullnetar Kombëtar me temën “Transformimi drejt shoqërive të qëndrueshme dhe elastike” mbi OZHQ-të në Forumin Politik të Nivelit të Lartë 2018 në Nju Jork. Ky forum është platforma kryesore e Kombeve të Bashkuara për zhvillimin e qëndrueshëm dhe ka një rol qendror në ndjekjen dhe rishikimin e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm në nivel global. Shqipëria ishte vendi i parë në rajon që zgjodhi përgatitjen e VNR-së, e cila synon të promovojë shkëmbimin e përvojave, përfshirë sukseset, sfidat dhe mësimet e nxjerra, me synimin për të përshpejtuar zbatimin e Agjendës 2030.

Raporti i parë Vullnetar Kombëtar i Shqipërisë (<https://hlpf.un.org/countries/albania>) është i fokusuar në progresin e kryer në kuadër të Agjendës 2030 sipas prioritetëve të qeverisë. Raporti është përgatitur me mbështetjen e Zyrës së Kombeve të Bashkuara në Tiranë dhe me pjesëmarrjen aktive të të gjitha institucioneve të përfshira në proces.

Sipas rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara, çdo vend duhet të paraqesë të paktën dy raportime të tilla gjatë periudhës 2015-2030, ndaj viti 2026 është periudha më e mirë për paraqitjen e raportit të dytë nga Shqipëria në forumin e nivelit të lartë të OKB-së (HLPF) për 2026 që zhvillohet gjatë muajit korrik 2026.

Përgatitja e raportit të dytë të Shqipërisë do të bazohet në rishikimin e progresit të kryer në drejtim të arritjes së OZHQ-ve dhe zbatimit deri në fund të vitit 2025 të SKZHIË 2030, si dhe dokumenteve kryesore strategjike të vendit, duke analizuar më në detaje OZHQ-të që janë në fokus të diskutimit të forumit të nivelit të lartë të OKB-së. SASPAC do të koordinojë punën për përgatitjen e këtij raporti nga grupi ndërinstitutional i punës, duke u bazuar në të dhënat e raportuara nga INSTAT dhe institucionet e tjera të përfshira në proces, duke bashkëpunuar ngushtë me organizatat e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri si dhe të gjitha organizatat aktive në këto fusha, për të përgatitur miratimin e dokumentit përfundimtar në Komitetin Ndërministror për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Raporti, gjithashtu, do të paraqesë në mënyrë të përmbledhur hapat që Shqipëria do të ndjekë deri në përfundim të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm si dhe do të përfshijë aneksin statistikor të përgatitur nga INSTAT-i mbi ecurinë e treguesve OZHQ.

Mbështetur në përvojën e përgatitjes së raportit të parë vullnetar si dhe të raporteve të prezantuara nga vendet e tjera, propozohet që raporti i dytë vullnetar i Shqipërisë të strukturohet në përmbajtje si vijon:

A. Përshëndetje/Fjalë hyrëse (1 faqe), nga nivel i lartë qeverisës, që përmbledh arritjet kryesore të Shqipërisë në zbatim të Agjendës 2030 si dhe qasjen strategjike të ndjekur deri në përfundim me sukses të plotë të saj.

B. Përmbledhje (2 faqe). Pasqyrim i çështjeve kryesore të raportit dhe vështrim i treguesve më të rëndësishëm për Shqipërinë, bazuar në të dhënat statistikore. Evidentim i faktorëve kryesorë të

suksesit apo dështimit për të arritur progresin. Vlerësime për zbatimin e parimit të moslënies së askujt pas. Shembuj ilustrues të praktikave të mira, sfidave dhe mësimave të nxjerra që mund të jenë të rëndësishme në kontekstin rajonal e global.

C. Metodologjia (1 faqe). Përfshin shkurtimisht metodologjinë për përgatitjen e raportit, institucionet e përfshira në proces, konsultimin me të gjithë aktorët qendrorë e lokalë në vend, akademinë, biznesin apo shoqërinë civile etj.

D. Politikat e zhvillimit dhe zbatimi i tyre (rreth 15 faqe). Kjo pjesë është thelbësore në përmbajtjen e raportit dhe paraqet kuadrin strategjik, ligjor dhe politikat e zhvillimit të ndjekura nga Shqipëria për arritjen e objektivave të Agjendës 2030. Në këtë seksion do të shtjellohen:

- a) Progresi i kryer që nga përgatitja e raportit të parë vullnetar të Shqipërisë;
- b) Përfshirja e OZHQ-ve në kuadrin strategjik e ligjor të miratuar gjatë kësaj periudhe;
- c) Ndërlidhjet dhe sinergjitë midis dimensioneve ekonomike, sociale dhe mjedisore të zhvillimit në Shqipëri;
- d) Përpjekjet në kuadër të Agjendës 2030 për të mos lënë askënd prapa;
- e) Funksionimi i mekanizmave institucionalë për arritjen e OZHQ-ve në Shqipëri;
- f) Proceset reformuese që kanë pasur ndikim në arritjen e OZHQ-ve.

E. Progresi sipas objektivave dhe synimeve (rreth 15 faqe). Në këtë seksion do të shtjellohet një analizë cilësore, shoqëruar me tregues përkatës, mbi arritjet dhe sfidat e Shqipërisë në çdo objektivi OZHQ, dhe sipas rasteve konkrete, edhe në nivel synimi OZHQ. Analiza e këtij udhërrëfyesi shërben si një pikënisje e mirë për këtë seksion, duke mundësuar identifikimin e përparësive, progresin e arritur si dhe synimet konkrete për vitin 2030.

F. Burimet e financimit të OZHQ-ve (2–3 faqe). Në këtë seksion do të paraqitet një përmbledhje e mjeteve të financimit në funksion të arritjes së OZHQ-ve në Shqipëri, duke përdorur si të dhëna parësore buxhetet e viteve të fundit si dhe duke konsideruar rolin kyç të sektorit privat në arritjen e këtyre objektivave, përfshirë instrumentet e financimit në kuadrin e integruar kombëtar të financimit (INFF).

G. Konkluzione dhe hapat e mëtejshëm (2–3 faqe). Në këtë pjesë të raportit do të nxirren përfundimet kryesore si dhe çfarë hapash janë planifikuar për të përmirësuar zbatimin e Agjendës 2030, veçanërisht si pjesë e dekadës së veprimit për zhvillim të qëndrueshëm.

H. Aneks (6–10 faqe). Nisur nga përvoja pozitive e përgatitjes së raportit të parë, në këtë pjesë mund të përfshihet një aneks statistikor me kontributin parësor të INSTAT, ku do të paraqiten me shifra dhe grafikë progresi dhe prirjet e Shqipërisë drejt përmbushjes së Agjendës 2030 sipas fushave kryesore të zhvillimit dhe OZHQ.

Hapat kryesorë dhe afatet për përgatitjen e raportit të dytë vullnetar të Shqipërisë mbi arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm:

Mesazhet kryesore (Main Messages): 20 prill 2026

30 mars – 10 prill 2026: Mbledhja e të dhënave dhe hartimi i Mesazheve Kryesore

30 mars – 30 prill 2026: Mbledhja e të dhënave dhe hartimi i Raportit VNR (Zero Draft)

5 maj 2026: Dorëzimi i draftit fillestar (Zero Draft) të VNR 2026

Maj 2026: Konsultime dhe validim

Qershor 2026: Finalizimi i raportit

8 qershor 2026: Dorëzimi i VNR nga Qeveria

Korrik 2026: Prezantimi në High-Level Political Forum on Sustainable Development nga përfaqësuesit e Qeverisë

Monitorimi dhe raportimi

Monitorimi i zbatimit të Udhërrëfyesit për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm deri në vitin 2030 është pjesë e zbatimit të politikave të pasqyruara në këtë dokument. Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës do të punojë për ngritjen e një sistemi të posaçëm monitorimi si pjesë e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrimin Evropian deri në vitin 2030. Standardizimi i procedurave, bashkërendimi ndërinstitucional dhe ndihma e ofruar kundrejt ministrive të linjës dhe institucioneve të tjerë të përfshira, do të jenë elementët kryesorë në monitorimin e treguesve OZHQ.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të SKZHIE 2030, SASPAC do të raportojë rregullisht e në mënyrë specifike për përmbushjen e objektivave OZHQ të përcaktuar në këtë dokument. SASPAC, gjithashtu, do të koordinojë në vazhdimësi miratimin e dokumenteve të tjerë të nivelit strategjik, duke siguruar që treguesit e tyre të jenë të harmonizuar me objektivat e OZHQ të përcaktuar në këtë dokument. SASPAC do të raportojë në mbledhjen e parë të çdo viti të Komitetit Ndërmnistror, mbi progresin e arritur, problematikën e evidentuar dhe masat e propozuara për veprim në procesin e monitorimit. SASPAC do të informojë rregullisht dhe sa herë t'i kërkohet, Nënkomisionit për Zhvillim të Qëndrueshëm pranë Kuvendit të Shqipërisë, mbi ecurinë e zbatimit të këtij udhërrëfyesi.

INSTAT-i do të vijojë të publikojë në mënyrë të rregullt të dhënat mbi treguesit kombëtarë të lidhur OZHQ, duke i dhënë edhe më përparësi atyre treguesve për të cilët janë të vendosur objektiva të matshëm për vitin 2030.

Aneks: Model për përcaktimin e synimeve të harmonizuara bazuar në treguesit OZHQ-ve

Kjo metodologji mundëson përcaktimin e synimeve konkrete për tregues specifikë OZHQ për të cilët disponohen të dhëna historike dhe të krahasueshme me vendet e tjera, duke përdorur si bazë projeksioni për vlerësimet në të ardhmen ecurinë e të njëjtit tregues, për vende që në të kaluarën kanë pasur ecuri të ngjashme me Shqipërinë (vlera përafërsisht të njëjta të treguesit), por që sot rezultojnë me një ecuri më pozitive. Në thelb, metodologjia për një tregues të caktuar krahason të dhënat e 10 viteve të fundit për Shqipërinë dhe vende që kanë pasur ecuri të ngjashme, dhe mbështetur në progresin më të mirë është arritur në këto vite, lejon projektimin e treguesit në të ardhmen, duke ndjekur të njëjtën prirje rritëse. Duke pasur në vëmendje ndryshimet në kontekstin e zhvillimit, si dhe reformat specifike që çdo vend mund të marrë, metodologjia ofron një alternativë statistikore, të mbështetur në të dhëna, për përcaktimin e synimeve të matshme në tregues OZHQ për të cilët kjo gjë nuk është e mundur me metoda të tjera vlerësimi.

Së bashku me shpjegimin, metodologjia shoqërohet me ilustrimin e tri treguesve OZHQ të përzgjedhur nga OZHQ 5, 7 dhe 16.

Vendosja e objektivit të duhur për vitin 2030 për një tregues të caktuar (kur ka të dhëna të disponueshme) mund të bëhet në disa mënyra, jo në mënyrë të plotë:

- Objektivat ndërkombëtarë (siç janë objektivat e OZH-ve);
- Vendim politik;
- Konsensusi i ekspertëve;
- Bazuar në përvojat më të suksesshme të mëparshme.

Ky shënim tregon se si mund të bëjmë përcaktime të harmonizuara të objektivave, bazuar në këtë të fundit – bazuar në përvojat më të suksesshme të kaluara të vendeve.

Meqenëse skenari më i mirë i përparimit në një variabël të caktuar zhvillimor do të ishte të thuash që një vend mund të përparojë po aq shpejt sa kanë bërë vendet më të mira të ngjashme në të kaluarën e afërt (duke treguar se një trajektore e tillë është e mundur), ne mund të sugjerojmë një metodologji të përcaktimit të objektivit të Fqinjtit më të Afërt (NN) për këtë qëllim.

Skenari NN mbështetet në idenë e konvergjencës së pakushtëzuar, sipas së cilës vendet në nivele të ngjashme arritjesh në fushat tona të fokusit kanë trajektore ose shtigje rritjeje të ngjashme të mundshme në të ardhmen. Duke parë të kaluarën, disa ishin në gjendje të ecnin përpara shpejt, ndërsa disa ngecën ose madje u përkeqësuan. Literatura mbi përputhjen e fqinjëve më të afërt shpesh gjendet në temat e vlerësimit të programit, të tilla si Heckman, Ichimura dhe Todd (1998), Lechner (1999), Dehejia dhe Wahba (2002), dhe Smith & Todd (2005), por, gjithashtu, lidhet drejtpërdrejt me përdorimin e sugjeruar këtu, për të identifikuar vende të ngjashme dhe për të identifikuar praktikën e tyre pozitive, të tilla si në Abu-Ismael et al. (2015) ose në UN Economist Toolkit, i disponueshëm në internet.

Qëllimi është të identifikohen fqinjët më të afërt për Shqipërinë dhjetë vjet më parë në aspektin e arritjeve zhvillimore tregues pas treguesi. Nga NK-të, ne identifikojmë ato që kanë përparuar më shumë në dhjetë vitet e fundit. Ne e dimë që këto NK të suksesshme në përgjithësi kanë zbatuar politika të mira në dhjetë vjetet e fundit, dhe se ato, dhjetë vjet më parë, ishin më të ngjashmet me Shqipërinë, kështu që performanca e tyre e mundshme tregon një skenar të mundshëm/maksimal të performancës për Shqipërinë deri në vitin 2030, dhe si i tillë përcakton një objektiv për vitin 2030 për secilin tregues dhe një rrugë që Shqipëria mund të monitorojë. Një ushtrim i ngjashëm mund të bëhet me performuesit më të këqij, të cilët tregojnë regresin e mundshëm sipas një përzierjeje të përshtatshme politikash ose një skenari parashikimi më të keq deri në vitin 2030. Përveç kësaj, dhe për secilin tregues të zgjedhur, qasja NK identifikon saktësisht se cilat vende duhet të kërkojmë politika që kanë funksionuar në të kaluarën dhe kanë kontribuar në progresin më të madh, me qëllim të të mësuarit nga kolegët dhe të shohim nëse ato do të funksiononin dhe mund të kontekstualizohen për Shqipërinë.

Shembull i treguesit 16.3.2: Të paraburgosurit e padënuar si përqindje e popullsisë së përgjithshme të burgjeve

Hapi 1: Shkarkoni të dhënat për të gjitha vendet dhe vitet (në këtë rast nga Baza e të Dhënave Globale të UNSTAT-it)

Hapi 2: Gjeni vlerën e vitit të fundit për Shqipërinë, e cila është viti 2022 dhe vlera për të dyja gjinitë është 56.48.

Hapi 3: Krijoni një renditje në Excel të të gjitha vendeve 10 vjet para vlerës më të fundit të Shqipërisë, pra një renditje të të gjitha vendeve nga më e mira te më e keqja në vitin 2012.

Hapi 4: Bazuar në vlerën e Shqipërisë për vitin 2022, përcaktoni 15 NN nga viti 2012 dhe llogaritni progresin e tyre mesatar vjetor nga viti 2012 deri në vitin 2022.


Hapi 5: Shqyrtoni të gjitha vendet NN dhe eliminoni çdo njëërën nëse është e justifikuar për arsye specifike (ne po eliminojmë Palestinën dhe Ishujt Faroe në bazë të faktit se ato nuk kanë sovranitet të plotë dhe kapacitete të zakonshme shtetërore, gjë që për këtë tregues të veçantë do të paraqiste një sfidë)

Hapi 6: Mund të identifikohen 5 performuesit më të mirë dhe 5 më të ulët, me rezultatet e paraqitura në tabelën më poshtë, me rritjet mesatare vjetore të 5 performuesve më të mirë dhe 5 më të ulët të llogaritura, gjithashtu.

Hapi 7: Rritjet mesatare vjetore të 5 vendeve më të mira dhe 5 vendeve më të ulëta, si dhe shkalla historike e rritjes së Shqipërisë përdoren për të përcaktuar se ku mund të jetë Shqipëria në skenarin optimal, duke ndjekur politikat e 5 vendeve më të mira, skenarin e keq, duke ndjekur politikat e 5 vendeve më të ulëta, ose thjesht duke vazhduar në trajektoren e vet (pa ndërhyrje). Ne mund t'i tregojmë të tria shtigjet e mundshme në një grafik.

Renditja	Fqinji më i afërt	Viti	Vlera	Vlera	Shkalla	5	5	Shënim
----------	-------------------	------	-------	-------	---------	---	---	--------

në vitin 2012	nga viti 2012		në vitin 2012	në vitin 2022	mesatare vjetore e rritjes	performuesit më të mirë	performuesit e fundit	
99	Hondurasi	2012	49.48	49.87	0.09%		x	Vlera për vitin 2022 nga viti 2021
100	Ishujt Faroe	2012	50	26.8	-14.44%			Vlera për vitin 2022 nga viti 2016, e eliminuar për shkak të statusit të tyre specifik.
101	Argjentinë	2012	50.27	40.78	-2.07%	x		
102	Shteti i Palestinës	2012	52.33	35.18	-3.89%			Eliminuar për shkak të statusit të tyre specifik.
103	Trinidad dhe Tobago	2012	52.78	62.27	2.09%		x	Vlera për vitin 2022 nga viti 2020
104	Uganda	2012	53.81	48.8	-0.97%			
105	Madagaskar	2012	54.54	50	-0.87%			
106	Ekuador	2012	55.47	40.17	-3.18%	x		
107	Shqipëria 2022	2022	56.48					
108	Bahamas	2012	57.15	25.55	-7.73%	x		
109	Belize	2012	57.78	36.36	-4.53%	x		
110	Peru	2012	58.47	37.73	-4.29%	x		
111	Filipinet	2012	62.16	65.23	0.48%		x	
112	Kamerun	2012	62.19	61.87	-0.06%		x	Vlera për vitin 2022 nga viti 2021
113	Burundi	2012	62.43	54.23	-1.40%			
114	Togo	2012	62.72	60	-0.49%		x	Vlera për vitin 2022 nga viti 2021
5 normat më të larta mesatare vjetore të rritjes:					-4.36%			
Shkalla mesatare vjetore e rritjes së 5 vendeve më të ulëta:					0.42%			



Duke ndjekur politikat e 5 vendeve me performancën më të lartë, Shqipëria mund ta ulë treguesin e të paraburgosurve të pandëshkuar si përqindje e popullsisë së përgjithshme të burgjeve nga 56% në vitin 2012 në nën 40% në vitin 2030. Politikat se si ta bëjmë këtë tashmë ekzistojnë, thjesht duhet të shohim masat që vendet që kanë arritur tashmë një reduktim të tillë kanë ndërmarrë në 10 vitet e fundit (Argjentina, Ekuadori, Bahamas, Belize dhe Peru). 40% është pra një objektiv realist për vitin 2030 për Shqipërinë, pasi bazohet në politikat që janë zbatuar tashmë dhe që kanë treguar se po funksionojnë në vende të tjera - Fqinjët më të Afërt më të suksesshëm.

Shembull i Treguesit 5.5.1, Seria: Përqindja e vendeve të mbajtura nga gratë në parlamentet kombëtare (% e numrit të përgjithshëm të vendeve)

Hapi 1: Shkarkoni të dhënat për të gjitha vendet dhe vitet (në këtë rast nga Baza e të Dhënave Globale të UNSTAT-it)

Hapi 2: Gjeni vlerën e vitit të fundit për Shqipërinë, e cila është viti 2024 dhe vlera është 35.71%.

Hapi 3: Krijoni një renditje në Excel të të gjitha vendeve 10 vjet para vlerës më të fundit të Shqipërisë, pra një renditje të të gjitha vendeve nga më e mira te më e keqja në vitin 2014.


Hapi 4: Bazuar në vlerën e Shqipërisë për vitin 2024, përcaktoni 15 NN nga viti 2014 dhe llogaritni progresin e tyre mesatar vjetor nga viti 2014 deri në vitin 2024.

Hapi 5: Shqyrtoni të gjitha vendet NN dhe eliminoni çdo njërën nëse është e justifikuar për arsye specifike (asnjë nuk duhet eliminuar)

Hapi 6: Mund të identifikohen 5 performuesit më të mirë dhe 5 më të ulët, me rezultatet e paraqitura në tabelën më poshtë, me rritjet mesatare vjetore të 5 performuesve më të mirë dhe 5 më të ulët të llogaritura, gjithashtu.

Hapi 7: Rritjet mesatare vjetore të 5 vendeve më të mira dhe 5 vendeve më të ulëta, si dhe shkalla historike e rritjes së Shqipërisë përdoren për të përcaktuar se ku mund të jetë Shqipëria në skenarin optimal. Në këtë rast, për shkak se progresi i Shqipërisë në tregues ishte një nga më të mirët, me një rritje mesatare prej gati 6% në vit, Shqipëria në fakt mund të konsiderohet si shembulli më i mirë për t'u ndjekur nga NN të tjera. Megjithatë, grafiku tregon edhe politikat e trajektores së 5 vendeve me performancën më të lartë, si dhe skenarin e keq, duke ndjekur politikat e 5 vendeve me performancën më të ulët.

Renditja në vitin 2014	Fqinji më i afërt nga viti 2012	Viti	Vlera në vitin 2014	Vlera në vitin 2024	Shkalla mesatare vjetore e rritjes	5 Performuesit më të mirë	5 Performuesit e fundit
16	Danimarka	2014	39.11	45.25	1.47%	x	
17	Holanda (Mbretëria e)	2014	38.67	38.67	0.00%		x
18	Kosta Rika	2014	38.6	47.37	2.07%	x	
19	Timori Lindor	2014	38.46	38.46	0.00%		x
20	Meksikë	2014	37.4	50.4	3.03%	x	
21	Angola	2014	36.82	38.64	0.48%		
22	Argjentinë	2014	36.58	42.41	1.49%		
23	Gjermania	2014	36.45	35.33	-0.31%		x
24	Republika e Bashkuar e Tanzanisë	2014	36	37.4	0.38%		
	Shqipëria 2024	2024	35.71				
25	Uganda	2014	34.97	33.93	-0.30%		x
26	Maqedonia e Veriut	2014	34.15	42.5	2.21%	x	
27	Zelanda e Re	2014	33.88	45.53	3.00%	x	
28	Serbia	2014	33.6	38	1.24%		
29	Grenada	2014	33.33	31.25	-0.64%		x
30	Slloveni	2014	33.33	37.78	1.26%		
	5 normat më të larta mesatare vjetore të rritjes:				2.36%		
	Shkalla mesatare vjetore e rritjes së 5 vendeve më të ulëta:				-0.25%		



Duke ndjekur politikat e veta shumë të suksesshme, Shqipëria mund ta rrisë treguesin Përqindja e vendeve të mbajtura nga gratë në parlamentet kombëtare (% e numrit të përgjithshëm të vendeve) nga 36% në vitin 2024 deri në pak mbi 50% në vitin 2030. Ajo, gjithashtu, mund të përfitojë nga politikat shtesë që 5 vendet kryesore të parlamentit kanë miratuar, thjesht duke parë masat që vendet që kanë arritur tashmë një reduktim të tillë kanë ndërmarrë në 10 vitet e fundit (Danimarka, Kosta Rika, Meksika, Maqedonia e Veriut, Zelanda e Re). Ndjekja e trajektore së 5 vendeve kryesore do të na çonte në 41%, kështu që diapazoni midis 41% dhe 50% do të ishte kështu një objektiv realist për vitin 2030 për Shqipërinë, pasi ajo bazohet në politikat e saj të suksesshme dhe politikat e zbatuara tashmë dhe që kanë treguar se po funksionojnë në vende të tjera - Fqinjët më të Afërt më të suksesshëm.

Shembull i Treguesit 7.2.1: Pjesëmarrja e energjisë së rinovueshme në konsumin total përfundimtar të energjisë

Hapi 1: Shkarkoni të dhënat për të gjitha vendet dhe vitet (në këtë rast nga Baza e të Dhënave Globale të UNSTAT-it)

Hapi 2: Gjeni vlerën e vitit të fundit për Shqipërinë, e cila është viti 2021 dhe vlera është 41.91%.

Hapi 3: Krijoni një renditje në Excel të të gjitha vendeve 10 vjet para vlerës më të fundit të Shqipërisë, pra një renditje të të gjitha vendeve nga më e mira te më e keqja në vitin 2011.

Hapi 4: Bazuar në vlerën e Shqipërisë për vitin 2024, përcaktoni 15 NN nga viti 2011 dhe llogaritni progresin e tyre mesatar vjetor nga viti 2011 deri në vitin 2021.


Hapi 5: Shqyrtoni të gjitha vendet NN dhe eliminoni çdo njërën nëse është e justifikuar për arsye specifike (asnjë nuk duhet eliminuar)

Hapi 6: Mund të identifikohen 5 performuesit më të mirë dhe 5 më të ulët, me rezultatet e paraqitura në tabelën më poshtë, me rritjet mesatare vjetore të 5 performuesve më të mirë dhe 5 më të ulët të llogaritura, gjithashtu.

Hapi 7: Rritjet mesatare vjetore të 5 vendeve më të mira dhe 5 vendeve më të ulëta, si dhe shkalla historike e rritjes së Shqipërisë përdoren për të përcaktuar se ku mund të jetë Shqipëria në skenarin optimal. Në këtë rast, për shkak se progresi i Shqipërisë në tregues ishte një nga më të mirët, me një

rritje mesatare prej 1.6% në vit, Shqipëria është shumë afër 5 vendeve më të mira të regjistruara. Grafiku tregon, gjithashtu, politikat e trajektores së 5 vendeve me performancën më të lartë, si dhe skenarin e keq, duke ndjekur politikat e 5 vendeve me performancën më të ulët.

Renditja në vitin 2011	Fqinji më i afërt nga viti 2011	Viti	Vlera në vitin 2011	Vlera në vitin 2021	Shkalla mesatare vjetore e rritjes	5 performuesit më të mirë	5 performuesit e fundit
69	Vanuatu	2011	35.75	24.64	-3.65%		x
68	Shqipëria	2011	35.84	41.91	1.58%	x	
67	Vietnami	2011	36.33	24.23	-3.97%		x
66	Kosta Rika	2011	38.02	34.16	-1.06%		
65	Bangladesh	2011	38.41	25.04	-4.19%		x
64	Samoa	2011	40.64	35.95	-1.22%		
	Shqipëria 2021	2021	41.91				
63	Belize	2011	42.18	26.56	-4.52%		x
62	Lesoto	2011	42.32	33.63	-2.27%		
61	Sao Tome dhe Principe	2011	42.38	40.75	-0.39%	x	
60	Mali i Zi	2011	42.77	39.64	-0.76%		
59	Ishujt Solomon	2011	43.61	49.13	1.20%	x	
58	Brazili	2011	45.25	46.48	0.27%	x	
57	Suedi	2011	45.43	57.9	2.46%	x	
56	Pakistani	2011	46.76	41.56	-1.17%		
55	Senegali	2011	47.97	35.42	-2.99%		x
5 normat më të larta mesatare vjetore të rritjes:					1.02%		
Shkalla mesatare vjetore e rritjes së 5 vendeve më të ulëta:					-3.86%		



Duke ndjekur politikat e veta shumë të suksesshme, Shqipëria mund të rrisë pjesën e energjisë së rinovueshme të treguesit në konsumin total të energjisë përfundimtare nga 42% në vitin 2021 në 48% në vitin 2030. Ajo, gjithashtu, mund të përfitojë nga politikat shtesë që kanë miratuar NN-të me përqindje më të lartë, thjesht duke parë masat që vendet që kanë arritur tashmë një reduktim të tillë kanë ndërmarrë në 10 vitet e fundit (Sao Tome dhe Principe, Ishujt Solomon, Brazili dhe Suedia). Ndjekja e trajektorës së 5 vendeve më të mira do të na çonte në 46%, kështu që diapazoni midis 46% dhe 48% do të ishte kështu një objektiv realist për vitin 2030 për Shqipërinë, pasi bazohet në politikat e saj të suksesshme dhe politikat e zbatuara tashmë dhe që kanë treguar se po funksionojnë në vende të tjera - Fqinjët më të Afërt më të suksesshëm.